

# RINIA SHQIPTARE 2018/2019

## FONDACIONI "FRIEDRICH EBERT"

Fondacioni "Friedrich Ebert" (FES) është fondacioni politik më i vjetër në Gjermani me një traditë të pasur të social-demokracisë, e cila daton prej 1925-ës. Angazhimi i fondacionit tonë politik, përqëndrohet në idetë bazë dhe vlerat e social-demokracisë, lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit. Kjo na lidh ne me social-demokracinë dhe lëvizjen e lirë sindikaliste.

Nëpërmjet rrjetit tonë ndërkombëtar të zyrave në më shumë se 100 shtete, FES mbështet politikën e bashkëpunimit paqësor dhe të drejtat e njeriut, promovimin, zbatimin dhe konsolidimin e demokracisë, strukturave sociale dhe kushtetuese, si dhe na bën pionierë në forcimin e sindikatave të lira dhe të një shoqërie civile të fortë. Ne jemi të përfshirë në mënyrë aktive në promovimin e një Evropë sociale, demokratike dhe konkurruese në kuadër të procesit të Integritimit Evropian.

## STUDIMET RINORE NË EVROPËN JUG-LINODRE 2018/2019:

"Studimi Rinor i FES për Evropën Jug-Lindore 2018/2019" është një projekt ndërkombëtar kërkimor i kryer njëkohësisht në dhjetë shtete të Evropës Jug-Lindore, specifikisht në: Shqipëri, Bosnjë-Herzegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali Zi, Rumani, Serbi dhe Slloveni. Objektivi kryesor i studimit është të identifikojë, përshkruajë dhe analizojë qëndrimet dhe modelet e sjelljes në shoqëritë moderne.

Të dhënat janë mbledhur në fillimin të vitit 2018 dhe më shumë se 10.000 të rinj të moshës 14-29 vjeç nga vëndet e sipërpërmendura të dhjetë shteteve të Evropës Jug-Lindore, morën pjesë në këtë analizë. Studimet mbulojnë një sferë të gjërë të çështjeve, përta i përket eksperiencave dhe aspiratave të tyre në fusha të ndryshme të jetës siç janë; edukimi, punësimi, përfshirja politike, marrëdhëniet familjare, koha e lirë dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit, por gjithashtu të vlerave, qëndrimeve dhe besimeve.

Kërkimi empirik prezantohet nëpërmjet dhjetë studimeve kombëtare dhe një studimi rajonal të publikuar në gjuhën Anlgeze dhe ato vëndase.

# STUDIIMI RINOR SHQIPËRI 2018/2019

Alba Çela  
Geron Kamberi



<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Metodologjia</b> .....	<b>5</b>
<b>3</b>	<b>Koha e lirë dhe stili i jetesës</b> .....	<b>9</b>
<b>4</b>	<b>Vlerat, feja dhe besimi</b> .....	<b>17</b>
<b>5</b>	<b>Familja dhe shoqëria</b> .....	<b>25</b>
<b>6</b>	<b>Mobiliteti</b> .....	<b>37</b>
<b>7</b>	<b>Arsimi</b> .....	<b>45</b>
<b>8</b>	<b>Punësimi</b> .....	<b>53</b>
<b>9</b>	<b>Politika</b> .....	<b>63</b>
<b>10</b>	<b>Pyetje konfidenciale</b> .....	<b>73</b>
<b>11</b>	<b>Pyetje specifike për Shqipërinë</b> .....	<b>81</b>
	Referenca .....	87
	Tabela e Figurave .....	88
	Tabela e Tabelave .....	90



## 1

## HYRJJE

“Rinia Shqiptare 2018” është hapi i 3-të i studimit të nisur në vitin 2011 nga FES, që synon të zbulojë dhe të evidentojë prirjet e të rinjve shqiptarë mbi tema të tilla si: familja, arsimimi, punësimi, politika, feja etj. Në shtjellim të kësaj problematike studimi arrin edhe në disa përfundime. Edhe pas gati 30 vitesh tranzicioni rëndësia e familjes dhe e shoqërisë mbeten mjete të qëndrueshme të mbështetjes emocionale dhe ekonomike për të rinjtë shqiptarë. Marrëdhënia e të rinjve shqiptarë me vlerat e familjes e të shoqërisë po ndryshon me ngadalësi për arsye të një ndërthurjeje të përvojave tradicionale me ato moderne. Mundësitë për pavarësi ekonomike që i hapin rrugë dëshirës së të rinjve për t’u çliruar nga pushteti i familjes janë kryesisht, të përqëndruara në kryeqytet dhe në pak qendra relativisht të mëdha urbane.

Të rinjtë shqiptarë i konsiderojnë miqësinë, mënyrën e jetës dhe marrëdhëniet shoqërore si element të rëndësishëm të identitetit të tyre social. Kontaktet e përditshme me rrethin e tyre social janë të karakterit real dhe virtual, falë medias sociale, që ka ndihmuar në krijimin e stereotipeve dhe ka ofruar platforma komunikimi për shkëmbimin e ideve dhe opinioneve. Marrëdhënia me shoqërinë përbën një tipar domethënës të sjelljes sociale të të rinjve dhe ka një rol të veçantë në jetën e tyre.

Studimi “Rinia Shqiptare 2018” ofron një sërë opinionesh dhe refleksionesh mbi arsimimin e të rinjve. Gjatë viteve të shkollimit ata krijojnë një identitet qytetar e profesional, që i ndihmon për të përballuar realitetet e tregut kombëtar, rajonal, europian e global të punës. Nga ana tjetër, lidhja realisht mes arsimimit dhe punësimit mbetet një element i vazhdueshëm shqetësimi për të rinjtë shqiptarë, sepse investimi i tyre në arsim nuk përkthehet gjithmonë në punësim të qëndrueshëm. Çështja e punësimit mbetet një shqetësim i brendshëm për të rinjtë, një realitet i ri, ku idetë dhe realiteti i premtuar (a i pritshëm) për raportin arsim – punësim përplasen, nuk ka siguri. E “sunduar” nga pasiguria, marrëdhënia që të rinjë krijojnë me karrierën e tyre të punës dhe të profesionit përbën një pikë me rëndësi të vecantë në jetët e tyre.

Pjesëmarrja e të rinjve në jetën politike, që fillon me respektimin e shtetit dhe të ligjit, me kuptimin e rolit të politikës në zhvillimet

e shoqërisë dhe të çdo individi, me parapëlqimin, anëtarësimin, si dhe votimin për partitë politike. Institucionet shtetërore janë instrumenta me ndikim të ndjeshëm mbi jetën e të rinjve. Besimi apo mosbesimi i të rinjve ndërmjet zhvillimet politike, janë thelbësore për pjesëmarrjen e tyre në këtë proces. Për këtë arsye studimi “Rinia Shqiptare 2018” është një ndihmesë për të reflektuar mbi praninë dhe ndikimin e politikës te të rinjtë. Përvoja historike mbarëbotërore dëshmon se të rinjtë janë aktorë të fuqishëm, që sjellin ndryshim dhe përpshpejtojnë proceset politike. Angazhimi i tyre politik, apo apatia, është ngushtësisht e lidhur me cilësinë e vetë politikës dhe institucioneve që ajo krijon. Veçanërisht lëkundja e besimit, apatia, zhgënjimi dhe “humbja” e shpresës i shtyjnë të rinjtë drejt largimit nga Shqipëria në kërkim të një jete më të mirë në nivel kombëtar. Ndikimi i përkatësive dhe besimeve fetare. Edhe për rrjedhojë të traditës shëkullore nuk është shqetësues në shumicën dermuese të rinisë. Por hapja e një populli të vetizoluar apo të izoluar për gati gjysëm shekulli, ndikimi i medias së lirë, i lëvizjes së lirë dhe globalizimit aktual kanë ndikuar e stimuluar edhe shfaqjen sporadike të elementëve fetarë radikalistë, që ndonëse të paktë janë bërë “të njohur” më tepër për pjesëmarrje në radhët e ISIS-it, sesa me aktivitetet në Republikën e Shqipërisë.



# 2

## METODOLOGJIA

Studimi bazohet në një sondazh kombëtar me 1200 të anketuar, përkatësisht të moshës nga 14 deri në 29 vjeç. Përzgjedhja e njerëzve të intervistuar është përfaqësuese për Shqipërinë dhe problematikën, objekt të këtij studimi.

### PËRZGJEDHJA E PËRFAQËSIMIT KOMBËTAR

Për të qënë një studim, që synon të ketë përmasa kombëtare, IDRA Research & Consulting ka përdorur një metodë të mbështetur në tre hapa të anketimit dhe intervistimit:

- i). Hapi i parë – Përzgjedhja e pikave
- ii). Hapi i dytë – Përzgjedhja e shtëpive / familjeve
- iii). Hapi i tretë – Përzgjedhja e personave të intervistuar

#### 1.1 Hapi i parë – Përzgjedhja e pikave

IDRA posedon listën e qendrave të votimit të bëra publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Mbi bazën e kësaj liste, ajo me anë të Probabilitetit Proporcional në Madhësi, bën përzgjedhjen e njerëzve për t'u anketuar ose intervistuar. Kjo përzgjedhje bëhet në varësi të numrit të votuesve të regjistruar në një qendër që gjithashtu kanë shansin më të madh për t'u zgjedhur. IDRA përzgjedh modelin në bazë të rajoneve dhe të një ndarjeje urbane-rurale. IDRA zgjedh një numër të caktuar të qendrave të votimit urban dhe rural në çdo rajon.

Për këtë studim, janë përdorur rezultatet e votimeve në 120 qendra votimi dhe janë përzgjedhur rastësisht nga 10 intervista në secilën prej tyre.

#### 1.2 Hapi i dytë – Përzgjedhja e shtëpive / familjeve (intervistimi)

Për secilin nga të intervistuarit është kërkuar, ku ishte, në përgjithësi qendra e votimit ose ndërtesa e banimit, udhëkryq, shkollë, institucion publik etj. Pas kësaj, ai/ajo u udhëzua që të fillojë nga pas dhe të ecë, duke e mbajtur gjithmonë anën e tij të

djathtë. Intervistuesi u udhëzua të numëroje ndërtesat / shtëpitë e "jetuara" dhe për të kryer një intervistë në çdo ndërtesë / shtëpi të tretë.

#### 1.3 Hapi i tretë – Përzgjedhja e personave të intervistuar

Përzgjedhja e personave të intervistuar u krye duke përdorur metodën e datëlindjes së fundit në familje. Intervistuesi merr listën dhe datëlindjet e banorëve të shtëpisë, që janë mbi 14 vjeç. Është bërë kontakti për të organizuar një intervistë me banorin e shtëpisë, i cili ka pasur më së fundi datëlindjen e tij / saj (distanca në kohë nga data e intervistës).

Nëse ky banor i përzgjedhur nuk ndodhet në shtëpi, intervistuesi përpiqet të bëjë një takim tjetër me të. Nëse intervistuesi nuk arrin ta kontaktojë banorin e përzgjedhur edhe pas përpjekjes së tretë, shtëpia kategorizohet si refuzim dhe shtëpia tjetër e përzgjedhur kontaktohet në bazë të metodologjisë. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur banori i përzgjedhur refuzon të marrë pjesë në intervistë.

#### Për tu marrë parasysh!

IDRA përdor numrin e votuesve të regjistruar në një qendër votimi për të kryer përzgjedhjen e qendrave të votimit. Numri i votuesve të regjistruar është një mjet shumë i mirë nëse kampioni është përfaqësues i popullsisë mbi 18 vjeç. IDRA beson se numri i votuesve të regjistruar është një premisë e mirë e marrjes së mostrave për mbështetjen e këtij studimi (14–29 vjeç), duke marrë parasysh gjithashtu se një qendër votimi, që ka më shumë votues të regjistruar ka më shumë familje.

TABELË 1: Peshimi / koeficienti

Albania			
		Para	Pas
Moshë	14–17 vjeç	40 %	20 %
	18–21 vjeç	25 %	35 %
	22–25 vjeç	20 %	25 %
	26–29 vjeç	15 %	20 %
Gjinia	Femër	45 %	49 %
	Mashkull	55 %	51 %
Marzhi i gabimit:		2.8	
Shkalla e pergjigjeve:		50.2 %	

## KONCEPTET DHE LITERATURA

Studimi i FES, “Rinia Shqiptare 2018”, është unik në termat e qasjes dhe të fokusit që ka ekskluzivisht te të rinjtë në Shqipëri. Përfundimet e tij janë arritur duke përdorur të dhëna nga studime apo anketat e INSTAT për nëngrupet moshore që në fakt kanë shtrirje në nivel kombëtar. Në të janë shfrytëzuar edhe studime të tjera për të rinjtë, që janë të limituara në çështje të ndryshme, më tepër te punësimi apo te mënyra e jetesës.

Që nga koha kur është publikuar studimi i fundit i FES për rininë në Shqipëri, literatura përkatëse ka trajtuar tri tema kryesore që janë të pranishme e me ndikim në shoqërinë shqiptare: **mënyrat e reja të emigrimit, shfaqja dhe, më pas, zbehja e fenomenit të radikalizmit fetar, si dhe shkalla e konsiderueshme e narkotrafikut dhe lidhjet e tij me politikën në vend.**

Së pari, është rritur ndieshëm preferenca e të rinjve dhe, sidomos, e profesionistëve në moshë të re për të emigruar në vendet e Europës Perëndimore dhe në veçanti në Gjermani, Hollandë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Kjo është duke shkaktuar probleme në sektorin shëndetësor në vend, duke qënë se një numër i konsiderueshëm mjekësh dhe infermierësh të synojnë apo edhe kanë shkuar në drejtim të Gjermanisë, në kërkim të një jete më të mirë. Të gjitha kurset e gjuhës gjermane në Tiranë dhe në qytetet kryesore janë të tejmbushura me nxënës, që përpiqen të plotësojnë nivelin e kërkuar të zotërimit të gjuhës. Studime të shumta që kanë shqyrtuar shkaqet dhe faktorët e kësaj dëshire masive citojnë një kombinim të mungesës së mundësive ekonomike dhe të humbjes së shpresës për ardhmërinë e jetesës në Shqipëri.

Fenomeni i dytë, është fatmirësisht në tërheqje të plotë radikalizmi fetar, i manifestuar në mënyrë të veçantë në pjesëmarrjen e një numri qytetarësh shqiptarë që iu bashkuan konflikteve të armatosura në Siri dhe Irak. Ky fenomen u bë shkak për nisjen e një debati intensive publik për të frenuar e parandaluar penetrimin e prirjeve të huaja ekstremiste në Komunitetin Musliman në Shqipëri, që u shfaqën edhe si pasojë e praktikimit të një forme rituali e predikimit thuajse krejt të ndryshëm nga modeli tradicional e i moderuar i islamizimit në Shqipëri. Pas ashpërsimit të ligjeve përkatëse, arrestimit të rekrutuesve si dhe ndërhyrjes në xhami jashtë

kontrollit të KMSH-se, por dhe pas rënies së fuqisë së ISIS, situata u përmirësua ndieshëm. Megjithatë këto zhvillime ekspozuan një vulnerabilitet të madh shoqëror e, për pasojë, nevojën për gatishmëri në vijimësi të shtetit dhe shoqërisë për t'i mbajtur këto lloj fenomenesh në kontroll.

Së fundmi, Shqipëria ende mbetet një vend “me peshë” për prodhimin, eksportin dhe transitin e narkotikëve në Europë. Kjo nuk dëshmohe vetëm nga raportet përkatëse ndërkombëtare, por edhe nga sasitë e mëdha të bllokuara gjatë aksioneve policore në Shqipëri, Greqi dhe Itali. Vetëm në një nga këto operacione, policia shqiptare ka kapur rreth 600 kilogramë kokainë, me vlerë tre-gu miliona euro.<sup>1</sup> Narko-trafikë është një problem tepër shqetësues jo vetëm për agjensitë e zbatimit të ligjeve. Më së shumti, ai po shkaktonte dëme të pariparueshme në sistemin bazë të vlerave për të rinjtë shqiptarë, të cilët vëzhgojnë dhe fillojnë të futen në këtë rrugë të pasurimit të shpejtë. Mbjellja dhe prodhimi në sasi të konsiderueshme e kanabis-sativës janë në disfavor të imazhit e Shqipërisë në Botë, sepse knaë dëmtuar dhe dëmtojnë të tashmen dhe perspektivën e zhvillimit të turizmit si dhe shanset për progres në rrugën e integritit evropian.

Këto zhvillime përbëjnë sfondin real, në të cilin formohen, ndryshojnë dhe konsolidohen imazhet, pritshmëritë dhe vlerësimet e të rinjve shqiptarë si dhe sjelljet e tyre në jetë.

Qëllimi i këtij studimi, sikurse edhe i dy studimeve paraprijëse nuk është vetëm fotografimi i situatës aktuale për të dalluar trendet të veçantë me rëndësi për të ardhmen e shoqërisë, që lidhen ngushtë me pritshmëritë demografike, zhvillimet politike afatmesme dhe afatgjata, por edhe inkurajimi i një debati të informuar për rininë. Një debat i tillë sfidon stereotipet për të rinjtë dhe kontribuon në hartimin e politikave, që e angazhojnë këtë segment vital të popullatës në zhvillimin e vendit në një mënyrë serioze dhe konsistente. Shqipëria vijon të ketë një strategji kombëtare apo plane veprimi për të rinjtë, të cilat, edhe pse janë voluminoze dhe ambicioze, shpesh, duket se nuk i përkojnë realitetit.

Studimi që keni në dorë përmban mjaft përfundime dhe rekomandime për audiencën të ndryshme, si dhe mund të shërbejë për pasurimin literaturës për të gjithë studiuesit, politikëbërësit dhe reporterët, që merren me çështjet e rinisë në Shqipëri.







## 3

# KOHA E LIRË DHE STILI I JETESËS

- Gjinia është faktori kryesor që vendos zgjedhjen e aktiviteteve të të rinjve për kohën e lirë: djemtë luajnë videogames, dalin më shpesh dhe praktikojnë sporte, ndërkohë që vajzat, më së shumti, lexojnë libra.
- Të rinjtë shqiptarë haxhojnë çdo ditë mesatarisht, 2.3 orë duke parë Televizor, si dhe 3.9 orë online (në Internet).
- Ngjarjet madhore të jetës, që ndodhin në moshë shumë të re te të rinjtë shqiptarë: janë tepër të paktë ata që martohen në moshën 21 vjeçare dhe që pas një viti, 22 vjeç, bëhen prindër për herë të parë.
- Të rinjve shqiptarë iu nevojitet një buxhet mujor prej rreth 105 euro për harxhime të ndryshme, përveç ushqimit dhe shkollës.

## ZGJEDHJET E KOHËS SË LIRË

Shpenzimi i kohës së lirë nga të rinjtë është i rëndësishëm, sepse tregon elemente të tjera të jetës së tyre, si dhe të planeve për të ardhmen. Aktivitetet më të zakonshme, që të rinjtë bëjnë shpesh në kohën e lirë, cdo ditë ose disa herë në javë, janë dëgjimi i muzikës (85 përqind e bëjnë këtë shumë shpesh), dalja me miqtë (70 përqind e bëjnë shumë shpesh), shikimi i filmave (72 përqind), relaksimi dhe kalimi kohës me familjen e tyre (92 përqind e bëjnë këtë mjaft shpesh).

Gjysma e të rinjve të pyetur e kalojnë shumë shpesh kohën e lirë duke frekuentuar kafene dhe lokale, ndërkohë që 21 përqind e bëjnë këtë me raste. Megjithatë, 15 përqind e të rinjve pohojnë se nuk shkojnë kurrë në kafene dhe lokale në kohën e lire, kurse 18 përqind prej tyre i frekuenton ato shumë rrallë. Shqipëria, së fundmi, është rankuar si vendi me numrin më të lartë të kafeneve për numrin e popullsisë duke ia kaluar dhe Spanjës, që ka pasur

për shumë vite rekordin.<sup>2</sup> Kafenetë shqiptare, sidomos në kryeqytet, janë të mbushura plot me të rinj në çdo ditë të javës. Ndaj është me shumë interes të eksplorohej profili i të rinjve, që shkojnë shumë rrallë ose nuk shkojnë kurrë në kafene dhe në bare. Shumica e këtyre të fundit janë femra dhe i përkasin grupmoshës më të re (14–17 vjeç). Po ashtu, një ndër katër të rinj, nga grupi më mundësitë më të ulëta ekonomike, thotë se nuk shkon kurrë në kafene ose lokale.


Vetëm një e treta e të rinjve shpenzon rregullisht kohë të lirë duke lexuar libra, 19 përqind e bëjnë këtë vetëm me raste, ndërkohë që gjysma tjetër e tyre lexon shumë rrallë (28 përqind) ose nuk lexon kurrë (22 përqind).

Ndarja gjinore është e dukshme dhe e shpeshtë në analizën e modeleve dhe e prirjeve që kanë të rinjtë për kohën e lirë. 28 përqind e femrave, krahasuar me vetëm 5 përqind të meshkujve, nuk dalin kurrë me miqtë ose e bëjnë këtë gjë shumë rrallë. Po ashtu, dalja me miqtë është më e rrallë në zonat rurale se sa në ato urbane. Faktor i fuqishëm në këtë çështje është, sigurisht, edhe statusi ekonomik i të rinjve: 8 përqind e të rinjve nga grupi më i varfër ekonomikisht nuk del kurrë, krahasuar me mesataren kombëtare, që është vetëm 1 përqind.

Të lexuarit e librave risjell në vëmendje një ndarje të madhe gjinore. Ndërkohë që 20 përqind e vajzave lexojnë shumë rregullisht vetëm 8 përqind e djemve e bën këtë gjë. Po ashtu vetëm 12 përqind e vajzave thonë se nuk lexojnë kurrë, ndërkohë që këtë e pohojnë 31 përqind e djemve.

Leximi i gazetave dhe revistave është një aktivitet që shpesh, bëhet vetëm nga 10 përqind e të rinjve, ndërkohë që nga 80 përqind e tyre bëhet rrallë ose s'bëhet aspak. Përqindja në këtë rast rritet në grupin e të diplomuarve nga universiteti, nga të cilët 18 përqind i lexojnë gazetat dhe revistat rregullisht.

FIGURA 1: Sa shpesh angazhoheni në aktivitet e mëposhtme?



Një situatë e kundërt vihet re aspektin gjinor në praktikimin e sporteve dhe të aktivitetit fizik, ku djemtë janë në krye. 46 përqind e djemve dhe 28 përqind e femrave praktikojnë sporte apo ushtrime shpesh ose shumë shpesh. Megjithatë, në përgjithësi, 41 përqind e të gjithë të rinjve shqiptarë nuk ushtrohen fizikisht, duke praktikuar sporte rrallë ose asnjëherë.

Djemtë preferojnë të luajnë me videogames shumë më shumë se vajzat. 37 përqind e tyre e bëjnë këtë shumë shpesh krahasuar me vetëm 13 përqind të vajzave. Ndërkohë 62 përqind e vajzave, dhe 24 përqind e djemve pohojnë se nuk luajnë kurrë videogames.

Marrja me aktivitete krijuese, veçanërisht në fushën e artit, vlerësohen gjithnjë e më shumë në Botë si aftësi e domosdoshme për angazhimin e ardhshëm profesional të individëve. Megjithatë, gjysma e të rinjve shqiptarë nuk merret kurrë me veprimtari krijuese, kurse 17 përqind e tyre e bëjnë këtë rrallë. Rreth 12 përqind e të rinjve e bëjnë këtë me raste, ndërkohë që 19 përqind e bëjnë këtë shpesh.

Duke qenë se numri i qendrave rinore në Shqipëri është shumë i vogël, edhe përqindja e të rinjve, që shpenzojnë kohë në to është shumë e vogël. 2/3 e gjithë të rinjve nuk kalojnë kurrë kohë në një qendër rinore. 17 përqind e atyre, që i kanë frekuentuar këto qendra shpesh ose me raste, banojnë shumica në zona urbane. Numri i vogël i qendrave rinore është një mundësi zhvillimi e munguar për rininë, se dihet që ato janë vende ku ndërtohet

ndësia e komunitetit, përftohen aftësi të vlefshme dhe inkurajohet pjesëmarrja qyterare.

Vullnetarizmi në projekte të ndryshme sociale apo organizata të ndryshme është një tjetër indikator i ndjenjës qytetare dhe i përgjegjësisë të të rinjve ndaj komunitetit. Në 2017, 16 përqind e të rinjve u angazhuan vullnetarisht në aktivitete të ndryshme disa herë. Vullnetarët e shpeshtë ishin pak. Në 2014, një grup prej 21 përqind ishin vullnetarë së paku disa herë ndërkohë që shifra ishte po 16 përqind në vitin 2011. Duket se vullnetarizmi mbetet sporadik tek të rinjtë.

Meditimi, praktikimi i jogës dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme me to, si leximi i librave mbi spiritualitetin dhe rritjen personale pothuajse nuk njihen nga të rinjtë. 87 përqind e tyre nuk i praktikojnë dhe ata pak të rinj që i njohin dhe i ushtrojnë jetojnë shumica në kryeqytet.

Një e treta e të rinjve të pyetur thonë se ata luten çdo ditë ose, të paktën, disa herë në javë. Një tjetër grup, prej 30 përqind luten me raste. Sipas sondazhit, vajzat e reja luten më shpesh se sa djemtë. Tërheq vëmëndjen fakti që të diplomuarit nga universiteti luten më shpesh.

Të bërit pazar (Shopping) është një aktivitet, që një e treta e të rinjve e kryen regullisht. Në këtë veprimtari kryesojnë vajzat me 45 përqind, krahasuar me 25 përqind të djemve. Një në dhjetë djem pothuajse nuk shkon kurrë për pazar, duke ia lënë këtë angazhim anëtarëve të tjerë të familjes me shumë gjasë të gjinisë femërore.

Kalimi i një kohe të lirë jashtë vendit mbetet një luks për të rinjtë shqiptarë. 51 përqind e tyre nuk e kanë bërë këtë asnjëherë, ndërkohë që 35 përqind e tyre e kanë bërë rrallë ose me raste. Vetëm 6 përqind kalojnë kohë shpesh jashtë Shqipërisë. Të rinjtë në zonat urbane kanë më shumë shanse të shpenzojnë kohë jashtë vendit. Nuk kanë qenë kurrë jashtë Shqipërisë vetëm 42 përqind e të rinjve nga zona urbane dhe me 63 përqind e atyre nga zonat rurale.

Të rinjtë shpenzojnë mesatarisht 2.3 orë duke ndjekur TV. Në 2011 dhe 2014, të rinjtë shpenzonin 3.1–3.2 orë përpara ekranit të televizorit. Kjo kohë tashmë ka kaluar tek ekrani i vogël ai i celularëve dhe tabletave. Në Tiranë të rinjtë raportojnë dhe kohën më të ulët të ndjekjes së televizionit, rreth 1.9 orë në ditë.

## REALITETI VIRTUAL

93 përqind e të rinjve shqiptarë, krahasuar me 85 përqind të tyre në sondazhin e kaluar kanë akses të rregullt në Internet. Për atë minoritet të vogël, që nuk ka akses të tillë, faktori vendimtar është statusi ekonomik. 1 në 10 të rinj nga grupi me mundësi më të kufizuara ekonomike nuk ka akses në Internet.

Të rinjtë shqiptarë kalojnë një kohë mbresëlënëse online, rreth 3.9 orë në ditë. Për meshkujt kjo kohë është dhe pak më e madhe tek 4.1 orë në ditë. Ky trend është në një rritje të vazhdueshme nga 3.2 orë të shpenzuara online në vitin 2014 dhe 2.9 orë në 2011.

Sasia e kohës e shpenzuar online dikton shumë elemente të jetës së të rinjve pasi ata e përdorin Internetin për shumë qëllime.

Përdorimet më të shpeshta të Internetit janë: Rrjetet sociale (87 përqind e përdorin shumë shpesh për këtë qëllim) Komunikimi përmes platformave falas si Skype/ Viber (85 përqind i përdorin shumë shpesh), dëgjimi i muzikës (70 përqind) dhe ndarja e fotove dhe videove me të tjerët (67 përqind).

Këto ndiqen nga shkarkimi i filmave (49 përqind); marrja e informacionit të duhur për detyrat dhe projektet e shkollës (48 përqind) dhe lojrat online (38 përqind).

Përdorimet utilitare të Internetit janë të rralla dhe jo fort të njohura nga të rinjtë: shopping online dhe veprimet bankare online janë në shifrat e ulëta 5–10 përqind, madje, dhe emaili, si formë më serioze komunikimi, përdoret vetëm nga 25 përqind e të pyeturve.

51 përqind e të rinjve e përdorin Internetin për tu informuar dhe për të lexuar lajmet mjaft shpesh. Një tjetër grup prej 37 përqind, po ashtu, informohet dhe dëgjon lajmet online me raste. Të rinjtë e moshave pak më të pjekura e përdorin Internetin më shpesh për t'u informuar për lajmet se sa adoleshentët. Kjo ndërvarje kaq e spikatur për të marrë lajmet nga Interneti duhet analizuar më tej. Një raport rajonal ka treguar se vendet e Europës Juglindore, e në veçanti, Shqipëria janë shumë të pambrojtura nga rreziku i lajmeve të rreme dhe influencave të ngjashme, duke qenë se niveli i njohjes së medias dhe funksionimit të saj (media literacy) aty është mjaft i ulët.<sup>3</sup>

Rrjetet sociale përdoren gjerësisht nga të rinjtë, të cilët kanë një preferencë në rritje për to. 21 përqind e të rinjve të pyetur thonë se kanë deri në 50 miq në këto rrjete, ndërkohë që 37 përqind thonë se kanë deri në 200 miq dhe, 30 përqind kanë deri në 500 miq nga rrjetet sociale. Grupi me më shumë sesa 500 miq online përbën 11 përqind të të rinjve.

Megjithatë kur iu kërkohet të rinjve se sa prej këtyre miqve virtualë do t'i konsideronin si miq në jetën reale, numrat fillojnë të bien ndieshëm. Mesatarisht, të rinjtë thonë se, nga numri i miqve të tyre në rrjete sociale, vetëm 29 prej tyre janë miq në jetën e përditëshme, me të cilët ata kanë vërtet kontakt. Për meshkujt ky numër është 31, ndërkohë, që për femrat është 25. Vihet re një hendek i madh midis numrit të miqve në botën virtuale dhe atyre në jetën e përditëshme.

Të rinjtë janë pyetur nëse kanë besim që rrjetet sociale i përdorin të dhënat e tyre personale me përgjegjësi, pra, e mbrojnë privatësinë e tyre. Ky sondazh u zhvillua përpara zbulimit të skandalit të *Cambridge Analytica*, i cili ndezi një debat global mbi sasinë e madhe të të dhënave personale, që kompani si Google apo Facebook posedojnë dhe për mënyrat se si ato përdoren për fitime komerciale. Rreth 46 përqind e të rinjve nuk kanë besim ose kanë fare pak besim te rrjetet sociale në lidhje me të dhënat e tyre. Rreth një e katërta i beson shumë ose plotësisht, ndërkohë që 29 përqind ndihen deri diku besues, por jo plotësisht. Femrat duken më skeptike sesa meshkujt për këtë çështje.

## VËZHGIME RRETH NGJARJEVE KRYESORE TË JETËS

Të rinjtë në Shqipëri, si dhe të rinjtë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e marrin eksperiencën e parë në një punë të përkohëshme më vonë se sa bashkëmoshatarët në Perëndim, të cilët, zakonisht e marrin një përvojë të tillë në një punë part-time gjatë pushimeve të verës ose në forma të ndryshme punësimi të përkohshëm.


Të rinjtë, që kanë nivele më të larta arsimore priren ta fillojnë jetën bashkëshortore, të martohen dhe të bëhen prindër rreth 3–4 vite më vonë se sa të rinjtë, që e ndërpresin arsimin në nivele më të ulëta. Nga ana tjetër, të rinjtë që kanë nivele më të ulëta arsimore fitojnë më shpejt pavarësi ekonomike, sepse fillojnë një punë të rregullt me kohë të plotë për të përballuar pagesën e qerasë ose të kredisë për shtëpi, ndërkohë që të rinjtë e tjerë, që vazhdojnë shkollën vijnë në mbështetjen, kryesisht, prej prindërve.

Mosha mestare e vajzave në Shqipëri, që martohen dhe që bëhen nëna, është ende e re. Është interesante se në këtë aspekt nuk ka ndryshime të theksuara moshore midis zonave urbane dhe atyre rurale sikundër ka qenë në të kaluarën.


Të dhënat tregojnë se për të rinjtë në Shqipëri të jetosh me partnerin do të thotë de fakto të martohesh.<sup>4</sup>

Përqindja e të rinjve mbi 25 vjeç, që e kanë zgjidhur problemin e strehimit, është 44 përqind, ndërkohë që të punësuar janë 55 përqind e tyre.

**FIGURA 2: Keni akses të rregullt interneti (përfshi: Wi-Fi, smart-phone, publik, PC ...)?**



**FIGURA 3: Sa shpesh e përdorni internetin për qëllimet e mëposhtme?**




## BUXHETI MUJOR: SHPENZIME PËRTEJ MUNDËSIVE

Dy të tretat e të rinjve shqiptarë, besojnë se kanë po aq para për nevojat e tyre personale sa ç'kanë edhe moshatarët e tjerë. Për këtë arsye ata ndihen si të barabartë në shoqëri, pra në grup-moshën e tyre. Kjo është një dukuri kontradiktore me realitetin në vend, ku pabarazia ekonomike është gjithnjë në rritje. 10 përqind e

ndejnë veten të privilegjuar, duke menduar se kanë më shumë para për të shpenzuar se sa moshatarët, ndërkohë që 24 përqind të tjerë thonë se kanë më pak para se sa moshatarët e tyre.

Sigurisht, nevojat e të rinjve për shpenzime nuk përfshijnë vetëm ato që bëhen për ushqimin, pagesën e shkollës, për ilaçe, udhëtime etj. Duke i shmangur këto, kemi selektuar tre kategori të zakonshme shpenzimesh, që janë: frekuentimi i kafeneve/bareve/kinemave pra I aktiviteteve, ku të rinjtë dalin vetëm ose me

FIGURA 4: Përafërsisht, sa miq keni në rrjetin social që përdorni më shpesh?



miqtë; blerja e rrobave dhe blerja e përdorimi i celularëve. Nga të dhënat rezultojnë se për të tilla shpenzime të rinjve u duhet një buxhet mujor prej rreth 13,800 lekë ose, ndryshe, 105 euro. Pjesa më e madhe e kësaj shume, rreth 60 përqind, nevojitet për blerjen e rrobave, këpucëve etj., që kanë dhe kosto më të lartë.

Por në masën e këtij buxheti mujor ka një ndryshim të vogël mes femrave dhe meshkujve, ku të parat raportojnë një buxhet të nevojitur rreth 1000 lekë (7-8 euros) më pak se meshkujt. Ndryshimet më të mëdha, në fakt, vërehen mes disa zonave urbane dhe

rurale. Të parët thonë se kanë nevojë për një buxhet më të lartë, afërsisht 15,000 lekë, ndërkohë që të dytët ndjehen mirë me rreth 12,000 lekë.

Mundësitë familjare ekonomike diktojnë edhe buxhetin e shpenzimeve. Të rinjtë nga familjet më të varfëra shpenzojnë pak më pak se sa 10,000 lekë në muaj, ndërkohë që të tjerë që kanë mundësi më të mëdha ekonomike, e kalojnë shifrën e 18,000 lekëve në muaj.

TABELA 2: Ngjarjet kryesore të jetës

Ngjarja	Mosha	Meshkuj	Femra	Arsim fillestar	Arsim i mesëm	Arsim universitar
Përmbyllja e arsimit të detyrueshëm	18	18	18	15	18	22
Lënia e shkollës	17	17	16	15	19	19
Fillimi i një pune të përkohshme	18	17	19	16	18	19
Fillimi i një pune të rregullt	20	20	21	18	19	22
Lëvizja nga shtëpia e prindërve	20	19	20	18	20	21
Pagesa e qerasë/ kreditës për shtëpi	20	20	21	19	20	21
Fillimi i jetës me partnerin	21	22	21	19	21	23
Martesa	21	23	21	19	21	23
Fëmija i parë	22	24	22	21	22	24

TABELË 3: **Monedha LEK**

Për frekuentimin e bareve, restoranteve, kinemave etj.	4,915
Për të blerë rroba, këpucë etj.	5,625
Për të blerë karta tel celular ose paguar faturën e celularit.	1,164
Të tjera	2,031
<b>TOTALI</b>	<b>13,736</b>

Ky buxhet mujor i nevojitur është mjaft i lartë i krahasuar me rrogat mesatare në Shqipëri të cilat nuk e kalojnë shifrën prej rreth 400 euro në muaj.<sup>5</sup>

## PËRFUNDIME

Administrata shtetërore aktuale e prezantoi projektin e shkollave si qendra multifunktionale të hapura për komunitetin dhe pasditëve me shumë fanfarë. Fatkeqësisht, ky projekt u bë realitet vetëm në pak raste dhe këto në zona urbane. Duke ekzaminuar të dhënat tona në këtë kapitull, vihet re qartë nevoja për të pasur më shumë mundësi për një jetë sociale cilësore sidomos për vajzat e reja në fshat, ndaj ky program duhet të marrë sërish jetë dhe të shtrihet dhe në zona rurale, duke qenë se ka potencial të madh ndryshimi.

Progame për sipërmarrjen dhe për njohjen e shfrytëzimin më të mirë të botës dixhitale do të ishin shumë të nevojshme për të rinjtë. Këta duhet të aftësohen për të përdorur internetin edhe për qëllime më utilitare si asistenca për arsimim, punësim, por dhe për angazhimin social/ qytetar. Të rinjtë kalojnë orë të tëra duke folur ose duke kontrolluar mediat sociale, ndërkohë që koha e tyre online me përdorim konstruktiv është shumë e kufizuar.

Është e nevojshme të pasurohen e përditësohen programet e planifikimit familjar që ato t'ju shërbejnë më mirë të rinjve, sepse vihet re që ende moshë kur ata martohen dhe bëjnë fëmijë është më e vogël se sa moshë kur fillojnë punën e parë apo kanë mundësinë të kenë një banesë.







## 4


# VLERAT, FEJA DHE BESIMI

- Të rinjtë janë në përgjithësi shumë më optimistë për të ardhmen e tyre, por mjaft skeptikë për të ardhmen e shoqërisë shqiptare.
- Shqetësimet dhe frikërat kryesore të të rinjve shqiptarë janë: të jesh i varfër, i papunë dhe viktimë e korrupsionit.
- Të rinjtë kanë besim te familjet e tyre, por, pothuajse nuk besojnë te askush tjetër.
- Brezi i ri në Shqipëri po tregon gjithënjë e më shumë shenja të pranimit dhe të tolerimit të praktikave jologjore dhe jolegjitime, sidomos, për të zgjidhur probleme personale dhe për të gjetur një punë.
- Shumica e të rinjve shqiptarë më shumë sesa 62 përqind, kur pyeten a identifikohen me një nga besimet kryesore fetare në vend, ata pranojnë se Zoti ka një vend të rëndësishëm në jetën e tyre. Megjithatë, në rininë shqiptare, feja është ende një element identifikimi dhe ndjesish shpirtërore, tradicionale e familjare se sa një set praktikash dhe ritualesh. Më pak se sa 15 përqind e të rinjve ndjekin rregullisht ritet fetare.
- Vlerat dhe optimizmi

Si në vitet e kaluara edhe tashmë të rinjtë shqiptarë tregojnë një set vlerash konservatore dhe tradicionale, si dhe një mungesë interesi për të qenë aktivë në çështje qytetare. Përveç të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme, i cili për arsye personale është mjaft i rëndësishëm, për ta janë shumë të rëndësishme edhe besnikëria ndaj miqve, partnerëve dhe punëdhënësve, si dhe të pasurit e një karriere të suksesshme. Të gjitha këto vlera marrin 4.8 dhe 4.7 nga 5 pikë të mundshme, duke treguar rëndësinë e konsiderueshme që ato kanë për të rinjtë. Femrat, më shumë se sa meshkujt, e konsiderojnë karrierën e suksesshme si shumë të rëndësishme. E njëjta gjë vlen edhe për rëndësinë e marrjes së

diplomës universitare. Femrat kanë një diferencë prej 10–15 pikësh në vendosjen e rëndësisë maksimale për çështjet e arsimimit dhe suksesit profesional.

FIGURA 5: Sa të rëndësishme janë sjelljet e mëposhtme për ju?



Në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 nënkupton "Aspak" dhe 5 nënkupton "Shumë e rëndësishme"

Edhe në sondazhet e viteve të kaluara dëshmohej se marrja e përgjegjësisë është një vlerë konsistente për të rinjtë. Këtë vit ajo merr një vlerësim prej 4.7 nga 5 që është maksimalja.

Martesa dhe të pasurit fëmijë është e rëndësishme si për meshkujt dhe për femrat. Fakt interesant është se pasja e fëmijëve konsiderohet më e rëndësishme edhe se martesa.

Një rezultat interesant vihet re në vlerësimin e dhënë për të dukurit bukur dhe të veshurit me firma të njohura. Këtu shikohet se konsideratat e meshkujve për këto aspekte janë, së paku, të barabarta dhe, në disa raste, edhe më të mëdha se të femrave.

Angazhimi në politikë dhe në aksione të ndryshme qytetare listohen ndër gjërat më pak të rëndësishme për të rinjtë, duke treguar, në njëfarë mënyre, zhgënjimin e tyre ndaj jetës publike në Shqipëri.

## KËNAQËSIA ME JETËN, SHQETËSIMET DHE PERSPEKTIVA E SË ARDHMES

Të rinjve iu është kërkuar të shprehin nivelin e kënaqësisë së tyre me jetën personale dhe profesionale. Të rinjtë duken se janë shumë të kënaqur me jetën e tyre familjare (4.7/5) dhe të kënaqur me grupin e miqve dhe të shokëve të tyre. Lidhur me kënaqësinë për jetën në shkollë dhe në punë, jepen respektivisht vlerësimet 3.9 dhe 3.6. Kur flasin në përgjithësi për kënaqësinë nga jeta niveli është pozitiv në vlerën 4.3/5. Diferencat më të mëdha brenda grupit të të rinjve, përsa i përket kënaqësisë me jetën, lidhen me statusin ekonomik familjar. Të rinjtë nga familjet me më pak mundësi ekonomike shprehin një

pakënaqësi më të madhe për jetën, se sa ata nga familje në gjendje më të mirë ekonomike.

Të rinjtë janë shumë optimistë në pritshmëritë për jetën e tyre personale në të ardhmen. 87 përqind prej tyre, një maxhorancë e konsiderueshme, raportojnë se e ardhmja do të jetë shumë më e mirë, ndërkohë që 9 përqind mendojnë se do të qëndrojnë në vend dhe vetëm një grup prej 2 përqind presin që të përkeqësohet. Këto numra janë pothuajse të pandryshuara, që nga vlerat e vitit 2014.

Megjithatë, kur shprehin pritshmëritë e tyre për të ardhmen e Shqipërisë dhe të shoqërisë së saj në tërësi, të rinjtë janë shumë më pak optimistë. 55 përqind e tyre presin që situata të përmirësohet, ndërkohë që 23 përqind mendojnë se asgjë nuk do të ndryshojë. Një tjetër grup prej 15 përqind mendojnë, madje, se gjërat do të përkeqësohen në Shqipëri. Në grupin e atyre që janë më optimistë për të ardhmen e vendit dallohen, sidomos, të rinjtë që banojnë në zonat jugore.

Të rinjtë janë shumë të qartë kur marrin parasysh frikërat dhe shqetësimet e tyre më të mëdha, në identifikimin e faktorëve, që çënojnë standartet e tyre të jetesës dhe, më konkretisht, gjendjen e tyre ekonomike. Kështu tre shqetësimet kryesore që trembin të rinjtë janë: **të jenë të varfër, të jenë të papunë dhe të jenë ndikuar negativisht nga korrupsioni. Në tre treja këto skenare të rinjtë thonë se janë shumë të frikësuar nga këto situata, në se do të ndodhnin në jetën e tyre.**

Këto shqetësime kryesore pasohen nga frikërat dhe shqetësimet, që lidhen me ndotjen dhe ndryshimet klimaterike, me padrejtësinë shoqërore si dhe me sëmundjet. Të rinjtë nuk duket se i frikëson shumë dhuna dhe grabitja, megjithatë, ka ndryshime të ndieshme midis femrave dhe meshkujve. Të parat

FIGURA 6: Si e shihni të ardhmen tuaj pas 10 vitesh?




FIGURA 7: Si e shihni të ardhmen e Shqipërisë në përgjithësi?





FIGURA 8: Në ç'masë ju trembin të mëposhtmet?




raportojnë në numra më të mëdhenj se kanë frikë nga dhuna dhe grabitja.

Të rinjtë në Shqipëri, që kanë jetuar më së shumti në një kohë paqeje dhe nuk janë ekspozuar ndaj valëve të mëdha migtarore ose të refugjatëve nuk ndjejnë frikë nga këto situata. Nivelet minimale të frikës raportohen për konfliktet e dhunshme dhe luftën, sulmet terroriste ose nga prania e shumë emigrantëve në Shqipëri. Këto dukuri për shumicën e tyre mbeten krejtësisht hipotetike.

Hierarkia e frikërave dhe rëndësia që u kushtohet atyre duket e pandryshuar që nga sondazhi i vitit 2014, ku situatat negative ekonomike ishin përsëri në krye të listës ndërkohë që shqetësimet e lidhura me probleme të sigurisë së vendit ishin shumë të zbehta te të rinjtë.


Të rinjve iu kërkua të tregonin në se situata të ndryshme do të ishin të pranueshme e të tolerueshme në një shkallë, ku numri 10 tregon pranueshmëri të plotë. Praktikata informale të përdorura

**FIGURA 9: Për mendimin tuaj, sjelljet e mëposhtme mund të justifikohen gjithmonë, nuk mund të justifikohen kurrë, apo diku ndërmjet?**



Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 nënkupton "Kurrë" dhe 10 nënkupton "Gjithmonë"

**FIGURA 10: Sa besim keni tek personat e mëposhtëm?**



Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 nënkupton "Aspak" dhe 5 nënkupton "Shumë"

për të gjetur një punë më të mirë ose për të zgjidhur halle personale kishin një pranueshmëri mesatare të rinjtë me vlera 4.7 dhe 4.6 nga 10 në total. Praktikë informale për të gjetur punë, për të marrë shërbim më të mirë në spitale apo dhe në zyrat e administratës janë shumë të përhapura në Shqipëri. Problemi i korrupsionit të vogël kapilar është po aq i ndieshëm, sa dhe korrupsioni i madh politik. Rreth 20 përqind e të rinjve thanë se ishte gjithnjë e justifikuar që për punësimin të përdoshin lidhjet dhe njohjet personale. Rezultatet konfirmohen edhe nga sondazhe të tjera, që dëshmojnë se Shqipëria, e krahasuar dhe me vende të tjera të rajonit, ka një nivel të lartë tolerance ndaj korrupsionit. Pothuaj gjysma e të rinjve mendojnë se është normale të jepet rryshfet për të pasur shërbime dhe favore të ndryshme.<sup>6</sup>

Në një sondazh të BERZH të vitit 2018, 43 përqind e shqiptarëve thonë se lidhjet politike janë vendimtare për të pasur sukses në jetë. Kjo e vendos Shqipërinë në nivel të ngjashëm me Bosnjen dhe Maqedoninë në rajon.<sup>7</sup> Kjo shkallë tolerance ndaj praktikave të tilla nga brezi i ri është shenjë shqetësuese për të ardhmen. Ajo bëhet akoma më domethënëse, kur krahasohet me grupin e të rinjve, që thonë se një ndër shqetësimet e tyre kryesore është ndikimi nga korrupsioni, pra, që do të preferonin t'i

dilnin përpara këtij rreziku, duke u angazhuar aktivisht në praktika korruptive për të qenë përftues prej tyre.


Mashtrimi me taksat (evazioni fiskal), aborti dhe homoseksualiteti janë tri çështjeve më pak të pranueshme nga të rinjtë ku e treta spikat me shkallën më të ulët prej 2.4 nga 10. Çuditërisht rryshfeti, që lidhet drejtpërdrejt me korrupsionin, merr 2.8 nga 10 pikë të mundshme, ndërkohë që në studimin e vitit 2016 në lidhje me korrupsionin në rreth 40 përqind e shqiptarëve të pyetur kanë pohuan se kishin dhënë një rryshfet, kurse 16 përqind të tjerë kanë thënë se kishin bërë një shërbim ose favor të caktuar në mënyrë jozyrtare.<sup>8</sup>

## BESIMI DHE KOMUNITETI

Dhe në studimet e mëparshme, vihet re se anëtarët e familjes kanë besimin e plotë të të rinjve, duke u vlerësuar me 4.9 në një shkallë, ku maksimalja është 5. Kjo shkallë besimi diferencon tepër me besimin të të gjitha kategoritë e tjera. Vlerësimi i besimit për të afërmit vjen i dyti pas familjes me 3.8, kurse për miqtë në 3.6 nga 5. Të rinjtë vazhdojnë të kenë shumë pak besim të shokët e klasës apo të kolegët e punës, të cilët marrin vetëm vlerësimin

2.9. I njëjti vlerësim bëhet edhe për besimin ndaj personave me fe të ndryshme.

Shkalla më e lartë e mosbesimit shfaqet për njerëz me bindje të ndryshme politike si dhe për fqinjët, të cilët marrin një vlerësim prej 2.2 nga 5. Të fundit fare për nga besueshmëria janë liderët politikë, që marrin një vlerësim më të ulët se sa 2, të të rinjve nga lidershipi politik i vendit.



Për të mësuar mbi stereotipet dhe përvojat me veprime diskriminuese, të rinjtë janë vënë përballë një skenari të thjeshtë hipotetik, ku duhet të vlerësojnë: ardhjen pranë shtëpisë së tyre si fqinj të një individi apo të disa të tjerëve me karakteristika të caktuara.


Të rinjtë pohojnë se do të ndiheshin më keq nëse do të vinin si fqinjë njerëz të varur nga droga, çiftet homoseksuale apo njerëz që kanë qenë në burg. Këto tre kategori vlerësohen afërsisht me 2 nga 5 maksimalja. Një familje rome merr një vlerësim mesatar 3.6, ndërkohë që një familjeje refugjatësh si fqinjë merr vlerësimin 3.9. Vlen të theksohet se skenari me refugjatët mbetet i sprovuar në realitet, ndërkohë që të tjerat kanë lidhje me eksperiencën të përditshme. Të rinjtë nuk do të kishin asnjë problem me ardhjen pranë tyre të kategorive që vlerësohen mbi shifrën 4: pensionistë, studentë, familje me shumë fëmijë apo familje nga Evropa Perëndimore.

Të pyetur nëse vetë ata janë ndjerë të diskriminuar apo janë trajtuar në mënyrë diskriminuese ndonjëherë, të rinjtë në Shqipëri duken mjaft të privilegjuar sepse raportojnë nivele shumë të ulëta të eskperiencave të tilla. Edhe këto raportime tregojnë një frekuencë mesatare ose të ulët të diskriminimit.

Vetëm 12 përqind e femrave pranojnë se kanë ndjerë në vazhdimësi diskriminim gjinor, kurse shumica pohojnë se e kanë ndjerë këtë diskriminim me raste dhe jo gjithmonë. 16 përqind e të rinjve thonë se kanë qenë subjekt diskriminimi për shkak të statusit të tyre ekonomik, ku vlerat maksimale raportohen nga të rinjtë më të varfër. Plot 28 përqind e këtyre të fundit kanë pasur një përvojë të tillë diskriminuese. Megjithatë, ironik mbetet fakti që edhe 11 përqind e të rinjve nga pjesa më e pasur po ashtu raporton një

diskriminim të ngjashëm. Diskriminimi me bazë të prejardhjes krahinore apo të nivelit të arsimit mbetet fare minimal ku jo më shumë se 7–8 përqind e të pyeturve e përmendin si diçka të përjetuar me raste. Sipas vetë deklarimeve të të rinjve duket se në Shqipëri nuk ekziston diskriminimi me bazë krahinore apo fetare.

## FEJA DHE PRAKTIKIMI I SAJ




Shumica e të rinjve shqiptarë e identifikojnë veten si myslimanë, rreth 69 përqind. Kjo është një shifër pak më e ulët sesa në vitin 2014, kur u regjistruan 76 përqind si të tillë. Komuniteti i të rinjve katolikë dhe ortodoksë vinë në vendin e dytë për nga numrat me 12 dhe 10 përqind respektivisht. Një grup prej 4 përqind thonë se janë të sektit Bektashi.

Të pyetur mbi rëndësinë që ka Zoti në jetën e tyre, 62 përqind e të rinjve thonë se ka shumë rëndësi. Këtë e pohojnë mbi 70 përqind e femrave dhe 56 përqind e meshkujve. 9 përqind e të rinjve i japin Zotit njëfarë rëndësie në jetën e tyre, ndërkohë që 3–4 përqind nuk e vlerësojnë fare.

Edhe në vitin 2017–2018, vihet re se besimi fetar te të rinjtë shërben më shumë si një mjet identifikimi dhe përkatësie, familjare e tradicionale, se sa një element që orienton të rinjtë të ndjekin ritet dhe shërbesat fetare.


Të pyetur mbi shpeshësinë e ndjekjes së ritualeve fetare (*përveç dasmave dhe funeraleve*), 30 përqind e të rinjve thonë se nuk i ndjekin kurrë, ndërkohë që një tjetër grup prej 17 përqind thonë se i ndjekin maksimumi një herë në vit. Një e treta e të rinjve, rreth 34 përqind, i ndjek ritet fetare dhe viziton vendet përkatëse me

FIGURA 13: Sa i rëndësishëm është Zoti në jetën tuaj?



Ju lutem, përdorni këtë shkallë si vlerësim: 10 nën kupton "Shumë i rëndësishëm" dhe 1 nënkupton "aspak i rëndësishëm"

FIGURA 14: Përpos dasmave dhe funeraleve, sa shpesh i ndiqni shërbesat fetare këto ditë?



%

■ Praktikisht kurrë      ■ Vetëm në festa të posaçme      ■ Mbi njëherë në javë  
■ Më pak se njëherë në vit      ■ Rreth njëherë në muaj      ■ Nuk e di  
■ Rreth njëherë në vit      ■ Rreth njëherë në javë      ■ Pa përgjigje



rastin e festave kryesore fetare, ndërkohë që vetëm 12 përqind i ndjek shërbimet dhe ritet fetare rregullisht çdo javë.

Këto të dhëna janë të afërta me ato të vitit 2014, ku, po ashtu, 23 përqind e të rinjve thanë se nuk e praktikojnë fenë e tyre, ndërkohë që, 61 përqind thanë se e bëjnë këtë vetëm gjatë festave (në atë vit nuk u veçuan nga ritet fetare ritualet në dasma e funeralet).

Të dhënat që disponojmë tregojnë se një e treta e të rinjve luten. Kjo tregon se feja dhe besimi në Zot janë më shumë çështje personale të brendshme shpirtërore për të rinjtë, se sa një stil jetese që sundohet nga ritet. Një tjetër sondazh global tregon se Shqipëria rendit mes vendeve më pak fetare, me vetëm 39 përqind të të rinjve që pohojnë se e ndjekin fenë e tyre.<sup>9</sup>

Të pyetur mbi prindërit, 48 përqind e të rinjve thonë se prindërit janë mesatarisht ose dhe shumë fetarë ndërkohë që 23 përqind thonë se feja e prindërve është në nivel të moderuar. Rreth 28 përqind thonë se prindërit nuk janë fetarë. Prezenca dhe rëndësia e fesë në familjet shqiptare dhe, si pasojë, rëndësia specifike e saj për të rinjtë është ende një çështje në zhvillim. Kjo vjen për shkak se shumica e prindërve të tyre e kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës në sistemin komunist, ku feja ndalohej plotësisht.

## PËRFUNDIME

Për shumë të rinj në Shqipëri ka më shumë rëndësi të duken bukur dhe të vishen firmato, se sa të angazhohen në çështje sociale apo politike. Niveli i çdo forme besimi jashtë bërthamës familjare është pothuajse zero. Në të njëjtën kohë po rritet toleranca dhe pranueshmëria e praktikave ligjore si përdorimi i të njohurve dhe i favoreve jozyrtare për të zgjidhur probleme personale dhe, sidomos, për t'u punësuar. Të rinjtë e shohin të ardhmen e tyre personale shumë më me optimizëm se sa të ardhmen kolektive të shoqërisë.

Angazhimi në çështje sociale, duke filluar nga forma më e thjeshtë si vullnetarizmi, duhen mësuar dhe inkurajuar në ato platforma dhe mjedise, ku ka më shumë shanse të ketë sukses, siç janë shkollat. Meritokracia po zhduket si vlerë në Shqipëri, sepse është më e vështirë të mësohet, në se nuk praktikohet gjerësisht nga institucionet. Dobësimi nga moszbatimi institucionalisht i meritokracisë po shndërrohet në model për të rinjtë që ankohen por nuk kanë të dëshirë të angazhohen për ndryshim dhe që mund të shdërrohen në qytetarë të ardhshëm pasivë. Këto janë rreziqe reale dhe madhore për demokracinë dhe zhvillimin e një vendi si Shqipëria, e cila ende duhet të përmbyllë një trancizion të vështirë në të dyja drejtimet.



## 5

# FAMILJA DHE SHOQËRIA

## GJETJET KRYESORE

- 82 përqind e të rinjve vazhdojnë të ruajnë prirjen e jetesës bashkë me prindërit.
- 58 përqind e të rinjve pohojnë se do të rrisnin fëmijet e tyre në të njëjtën mënyrë sesi i kanë rritur ata prindërit
- Rreth 74 përqind pohojnë se vendimet i marrin në bashkëpunim të ngushtë me prindërit
- 88 përqind e shohin të ardhmen e tyre përmes martesës dhe krijimit të familjes.
- 83 përqind e të rinjve vlerësojnë personalitetin e partneritetit si shumë të rëndësishëm.
- 64 përqind pohojnë se të kesh shumë shokë është mjaft e rëndësishme për një jetë të lumtur.
- 90 përqind e të rinjve të shtresave shumë të pasura pohojnë se kanë shoqëri me shokë apo shoqe që vijnë nga shtresa të tjera sociale

## ANALIZA E DETAJUAR E REZULTATEVE

### 1. Marrëdhënia me prindërit dhe familjen



Sipas të dhënave të studimit të rinjtë shqiptarë **vazhdojnë të ruajnë prirjen e jetesës bashkë me prindërit** në një shtëpi. 82 përqind tyre kanë pohuar se jetojnë bashkë me prindërit. Kjo shifër shënon një rritje në krahasim me vitin 2015, kur ishte 80 përqind.<sup>10</sup> Në prirjen për të jetuar me prindërit nuk ka dallime mes zonave urbane e rurale. 1 përqind e të rinjve të pyetur jetojnë vetëm dhe 3 përqind me shokët, duke dëshmuar se rinia shqiptare vazhdon të ndjekë qasjen tradicionale në këtë drejtim. Edhe 84 përqind e të rinjve, që vijnë nga shtresat e pasura, me mundësi të mira ekonomike, jetojnë me prindërit e tyre në të

njëjtën shtëpi, duke e shndërruar këtë dukuri në një stereotip social.

Në shumicën e të rinjve të intervistuar **madhësia mesatare e familjes së tyre** nuk i kalon 4 persona, ndërkohë që në zonat rurale ky numër arrin deri në 5. 95 përqind e të rinjve pohojnë se jetojnë me të dy prindërit, gjë që vlerësohet si faktor i rëndësishëm për qetësinë e tyre emocionale.

Përveç jetesës në një shtëpi me prindërit, një pjesë e të rinjve shqiptarë përjetojnë eksperiencat e jetës së pavarur. 6 përqind e tyre deklarojnë se jetojnë vetëm ose me partnerin/partneren në një shtëpi të blerë. Kjo prirje, që arrin në 12 përqind për femrat dhe në 1 përqind për meshkujt, është e ndjeshme te grup-mosha e të rinjve 26–29 vjeç, që është faza e krijimit të lidhjeve të qëndrueshme dhe e qasjes drejt një jete të pavarur mes partnerëve. 4 përqind e të rinjve jetojnë në një shtëpi /apartament me qera, që e paguajnë vetë. Në këtë kategori mbizotërojnë të rinjtë nga Tirana me 13 përqind, përkundër 4 përqind nga qytetet e tjera. Është për t'u veçuar fakti se asnjë prej të rinjve të intervistuar nuk jeton në konviktet studentore. Kjo dëshmon se, përveç kushteve të papërshtatshme të konvikteve, të rinjtë studentë nga qytete të ndryshme duan të përjetojnë jetën urbane.

Përtej dëshirës për jetë të pavarur, 78 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë **se jetesa bashkë me prindërit është më e përshtatshme** për ata, duke shënuar një rritje në krahasim vitin 2015, kur kjo shifër ishte 70 përqind.<sup>11</sup> Vetëm 17 përqind e të rinjve pohojnë se do të jetonin më vete nëse kushtet financiare do ta lejonin. Diferenca e madhe mes këtyre shifrave pasqyron frikën e pasigurinë e të rinjve shqiptarë për modelin e “jetës së pavarur nga prindërit” për shkak të traditës, kujdesit që ka familja shqiptare dhe kushteve të paqëndrueshme social-ekonomike në një ekonomi të vogël si Shqipëria. Përqindjen më të ulët në këtë prirje e kanë të rinjtë e moshës 22–25 vjeç me 66 përqind, gjë e

FIGURA 15: **Ku jetoni?**FIGURA 16: **Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë situatën tuaj?**

cila lidhet me periudhën e pas studimeve universitare, kur të rinjtë kërkojnë të gjejnë identitetin e tyre social e profesional përmes jetës së pavarur nga prindërit

60 përqind e të rinjve pohojnë se nuk kanë probleme dhe kanë marrëdhënie shumë të mira me anëtarët e familjes. Të dhënat dëshmojnë se 63 përqind e djemve, përkundër 56 përqind të femrave. Ky dallim lidhet me faktin se familja tradicionale shqiptare ushtron një kontroll më të madh mbi vajzat, duke u bërë shkak

për kontradikta. Këtë e dëshmojnë të dhënat; 43 përqind e femrave të intervistuar pohojnë se kanë disa kontradikta me familjen, përkundër 35 përqind të djemve. 53 përqind e të rinjve nga zonat urbane pohojnë se kanë disa kontradikta me prindërit, kurse në fshat kjo shifër arrin në 33 përqind, gjë që tregon se bindja ndaj autoritetit të familjes në zonat rurale është më i fortë.

Megjithatë, një element që vërteton "modelin e fortë" të familjes të të rinjtë është fakti se 58 përqind e tyre janë përgjigjur

FIGURA 17: Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë marrëdhënien tuaj me prindërit?





FIGURA 18: Do t'i rrisnit fëmijët tuaj ashtu siç ju kanë rritur ju prindërit, apo do t'i rrisnit ndryshe?



se do të rrisnin fëmijet e tyre në të njëjtën mënyrë si edhe prindërit e tyre i kanë rritur ata. Vetëm 30 përqind e tyre pohojnë se do t'i rrisnin ndryshe fëmijët e tyre. Roli i këtij modeli trashëgohet dhe dallimet janë të pakta mes zonave urbane e rurale, duke dëshmuar një prirje në nivel kombëtar.

**Procesi i vendimarrjes** te të rinjtë karakterizohet nga bashkëpunimi i tyre i ngushtë me prindërit. Rreth 74 përqind e tyre pohojnë se vendimet i marrin në bashkëpunim të ngushtë me

prindërit. Në këtë çështje, të rinjtë e zonave urbane e rurale nuk kanë dallime. Në krahasim me 67.5 përqind sipas studimit të vitit 2015, të rinjtë nga Tirana kanë arritur në 74 përqind. Familja e ushtron rolin vendimtar në procesin e vendimarrjes së të rinjve shqiptarë në vartësi të peshës së babait apo të nënës brenda saj. 57 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se babai ka më shumë ndikim në vendimet e të rinjve. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015, kur kjo shifër ishte 61.5 përqind, vihet re në rënie e lehtë e

rolit të babait në vendim-marrje.<sup>12</sup> Për shkak të lidhjeve gjinore 66 përqind e meshkujt pohojnë se është babai që luan rol në vendim marrjet e tyre, përkundër 46 përqind e femrave. Rreth 50 përqind e të rinjve pohojnë ndikimin e rolit të nënës në vendim-marrje. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015 vërehet një rritje e rolit të nënës te vajzat për vendim-marrjen e tyre nga 29.9 përqind në 54 përqind. Nënmat ushtrojnë më shumë ndikim tek të rinjtë e zonave urbane ku

56 përqind e tyre pranojnë këtë rol përkundër 47 përqind të atyre rurale. Kjo diferencë lidhet me peshën më të madhe të rolit të babait në familjen rurale, që është pjesë e traditës.

Vetëm 5 përqind e të rinjve pohojnë për ndikimin e vëllait apo të motrës në vendim-marrje. Edhe pjesëtarët e tjerë të familjes, si gjyshi e gjyshja, kanë një ndikim të papërfillshëm, vetëm 1 përqind e të rinjve e pranojnë rolin e tyre në vendim-marrjet e rëndësishme.

FIGURA 19: Cili mes pjesëtarëve të familjes apo të njohurve tuaj ka më shumë ndikim mbi vendimet tuaja të rëndësishme?




FIGURA 20: Kanë ndikim prindërit mbi vendimet e rëndësishme në jetën tuaj?





FIGURA 21: Si e shihni veten në të ardhmen?



Një fakt interesant është se miqtë nuk ushtrojnë asnjë ndikim në vendimmarrjet e të rinjve, gjë që tregon rolin e madh të faktorëve të tjerë. Vetëm 8 përqind e të rinjve pohojnë se vendosin në mënyrë të pavarur.

74 përqind e të rinjve të intervistuar i marrin vendimet më të rëndësishme në jetë bashkërisht me prindërit. 36 përqind e grupmoshes së të rinjve 26–29 vjeç i merr këto vendime në mënyrë të pavarur. Të rinjtë e zonës juglindore kanë një prirje më të lartë me 24 përqind për të vendosur çdo gjë me prindërit.


## MARTESA DHE LIDHJA NË ÇIFT

Martesa është një institucion dhe vlerë e qëndrueshme për të rinjtë shqiptarë. Këtë e dëshmon fakti, se nga të rinjtë e intervistuar 88 përqind e tyre e shohin të ardhmen përmes martesës dhe krijimit të familjes, që shënon një rritje në raport me të dhënat e studimit të vitit 2015, ku kjo shifër ishte 80 përqind.<sup>13</sup> Në këtë pikë dallimet gjinore për vlerën e institucionit të martesës janë të papërfillishme: (86 përqind e djemve dhe 88 përqind të vajzave).

Rreth 86 përqind e të rinjve të intervistuar kanë qenë me status beqar dhe vetëm 11 përqind të martuar dhe mbështetja për institucionin e martesës, si perspektivë e jetës së tyre, tregon se ata duan të ndjekin traditën. Kjo prirje dëshmohet edhe nga fakti se 78 përqind e të rinjve janë përgjigjur se e shohin lidhjen në çift si diçka shumë të rëndësishme për një jetë të lumtur.

Jetesa në një vend të mirë përbën një kusht për jetën e lumtur dhe 83 përqind e konsiderojnë shumë të rëndësishme këtë element të domosdoshëm për mirëqenien shpirtërore.


FIGURA 22: Cili është statusi juaj aktual?



Mosha më e mirë për martesë të vajzave konsiderohet vitet 25–26 vjeç. Në këtë drejtim nuk vihet re dallim mes të rinjve të zonave urbane apo rurale edhe në shtrirjen e tyre gjeografike. Ky fakt tregon mbizotërimin e piskologjisë tradicionale që vajzat e kësaj grupmoshe, duke përfshirë ato të ciklit universitar duhet të zgjedhin martesën.

Shumica e të rinjtë të intervistuar janë shprehur se mosha më e mirë për martesë e meshkujve është 28–29 vjeç. Në këtë rast opinioni i të rinjve ndjek prirjen tradicionale të shoqërisë shqipta-

FIGURA 23: Për mendimin tuaj, sa të rëndësishëm janë faktorët e mëposhtëm për një jetë të lumtur?



re që meshkujt duhet të kenë një moshë martesë më të madhe se vajzat për shkak të rolit së mashkullit brenda familjes. Në të gjitha shtresat e të rinjve të intervistuar mbizotëron ky përcaktim i moshës për martesë cka tregon gati shndërrimin e tij në normë sociale për shoqërinë shqiptare.

Rëndësia e familjes për të rinjtë përforcohet nga lidhja e lumturisë së tyre me lindjen e fëmijëve. 82 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se fëmija është shumë e rëndësishme për një jetë të lumtur. Përsa i përket numrit të fëmijëve që do të dëshironin të kishin në familjet e tyre, shumica e të rinjve të intervistuar pohojnë se do të donin të lindnin 2 fëmijë. Statistikat nuk tregojnë dallime mes të rinjve të zonave urbane apo rurale lidhur me numrin e fëmijëve, që do të dëshironin të kishin. Në dallim nga studimi i vitit 2015, të dhënat tregojnë se të rinjtë e të gjitha shtresave sociale në gjithë vendin kanë përcaktuar si numër magjik “2-in” e fëmijëve për një familje, duke synuar një të “mesme të artë” që garanton stabilitet social ekonomik<sup>14</sup>

Shumica e të rinjve të intervistuar kanë pohuar që do të dëshironin fëmijën e parë ta lindin në moshën 27 vjeç. Femrat janë përgjigjur se do të parapëlqenin në moshën 26 vjeç, ndërsa meshkujt 29 vjeç. Ngurrimi i meshkujve për t’u bërë prindër në një moshë më të herëshme lidhet me modelin tradicional të familjes shqiptare, ku pesha më e madhe e kontributi ekonomik në familje anon nga babai.

Për të rinjtë janë shumë të rëndësishme vlerësimi dhe pesha e elementëve të veçantë, kur zgjedhin partnerin e tyre.

Kur të rinjtë janë pyetur lidhur me rëndësinë e përkatësisë fetare të partnerit, 52 përqind e tyre janë përgjigjur se këtë nuk e konsiderojnë fare të rëndësishme. Te 19 përqind e të rinjve, që e konsiderojnë shumë të rëndësishëm këtë element, 25 përqind e tyre janë nga zonat rurale, ku, për shkak të komuniteteve të vogla identiteti fetar është më i dukshëm.

Gjendja ekonomike e partnerit është element që ndikon në zgjedhjen e tij. Por vetëm 22 përqind e të rinjve të intervistuar e konsiderojnë atë shumë të rëndësishme, kur vendosin të lidhen me dikë, ndërsa 31 përqind nuk e quajnë fare të rëndësishme. Krahasimi me të dhënat e vitit 2015, kur gjendja ekonomike e partnerit kishte rëndësi për 42 përqind të të rinjve shifrat e mësipërme dëshmojnë se vlera të tjera po marrin përparësi për të rinjtë në lidhje me krijimin e familjes.<sup>15</sup>

Sërish del në pah roli i familjes në përzgjedhjen e partnerit nga të rinjtë shqiptarë. 69 përqind e të rinjve pohojnë se miratimi i

familjes në zgjedhjen e partnerit për martesë është i rëndësishëm dhe shumë i rëndësishëm. Vërehet një ulje e këtij roli në krahasim me të dhënat e studimit të vitit 2015, kur kjo shifër ishte 76 përqind.<sup>16</sup> Kjo dëshmon se të rinjtë po kërkojnë një rol më të pavarur për zgjedhjen e partnerit përtej miratimit të familjes. Te femrat ky rol është sërish më i madh. 58 përqind e tyre pohojnë rëndësinë që ka miratimi nga familja përkundër 46 përqind e djemve. Në zonat veriore miratimi nga familja është 63 përqind, duke dëshmuar qasje më të fortë tradicionale të marrëdhënieve brenda familjes.


Për të rinjtë shqiptarë problemi i virgjërisë së partnerit për martesë është një element, që vazhdon të ketë peshën e vet në këtë vendim marrje. Sipas të dhënave të studimit 44 përqind e të rinjve e konsiderojnë virgjërinë të rëndësishme apo shumë të rëndësishme, ndërsa për 34 përqind të të rinjve nuk ka fare rëndësi. Në krahasim me statistikën e vitit 2015, kur kjo shifër ishte 51.3 përqind, vërejmë se po rritet numri i të rinjve që nuk i kushtojnë më rëndësi aspektit të virgjërisë së partnerit për martesë.<sup>17</sup> Kjo është tregues i çlirimit të të rinjve nga paragjykimet dhe normat sociale tradicionale si rezultat i jetës së çlirët. Këtë e tregon ngushtimi i diferencës gjinore mes vajzave e meshkujve 28 përqind me 38 përqind. Në zonat rurale virgjëria ende vazhdon të konsiderohet një aspekt me rëndësi, 43 përqind e të rinjve në këto zona e vlerësojnë atë shumë të rëndësishme, përkundër 27 përqind të të rinjve në qytet.

Personaliteti i partnerit për martesë është tregues i rëndësishëm për të rinjtë. Në nivel kombëtar 83 përqind e të rinjve të intervistuar e vlerësojnë personalitetin e partnerit si shumë të rëndësishëm. Ndonëse ka një rënie të lehtë të përqindjes së të rinjve, në krahasim me studimin e vitit 2015, ku kjo shifër ishte 95.6 përqind, personaliteti sërish përbën një element bazë për të rinjtë, që garanton martesë të qëndrueshme.<sup>18</sup> Femrat e vlerësojnë me 90 përqind personalitetin e partnerit përkundër 78 përqind të meshkujve, cka dëshmon se për ato qëndrueshmëria e jetëgjatësia e martesës varet nga personaliteti i partnerit të tyre.

59 përqind e të rinjve të intervistuar e konsiderojnë pamjen e jashtme si kusht për zgjedhjen e partnerit të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme. Gjithsesi, në krahasim me të dhënat e studimit të vitit 2015, kur kjo shifër ishte 75 përqind, vërejmë se të rinjtë po e rivlerësojnë rëndësinë e pamjes së jashtme në zgjedhjen e partnerit për martesë në raport me elementë të tjerë.<sup>19</sup>



FIGURA 24: Për mendimin tuaj, cila është mosha më e mirë për tu martuar?



Sërish, femrat e vlerësojnë më pak këtë aspekt, 52 përqind përkundër 66 përqind të meshkujve. Megjithatë, rëndësia e bukurisë fizike për të rinjtë është tipar, që po përforcohet edhe nga ndikimi i rrjeteve sociale.

Një element i rëndësishëm është niveli arsimor dhe roli që ai luan në përzgjedhjen e partnerit për martesë. 70 përqind e të rinjve të intervistuar e vlerësojnë atë si të rëndësishëm e shumë të rëndësishëm. Në këtë rast mbizotërojnë femrat me 60 përqind, përkundër djemve në 42 përqind, çka tregon se niveli arsimor i partnerit për femrat është tregues për marrëdhënie të qëndrueshme.

Interesat e përbashkëta mes dy të rinjve, që lidhen për martesë, janë parakusht për mirëkuptimin e tyre. Për këtë arsye 86 përqind e të rinjve në nivel kombëtar e konsiderojnë të rëndësishme e shumë të rëndësishme që të kenë interesa të përbashkëta. Në këtë rast nuk luajnë rol dallimet apo prejardhjet e ndryshme gjeografike, çka tregon për një prirje të përgjithëshme.

Kombësia e partnerit vlerësohet nga 60 përqind e të rinjve si pak e rëndësishme ose që nuk ka rëndësi fare, çka tregon se hapja e kufijve, lëvizja e të rinjve dhe marrëdhëniet në çift me individë nga vende të ndryshme po shndërrohen në normë sociale në Shqipëri. Për këtë çështje, të rinjtë nga zonat rurale shprehin një përkrahje më të ulët me 44 përqind, përkundër atyre nga qyteti me 57 përqind, duke dëshmuar nivelet të ndryshme mentaliteti.

Koncepti i jetës së lumtur për të rinjtë është një ekuilibër mes dëshirës për familje, për shoqëri të zgjeruar dhe për aspekte të tjerë, që e që kushtëzojnë atë. Larmia e marrëdhënieve shoqërore dhe shmangia e paragjytimeve në krijimin e shoqërisë mes të rinjve janë tregues të rëndësishëm.

Përtej martesës, një element me rëndësi për të rinjtë shqiptarë është shoqëria dhe miqtë. 64 përqind e të rinjve pohojnë se të kesh shumë shokë është shumë e rëndësishme për një jetë të lumtur. 56 përqind e tyre pohojnë se kanë shoqëri me persona, që u përkasin etniteteve të ndryshme, çka tregon një çlirim nga paragjykimet, kurse 43 përqind pohojnë se nuk kanë shoqëri të tillë, gjë që nënkupton nivelin e kontakteve me etnitete të tjera të zonave të ndryshme brenda Shqipërisë. Të rinjtë e zonave urbane kanë 62 përqind shoqëri të tillë, përkundër 48 përqind të atyre të zonave rurale, duke dëshmuar se qytetet kanë një përzierje më të larmishme të grupeve.

Marrëdhëniet shoqërore mes të rinjve nuk ndikohen nga përkatësia fetare, duke dëshmuar tolerancën fetare mes tyre. 85 përqind e të rinjve të intervistuar deklarojnë se kanë shokë apo shoqe me prejardhje të ndryshme fetare. Në Tiranë kjo prirje është më e lartë me 93 përqind, çka tregon se kryeqyteti, me larminë e tij urbane, i rrafshon dallimet.

Një shifër interesante është se 56 përqind e të rinjve në nivel kombëtar pohojnë se kanë shokë që flasin gjuhë të ndryshme nga shqipja. Prania e minoriteteve në disa zona të Shqipërisë, hapja dhe lëvizja e lirë e njerëzve e ka bërë të larmishme tipologjinë e shoqërisë së të rinjve.

Shtresëzimi social është një fenomen që po zhvillohet në shoqërinë shqiptare në forma të ndryshme. Por, 84 përqind e të rinjve të intervistuar deklarojnë se kanë shokë apo shoqe me status të ndryshëm social. Mungesa e paragjytimeve në të këtë rast lidhet me moshën e re dhe dëshirën për një shoqëri të



FIGURA 25 A: **Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju? Etni tjetër**FIGURA 25 B: **Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju? Besim tjetër**

FIGURA 25 C: **Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju? Gjuhë tjetër**





FIGURA 25 D: **Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju? Status social tjetër**



zgjertuar në kushtet e lëvizjeve migratore. Edhe 90 përqind e të rinjve të shtresave shumë të pasura pohojnë se kanë shoqëri me shokë apo shoqe që vijnë nga shtresa të tjera sociale.

## **KONKLUZIONE**

Lidhja dhe marrëdhëniet me familjen vazhdojnë të shfaqen si një tipar i qëndrueshëm i modelit të sjelljes sociale së të rinjve shqiptarë. Kushtet social-ekonomike dhe tradita e këtyre marrëdhënieve në shoqërinë shqiptare veprojnë si faktorë bazë, që këto marrëdhënie të mos preken nga ndryshime rrënjësore. Nga ana tjetër tipologjia e modelit të lidhjes në çift të të rinjve po kushtëzohet nga faktorë që garantojnë lidhje të qëndrueshme ndërkohë që koncepti i martesës e krijimi i familjes nuk ka pësuar lëkundje, pavarësisht formave të reja të shfaqura gjatë viteve të fundit. Koncepti i një shoqërie të gjerë konsiderohet nga të rinjtë si element bazë për një jetë aktive dhe që ndikon në shëndetin e tyre emocional.





## 6

# MOBILITETI

- Rreth 40 përqind e të rinjve shqiptarë dëshirojnë shumë të jetojnë larg Shqipërisë dhe, shumica e tyre, të jetojnë përgjithmonë, ndërsa 20 përqind kanë një dëshirë të moderuar për të emigruar.
- Arsyes kryesore për këtë dëshirë janë kërkesa për standarte më të mira të jetesës dhe për një punësim më të kënaqshëm, ndërkohë që arsimi mbetet dytësor si motiv për t'u larguar.
- Gjermania është destinacioni më i dëshirueshëm për të gjithë ata që duan të ikin, e ndjekur nga Mbretëria e Bashkuar, Italia dhe Franca.
- Të rinjtë që dëshirojnë të migrojnë janë të predispozuar për të qenë qytetarë shëmbullorë në vendet ku do të shkojnë dhe kontribues të shkëlqyer në ato shoqëri: do të mësojnë gjuhën, do të shfaqin sjellje qytetare të mira dhe një performancë solide profesionale, do të ndajnë njohuritë e tyre, madje dhe do të pranojnë ato lloj punësh, që popullsia vendase nuk i preferon.

Shumica e të rinjve shqiptarë nuk kanë qendruar jashtë vendit për qëllime arsimimi apo trajnimi dhe, madje, nuk kanë plane për ta bërë këtë gjë në të ardhmen. Nga 31 përqind që planifikojnë të shkollohen jashtë Shqipërisë, shumica janë vajza. Vetëm 7 përqind e të rinjve shqiptarë kanë marrë pjesë në programe të ndryshme arsimimi apo trajnimi jashtë vendit.

Një shumicë dërrmuese prej 86 përqind nuk kanë qenë jashtë Shqipërisë për një kohë më shumë se sa 6 muaj, ndërkohë që vetëm 14 përqind e kanë këtë eksperiencë.

Mbi bazën e përgjigjeve për pyetjen mbi dëshirën e tyre për t'u larguar nga Shqipëria dhe sa e fortë është kjo dëshirë të rinjtë shqiptarë ndahen në tre grupe: Një e treta e tyre nuk ka për qëllim të emigrojë; një e katërta e tyre, rreth 23 përqind, kanë një dëshirë të moderuar ose të ulët për t'u larguar dhe shumica që mbetet, rreth 43 përqind kanë një dëshirë të shprehur mjaft të fortë për t'u larguar (e përcaktuar kjo si një dëshirë për të qenë jashtë vendit për më shumë sesa 6 muaj.) Shumica e atyre që raportojnë dëshirën më të fortë për të emigruar jetojnë në Veri të vendit.


Tashmë është e ditur dhe nga raporte statistikore të tjera që dëshira për t'u larguar nga Shqipëria nuk është e kufizuar vetëm te të rinjtë. Sipas Barometrit të Ballkanit, gjysma e të pyeturve në Shqipëri, pa dallim moshe, raportojnë se do të dëshironin të jetonin larg vendit.<sup>20</sup>

Gjatë viteve të fundit shqiptarët kanë dëshmuar se i kanë seriozisht me planet e tyre të emigrimit. Shumë prej tyre kanë lëvizur tashmë në Europën Perëndimore dhe po aq, e ndoshta dhe më shumë, kanë aplikuar në programe të lotari të ndryshme për tu vendosur në SH.B.A apo Kanada. Duke përdorur të dhëna nga Eurostat, media shqiptare ka raportuar se rreth 22 mijë shqiptarë, shumica e tyre nën 35 vjeç, kanë aplikuar për azil në vendet e BE, një numër ky i lartë po, gjithësesi, jo aq sa në vitet e mëparshme, kur ishte 60 mijë në 2015 dhe rreth 29 mijë në 2016.<sup>21</sup> Viti i kaluar shënoi, po ashtu, një rekord në numrin e atyre që aplikuan në Lotarinë Amerikane (Diversity Lottery Program), që ariti deri në 200.000 persona dhe bllokoi serverin përkatës.<sup>22</sup>

Shumica e të rinjve që kanë dëshirë të emigrojnë, 26 përqind, besojnë se do ta realizojnë këtë në dy vitet e ardhshme. 22 përqind e të tjerë besojnë se kjo do të ndodhë në pesë vitet pasuese. Një tjetër grup prej 21 përqind kanë ndërmend që planin për të lëvizur jashtë vendit ta realizojnë në vetëm gjashtë muajt e ardhshëm, pra, relativisht shpejt. Vetëm një e dhjeta e të rinjve që dëshirojnë të largohen besojnë se kjo do të kërkojë shumë kohë, dhjetë ose më shumë vite, që të ndodhë. Pra, është e dukshme që shumica absolute e dëshiron emigrimin të ndodhë herët në jetën e tyre dhe jo në faza të mëvonshme.

Një tjetër rezultat "i fortë" nga pyetjet për këtë temë është se shumica e të rinjve, që duan të emigrojnë do ta bëjnë këtë përgjithmonë pra nuk kanë plane të rikthehen. Rreth 43 përqind e tyre kanë për qëllim të rrinë për një periudhë, minimum, 20 vjetecare ose dhe për fare. Rreth 13 përqind thonë se dëshirojnë të qëndrojnë për rreth pesë deri në dhjetë vjet dhe 16 përqind pohojnë se duan të qëndrojnë deri në pesë vjet. Vetëm 8 përqind thonë se do të qëndrojnë për pak kohë, rreth gjashtë muaj.

FIGURA 26: Sa e fortë është dëshira juaj të lëvizni në një vend tjetër për më shumë se gjashtë muaj (të emigroni)?



Shumica e personave, që dëshirojnë të jetojnë jashtë Shqipërisë përgjithmonë, janë femrat.

Krahasuar me dëshirën dhe pritshmëritë e tyre, duket se jo të gjithë të rinjtë kanë ndërmarrë veprime konkrete, të cilat do të mundësonin që planet e tyre të bëheshin realitet. Kur janë pyetur se çfarë kanë bërë deri tani konkretisht për të realizuar dëshirën për të emigruar, rreth 65 përqind thonë se s'kanë bërë asgjë. Shumica e atyre, të cilët kanë ndërmarrë disa hapa, raportojnë se kanë kontaktuar dhe kanë kërkuar ndihmë nga miqtë ose të afërmit e tyre, që tashmë jetojnë jashtë vendit. Vetëm 13 përqind prej tyre kanë ndërmarrë veprime më të qenësishme si sigurimi i një burse studimi, kontakti me punëdhënës të mundshëm apo dhe kontaktimi i ambasadave përkatëse në vend.

Arsyet më kryesore, për të cilat të rinjtë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, mbeten me një natyrë ekskluzive ekonomike. Ky realitet nuk ka ndryshuar që nga anketa e fundit e zhvilluar në 2014. 56 përqind e atyre që preferojnë emigrimin, pra, pak më shumë se gjysma e gjithë atyre që dëshirojnë të ikin, duan ta bëjnë këtë për të kërkuar standarte më të mira jetese. Rreth 18 përqind janë më konkretë dhe thonë se duan të kërkojnë mundësi punësimi më të kënaqshme. Ndërkohë, 17 përqind dëshirojnë mundësi arsimimi më të mira, se sa ato që gjejnë në


vendin e tyre. Arsyet e tjera të përmendura si jetesa në një kulturë të ndryshme apo dëshira për të qenë afër me të afërmit që kanë jashtë vendit nuk përbëjnë më shumë se 1-2 përqind të përgjigjeve.

Vajzat dëshirojnë të marrin një diplomë, djemtë duan të ikin për të gjetur punë, të gjithë duan të kërkojnë një jetë më të mirë.

Ndërkohë që kërkesa për standarte më të mira të jetesës mbetet njësoj e rëndësishme për të dyja gjinitë, vërehen ndryshime të mëdha kur krahasojmë arsyet e emigrimit për arsim me ato për punësim. 24 përqind e djemve të rinj përmendin si arsye kryesore një punë më të mirë, ndërkohë që vetëm 12 përqind e vajzave e përmendin këtë arsye. Nga ana tjetër, arsimimi si arsye për të emigruar paraqet një situatë të kundërt. Për një të katërtën e vajzave arsimimi është pikërisht arsyeja kryesore ndërkohë që kjo arsye është e vlefshme vetëm për 12 përqind të djemve.



FIGURA 27: Sa kohë mendoni të qendroni jashtë?



**Gjermania** është destinacioni më i preferuar nga të rinjtë për të emigruar. Kur janë pyetur të listojnë tre preferencat e tyre kryesore për destinacione të emigrimit, të rinjtë, në shifra shumë të larta citojnë Gjermaninë. Për 25 përqind të tyre Gjermania është zgjedhja e parë, ku do dëshironin të shkonin dhe për një tjetër 20 përqind zgjedhja e dytë. Madje Gjermania figuron edhe si zgjedhje e tretë e preferuar për rreth 12 përqind të të rinjve.

Mbretëria e Bashkuar është destinacioni i dytë më i preferuar nga të rinjtë. Për 19 përqind të tyre ajo mbetet destinacioni më i preferuar, për 17 përqind të tjerë është zgjedhja e dytë dhe për 12 përqind zgjedhja e tretë. Destinacione të tjera të preferuara duken Franca, Italia dhe Shtetet e Bashkuara. Gjermania u rrit shumë si preferencë pas vitit 2014, para të cilit vendet më të preferuar ishin Mbretëria e Bashkuar, ShBA dhe Italia. Në këtë ndryshim preferencash kanë ndikuar shumë arsye dhe ngjarje, përfshirë valën e azilantëve në vitin 2015, si dhe kërkesa e Gjermanisë për forcë punëtore të kualifikuar, si për shembull mjekë dhe infermierë. Në Tiranë dhe qytete të tjerë është më se e zakonshme të shohësh klasat e kurseve të gjuhës gjermane të tejmbushura me student, që aspirojnë të shkojnë në Gjermani për studime, për punë apo dhe për stazhe.

Gjermania është bërë një zgjedhje kaq e preferuar për të rinjtë për arsye të kombinimit të faktorëve të fortë tërheqës<sup>23</sup> si mun-

dësitë ekonomike, por dhe asistencë e dhënë në kohën e pritjes së finalizimit të statusit të emigracionit.

Dëshira masive për t'u larguar nga Shqipëria drejt Gjermanisë, e shoqëruar dhe me hapa konkretë, si përvetësimi i gjuhës, ka potencialin të krijojë probleme afatgjata për Shqipërinë. Që tani gazetarët e çështjeve sociale kanë ngritur shpesh çështjen e mungesës së stafit mjekësor në spitalet shqiptare, si pasojë e fluksit të madh të atyre që e lënë vendin.

Niveli i informacionit dhe dijenive për vendin pritës ndryshon shumë të të rinjtë, që duan të largohen. Ata kanë sete të ndryshme njohurish mbi politikën dhe karakteristikat e destinacioneve të tyre si ato të punësimit, strehimit apo dhe të stausit të ligjshëm të emigrimit. Rreth 30-40 përqind e të rinjve nuk kanë fare informacion për politikën në vendin ku duan të migrojnë, ndërkaq, po kaq të rinj ndihen mjaft mirë të informuar për to. 20-25 përqind e tyre kanë disa njohuri, ndonëse jo të plota, për politikën.

Nga të gjitha fushat e ndryshme, të rinjtë duket sikur dinë diçka më shumë rreth punësimit në vendet pritëse. Po ashtu ekziston informacioni përsa u përket mundësive të strehimit. Ata dinë relativisht më pak për praktikën e marrjes së statusit të ligjshëm të qëndrimit, si dhe për mundësitë e arsimimit.

Të pyetur për gjuhën dhe zotërimin e saj, pra për faktorin më rëndësor më të madhe për integrimin në një shoqëri të huaj, të

FIGURA 28: Ç'keni bërë deri tani për t'u larguar nga vendi?




FIGURA 29: Cila është arsyeja kryesore pse kërkonti të largoheni nga vendi?







FIGURA 30: Ku dëshironi të shkoni? Rendisni deri në tre vende që ju pëlqejnë më shumë.



**FIGURA 31: Deri në ç'masë keni njohuri për mundësitë në dispozicion të imigrantëve / të huajve në vendin mikpritës më të dëshiruar (i renditur i pari) sa i përket:**



**FIGURA 32 A: Cili është niveli juaj i zotërimit të gjuhës zyrtare në vendin mikpritës më të dëshiruar (i renditur i pari)?**



rinjtë, në shumicë grupohen tek ata që kanë pak ose aspak dijeni. 30 përqind e tyre nuk e dinë gjuhën e vendit, ku duan të shkojnë, kurse 35 përqind ka njohuri fare fillestare për të, duke zotëruar vetëm disa shprehje komunikimi. Një e katërta e të rinjve besojnë se kanë një nivel të kënaqshëm të gjuhës dhe 10 përqind thonë se e zotërojnë atë mjaft mirë. Ajo që bën më shumë përshtypje është se nga të rinjtë, që dinë pak ose aspak nga gjuha e huaj, shumica dërrmuese kanë shumë dëshirë ta mësojnë atë. Rreth 90 përqind e tyre shprehen se duan patjetër të mësojnë gjuhën e destinacionit të planifikuar të largimit.

Rreth 60 përqind e të rinjve, që dëshirojnë të largohen, kanë tashmë një lloj mbështetjeje nga dikush që jeton jashtë apo dhe një ftesë konkrete. Ndërkohë, 40 përqind të tjerë mendojnë të kenë një avantazh të tillë si pikë fillimi.

Shumica e të rinjve me plane për të emigruar janë të vendosur të japin një kontribut të mirë në shoqëritë pritëse në disa mënyra. Mbi 90 përqind e tyre thonë se do të jenë qytetarë të devotshëm dhe besnikë në shoqëritë pritëse, se do të demonstrojnë arritje të mira profesionale dhe do të ndajnë me të tjerët njohuritë dhe aftësitë e tyre. Përsëri, një shumicë rreth 80 përqind kanë dëshirë të kontribuojnë në arritjet kulturore dhe zhvillimin shkencor të vendit pritës. Tre të katërtat e atyre që duan të ikin dhe, sidomos meshkujt, janë të gatshëm madje të pranojnë punë, që popullsia vendase nuk i preferon.

FIGURA 32 B: **Nëse nuk e kuptoni / flisni gjuhën zyrtare të vendit mikpritës më të dëshiruar (i renditur i pari), sa të gatshëm jeni ta mësoni atë?**





FIGURA 33: **Mendoni se jeni / do të jeni në gjendje të kontribuoni në zhvillimin dhe begatinë e vendit mikpritës? Si?**



## PËRFUNDIME

Potenciali migrator i të rinjve shqiptarë është mjaft i lartë. Institucionet shqiptare duhet ta rishqyrtojnë qasjen e tyre indiferente ndaj kësaj çështjeje dhe të konsiderojnë me kujdes të gjitha pasojat e mundshme afatgjata të saj, duke filluar nga ndikimi te skema e pensioneve, mungesa e stafit mjekësor në sistemin e shëndetësisë dhe deri te largimi i “trurit”.

Tërheq vëmendjen fakti që të rinjtë, nga njëra anë, janë mjaft të vendosur të tregojnë anën e tyre më të mirë si qytetarë dhe profesionistë në vendin ku duan të shkojnë dhe, nga ana tjetër, duken mjaft të shkurajuar për ta provuar këtë në vendin amë. Nëse ky frymëzim për të punuar fort dhe për të qenë qytetarë model do të ishte prezent në Shqipëri, shumë procese të nevojshme të ndryshimit do të ecnin më shpejt dhe do të ishin më eficiente. Arsyet për këtë mungesë entuziazmi mund të gjenden në tranzicionin e stërzgatur dhe të vështirë të Shqipërisë dhe, sidomos, te korrupsioni dhe polarizimi ekstrem në politikën shqiptare.

Politikëbërësit dhe vendimmarrësit kanë mundësi ta shfrytëzojnë këtë potencial të të rinjve, duke e ndryshuar vektorin e tij drejt shoqërisë shqiptare në mënyrë që të realizohet integrimi evropian i Shqipërisë.

Po ashtu, është një lloj e rëndësishme që vendet tipike pritëse të shqyrtojnë politikën e tyre të deritanishme dhe të jenë më transparente dhe më të qarta në mesazhet që iu përçojnë emigrantëve potencialë përse i përket dëshirueshmërisë së tyre, mundësive reale për të marrë një status qëndrimi të ligjshëm, si dhe perspektivës së tyre afatgjatë. Kjo do të evitonte një lloj hipokrizie të deritanishme, ku vëmë re se disa vende evropiane ankohen për emigrimin dhe, ndërkohë, sponsorizojnë jo pak programe, që inkurajonë njerëzit e kualifikuar të largohen nga rajoni jonë.



## 7

# ARSIMI

## GJETJET KRYESORE

- 38 përqind e të rinjve pohojnë se ndjehen disi të kënaqur me cilësinë e arsimit
- 54 përqind e të rinjve pohojnë pagesën për provime në universitete
- 63 përqind e të rinjve të intervistuar deklarojnë se sistemi i kualifikimit, shkollimit dhe studimeve universitare nuk është i përshtatur me nevojat e tregut aktual të punës
- 49 përqind e të rinjve të intervistuar janë përgjigjur se kanë arritur një mesatare 8–9 dhe 9–10 në vitin e fundit të shkollimit
- 54 përqind e të rinjve pohojnë se do ta kishin të vështirë e shumë të vështirë të gjenin një punë pas përfundimit të ciklit të tyre të shkollimit

## ANALIZA E DETAJUAR E REZULTATEVE

Lidhur me cilësinë e arsimit në Shqipëri 38 përqind e të rinjve pohojnë se ndjehen disi të kënaqur, përkundër 55.5 përqind me të dhënat e studimit të vitit 2015. Vetëm 17 përqind deklarojnë se nuk janë fare të kënaqur, vetëm 11 përqind e të rinjve në Tiranë shprehën shumë të kënaqur për cilësinë e arsimit.<sup>24</sup>

54 përqind e të rinjve bien dakort se pagesa për notën apo blerja e provimeve në universitete është një fenomen shumë i përhapur. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015, kur kjo përqindje ishte 45.7, vërejmë një rritje të perceptimit të të rinjve vecanerisht në universitete ku 61 përqind e të rinjve të grupmoshës 18–21 vjeç e pohojnë këtë.<sup>25</sup>


Një element shumë i rëndësishëm për të rinjtë është lidhja e shkollimit me tregun e punës. 63 përqind e të rinjve të intervistuar deklarojnë se sistemi i kualifikimit, shkollimit dhe i studimeve universitare nuk është i përshtatur me nevojat e tregut aktual të punës. Këtë e pohojnë 69 përqind e të rinjve të moshës 22–25 vjeç dhe 67 përqind e të rinjve të grupmoshës 26–29, që kanë kryer ciklet e studimit dhe përballen me sfidat e punësimit.

Praktikat mësimore rrisin aftësinë praktike të të rinjve por, 83 përqind e të rinjve, kryesisht të shkollave të mesme, pohojnë se gjatë periudhës së shkollimit nuk kanë marrë pjesë në praktika mësimore apo intershipe. Ky tregues dëshmon për shkëputjen të aspektit teorik nga ai praktik, që ndikon te aftësia për të punuar. Të rinjtë e zonave rurale e kanë më të lartë këtë përqindje, 87, përkundër 78 të zonave urbane, çka shpjegohet me përqëndrimin më të madh të institucioneve dhe bizneseve në zonat urbane.

Struktura e shkollimit të të rinjve të intervistuar është e ndryshme. 43 përqind e tyre kanë përfunduar shkollën 9 vjeçare, 27 përqind arsimin e mesëm, 5 përqind arsimin profesional, 9 përqind arsimin universitar, 9 përqind dhe arsimin pasuniversitar (MA) 7 përqind. Në grup-moshat e të rinjve të intervistuar nuk përfshihen të rinj që kanë përfunduar studimet e doktoraturës.

Objektivat e synimet e arsimimit për të rinjtë janë të ndryshme. Të dhënat tregojnë se 36 përqind e të rinjve të intervistuar dëshirojnë që të arrijnë MA si nivelin më të lartë të arsimimit të tyre. Femrat kanë një përqindje më të lartë me 45 përqind përkundër 29 përqind të djemve, çka dëshmon për prirjen e tyre drejt arsimimit sa më afatgjatë. Ndërkohë, 14 përqind synojnë si nivelin më të lartë të arsimimit BA, ndërsa studimet e doktoraturës vetëm 10 përqind. Vërejmë se vetëm 2 përqind kanë dëshirë të ndjekin arsimin profesional, megjithë fushatat e ndërgjegjësimit për rëndësinë e këtij arsimimi në perspektivën e punësimit. Arsimi i lartë, deri në përfundim të ciklit të II-të të studimeve, sërish mbetet objektiv kryesor i arsimimit për të rinjtë shqiptarë. Në krahasim me vitin 2015, kur kjo shifër ishte 54.8 përqind, vërehet një rënie, por kjo nuk është reflektuar në zgjedhjen e formave të tjera të arsimimit nga ana e të rinjve.<sup>26</sup>

**FIGURA 34: Një përgjithësi, sa të kënaqur jeni me cilësinë e arsimit në Shqipëri?**



**FIGURA 35: Jeni dakort se ka raste kur në universitetet / institutet në Shqipëri "blihen" notat?**






FIGURA 36: **Mendoni se arsimiti universitar, shkollor dhe profesional në vendin tuaj është i mirëpërshtatur apo i keqpërshtatur me tregun e punës?**






FIGURA 37: **Gjatë arsimimit tuaj deri tani, keni marrë pjesë në një praktikë apo stazh?**



**FIGURA 38: Cili është niveli më i lartë i arsimit që keni përbushur deri tani?**



**FIGURA 39: Cili është niveli më i lartë i arsimit që synoni të përbushni?**





FIGURA 40: Cili është statusi juaj aktual sa i përket arsimimit?



Bindja e të rinjve për të ndjekur arsimimin që dëshirojnë është e fortë dhe 76 përqind e të rinjve të intervistuar shprehin se janë të sigurtë e shumë të sigurtë se do ta arrijnë atë. Ata besojnë se zgjedhja që kanë bërë përputhet me aftësitë e tyre dhe me mundësitë që ofron sistemi arsimor. Femrat shprehin një siguri më të madhe me 60 përqind, përkundër djemve me 46 përqind, duke dëshmuar këmbënguljen e tyre drejt një niveli sa më të lartë arsimimi. Të rinjtë që jetojnë në Tiranë e kanë më të fortë këtë bindje; 65 përqind prej tyre janë të sigurtë për arritjen e objektivit të tyre të arsimimit, në krahasim 47 përqind e të rinjve nga qytetet e tjera.

## STATUSI AKTUAL I ARSIMIMIT TË RINJVE TË INTERVISTUAR ËSHTË:

44 përqind ndjekin shkollën e mesme; 11 përqind ndjekin studimet pasuniversitare dhe 37 përqind nuk ndjekin asnjë lloj shkollimi. Në grupin e fundit 41 përqind e përbëjnë të rinjtë të zonave rurale, që kanë pak mundësi për arsimim pas përfundimit të periudhës së arsimit të detyruar. 34 përqind i përkasin grup moshës 18–21 vjeçare, që është një moshë aktive për punë.

Mënyra se si të rinjtë e shpenzojnë kohën për studim dhe, se si ndjehen përballë nivelit të arsimimit është tregues i vetëdijes së tyre të brendshme për sfidat e shkollimit

Lidhur me kohën e studimit, të dhënat tregojnë se të rinjtë shqiptarë shpenzojnë mesatarisht 2 orë për studim. 17 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se për të mësuar shpenzojnë nga

0–1 orë në ditë; 32 përqind e tyre nga 1–2 orë, 27 përqind nga 2–3 orë, ndërsa, më shumë se 3 orë në ditë për studim shpenzojnë rreth 23 përqind. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015 vërehet një rritje të numrit të rinjve, që studiojnë më shumë se 3 orë, nga 14.1 përqind në 23 përqind, duke dëshmuar ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e studimit në një botë e ekonomi, ku dijet kanë vlerë.<sup>27</sup> Femrat shpenzojnë më shumë kohë për studim, 38 përqind e tyre përkundër 10 përqind të djemve. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015, numri i vajzave studioje ka pësuar një rënie të lehtë nga shifra prej 42.7 përqind.

Për 41 përqind e të rinjve të intervistuar jeta e përditshme në shkollë e universitet është, deri diku, e vështirë dhe stresuese, ndërkohë që për 34 përqind të tyre është e lehtë dhe pa stres. Te grupmosha 22–25 vjeç vërehet një përqindje më e lartë, 57 përqind, që e konsiderojnë jo stresuese jetën e përditshme në shkollë, çka lidhet me vështirësinë e cikleve pasuniversitare.

FIGURA 41: Mesatarisht, sa orë në ditë shpenzoni për të studiuar (pas klasave/në shtëpi)?




FIGURA 42: Për mendimin tuaj, si është jeta e përditshme në universitetin/shkollën tuaj?





FIGURA 43: Cila ishte nota juaj mesatare gjatë vitit të fundit akademik?



Përsa i përket notës mesatare në vitin e fundit të shkollës, 49 përqind e të rinjve të intervistuar janë përgjigjur se kanë arritur një mesatare 8-9 dhe 9-10, 36 përqind e tyre pohojnë se nota mesatare e vitit të fundit të shkollës ka qene 7-8. Femrat, me notë mesatare 8-9 dhe 9-10, kanë një përqindje më të lartë me 35 përqind e 32 përqind, përkundrejt djemve me 21 e 13 përqind, duke dëshmuar qendrueshmërinë e vajzave në procesin e formimit e arsimimit. Përqindja e të rinjve në zonat rurale me mesatare 9-10 është 19 përqind përkundrejt atyre në qytet me 24 përqind. Kjo shpjegohet me kushtet specifike të arsimimit në zonat rurale, ku, përveç cilësisë së mësimdhënies nxënësit shpenzojnë kohë edhe me punët në familje.

Punësimi dhe shkollimi janë dy elementë të pandashëm. Por 54 përqind e të rinjve pohojnë se do ta kishin të vështirë e shumë të vështirë të gjenin një punë pas përfundimit të ciklit të tyre të shkollimit. Vetëm 38 përqind pohojnë se do ta kishin të lehtë apo shumë të lehtë të gjenin një vend pune pas shkollimit. Në këtë drejtim dalin në pah dallimet gjinore: 35 përqind e femrave pohojnë se do ta kishin shumë të vështirë të gjenin një punë, përkundër 28 përqind të djemve. Megjithëse formalisht tregu i punës është i lirë nga paragjykimet gjinore, realiteti praktik i përball shpesh vajzat me aspekte të tilla, që ua vështirojnë punësimin

## KONKLUZIONE

Niveli dhe cilësia e arsimit vazhdojnë të mbeten shqetësim i vazhdueshëm për të rinjtë shqiptarë, duke qenë se ato lidhen drejtpërdrejt me punësimin. Shqetësimet e tyre për arsimin janë të lidhura jo vetëm me fenomenet brenda shkollës, por, veçanërisht, me sfidën e përputhjes së programeve të edukimit me tregun e punës. Aspektet e studimit dhe rezultatet në shkollë vazhdojnë të jenë të ndryshme, sipas kategorive gjinore të të rinjve shqiptarë, çka tregon një prirje dalluese që vazhdon mes tyre. Pavarësisht rritjes së numrit të të rinjve, që po ndjekin arsimin profesional, shumica e rinjve vazhdojnë ta kenë si objektiv bazë përfundimin e një shkolle të lartë, duke besuar se përfundimi i studimeve universitare ofron mundësi më të mira për punësim.



## 8

# PUNËSIMI

## GJETJET KRYESORE

- 48 përqind e të rinjve të intervistuar, që janë në marrëdhënie pune, pohojnë se nuk punojnë në profesionin për të cilin janë arsimuar dhe kualifikuar.
- 36 përqind e të rinjve punojnë në vende pune, ku kërkohet një nivel më i ulët arsimimi, se ai që ata kanë
- Të rinjtë në marrëdhënie pune pohojnë se punojnë mesatarisht 41 orë në javë, ndërsa ata në zonat rurale 43 orë.
- 45 përqind e të rinjve kanë pohuar se do të pëlqenin të punonin në sektorin public, ndërsa 44 përqind në sektorin privat.
- 81 përqind e të rinjve thonë se janë të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme lidhjet shoqërore (farefisi, shokët) për të gjetur një vend pune.
- 71 përqind pohojnë se ekspertiza apo aftësia profesionale për një punë të caktuar është element shumë i rëndësishëm për një vend pune.
- 86 përqind e të rinjve e konsiderojnë pagën motiv kryesor të punësimit.
- 76.5 përqind e të rinjve pohojnë se është shumë e rëndësishme të kesh ndjesinë se do të arrish diçka, kur merr vendimin të punësohesh.
- Vetëm 22 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se janë përfshirë në aktivitete vullnetare 12 muajt e fundit

## ANALIZA E DETAJUAR E REZULTATEVE

Statusi i punësimit të të rinjve mbetet një problematikë e vazhdueshme. 51 përqind e tyre pohojnë se nuk janë në punë dhe nuk janë duke kërkuar për punë. 81 përqind e kësaj kategorie i përket grupmoshës 14–17 vjeç, që është duke përfunduar shkollën. 17 përqind e të rinjve se nuk kanë punë dhe po kërkojnë aktivisht për të gjetur një vend pune. 33 përqind të kësaj kategorie e përbërjnë të rinjtë e grupmoshës 22–25 vjeçare dhe 28 përqind ata të grupmoshës 26–29 vjeç. Të rinjtë e kësaj kategorie kanë përfunduar

të gjitha ciklet e shkollimit e përballen me vështirësitë e gjetjes së një vendi pune. Vetëm 10 përqind e të rinjve të intervistuar kanë një kontratë të përhershme pune dhe kjo shifër është më e ulët se të dhënat e vitit 2015, kur ishin 22 përqind, çka tregon për rënie të punësimit.<sup>28</sup>

Pengesat për punësim, sipas të rinjve janë të ndryshme, por përballja e tyre me këto pengesa është në vartësi të eksperiencave individuale. Për këtë arsye janë intervistuar grupi i të rinjve, që kanë përfunduar një cikël studimi dhe kanë qenë në kërkim të një vendi pune.

Sipas përgjigjes së të rinjve, që kanë përfunduar një nga ciklet e studimit, cilësia e notave në shkollë nuk ka përbërë pengesë për punësimin e tyre në tregun lokal të punës. 82 përqind e të rinjve janë përgjigjur se nuk kanë patur eksperiencë, ku të jenë përballur me refuzimin e një vendi pune për shkak të notave të shkollës, ndërkohë që këtë e pohojnë 26 përqind e të rinjve, që kanë mbaruar shkollën e mesme. Kjo prirje është e njëjtë si për zonat urbane dhe ato rurale të vendit, çka tregon se punëdhënësit mbështeten mbi aftësitë praktike të punëkërkuësve dhe eksperiencat e mëparshme.

Edhe niveli i arsimimit nuk ka qenë shkak apo pengesë për të rinjtë në tregun lokal të punës. 75 përqind e tyre thonë se nuk kanë pasur eksperiencë, ku të jenë përballur me refuzimin e një vendi pune për shkak të nivelit të arsimimit, ndërkohë që 23 përqind janë ndeshur me këtë kufizim. Në grupmoshën 18–21 vjeçare bie në sy se 40 përqind e të rinjve të intervistuar, që kanë përfunduar shkollën e mesme dhe 30 përqind e atyre, që kanë përfunduar ciklin 9 vjeçar, janë përballur me këtë eksperiencë.

15 përqind e të rinjve pohojnë se kanë lëvizur nga rajoni i tyre për shkak të punësimit, ndërkohë që 83 përqind e tyre deklarojnë se nuk janë përballur me një eksperiencë të tillë. Në këtë rast vërehet se janë 24 përqind e të rinjve të grupmoshës 26–29 vjeç, që kanë lëvizur nga rajoni i tyre për një vend, pune pasi kanë përfunduar të gjitha ciklet e studimit, duke synuar rajone me mundësi më të mëdha punësimi.

FIGURA 44: Cili është statusi juaj aktual i punësimit?






FIGURA 45: Keni përjetuar një apo më shumë nga përvojat e mëposhtme: Nuk kam mundur të fitoj punën e dëshiruar për shkak të notave të dobëta në shkollë



\*Vetëm ata që kanë përfunduar të gjitha ciklet e studimit




FIGURA 46: **Keni përjetuar një apo më shumë nga përvojat e mëposhtme: Pas shkollës kam lëvizur sepse nuk kishte punë të përshtatshme për mua në rajonin tim**



Të rinjtë e punësuar përballen me orare të ndryshme pune në varësi të gjinisë dhe të zonave ku ndodhen. Ata pohojnë se punojnë, mesatarisht, 41 orë në javë, duke shënuar një rritje në krahasim me të dhënat e studimit të vitit 2015, kur kjo shifër ishte 38 orë.<sup>29</sup> Sipas të dhënave, djemtë punojnë mesatarisht, 43 orë në javë, ndërsa femrat 37 orë. Të rinjtë e zonave rurale deklarojnë se

punojnë, mesatarisht 46 orë në javë, përkundër 39 orëve të punës në zonat urbane. Të rinjtë nga qytetet e tjera punojnë mesatarisht 43 orë në javë, përballë 34 orë të të rinjve në Tiranë. Këto dallime dëshmojnë se kushtet social-ekonomike të zonave të ndryshme të vendit ndikojnë tek orët mesatare të punës.

FIGURA 47: Mesatarisht, sa orë në javë punoni?



Përputhja e pozicionit të punës me arsimimin e të rinjve është një sfidë, që ndeshet shpesh në realitetin e përditshëm. 48 përqind e të rinjve të intervistuar, që janë në marrëdhënie pune, pohojnë se nuk punojnë në profesionin për të cilin janë arsimuar dhe kualifikuar. Kjo shifër është më e lartë se në studimin e vitit 2015, kur ishte 41 përqind e të rinjve që pohonin këtë realitet.<sup>30</sup> Thellimi i këtij procesi tregon se tregu i punës dhe shkollimi i të rinjve nuk janë në harmoni. Megjithatë, 38 përqind e të rinjve pohojnë se puna e tyre është afër ose plotësisht në përputhje me arsimimin që kanë përfunduar. Në raport me të dhënat e studimit të vitit 2015, kur kjo shifër ishte 37 përqind, vërehet një rritje e lehtë e kësaj prirjeje.

53 përqind e të rinjve të intervistuar deklarojnë se aktualisht punojnë në një punë që është në përputhje me nivelin formal të arsimimit, ndërkohë, që 36 përqind e të rinjve punojnë në vende pune ku kërkohet një nivel më i ulët arsimimi se ai që ata kanë. Nevoja për punë i shtyn të rinjtë të pranojnë pozicione, ku kërkohet një nivel më i ulët arsimimi. Kjo qasje është e njëjtë si për femrat dhe për meshkujt. 45 përqind e të rinjve nga shtresat shumë të varfra janë më të gatshëm ta pranojnë një punë të tillë përkundër 34 përqind të të rinjve, që vinë nga shtresat e mesme.

Struktura e punësimit të të rinjve është e ndryshme. 84.5 përqind e të rinjve pohojnë se janë të punësuar në sektorin privat dhe vetëm 14 përqind punojnë në administratën publike. Nga të rinjtë e intervistuar asnjë prej tyre nuk punon në organizatat joqeveritare apo ato ndërkombëtare

**Dëshirat apo parapëlqimet e të rinjve për punësimin** janë të lidhura me perceptimin e tyre mbi tregun e punës. 45 përqind e të rinjve kanë pohuar se do të pëlqenin të punonin në

sektorin publik, përkundër 48 përqind që kishin shprehur këtë dëshirë në vitin 2015. Kjo rënie e lehtë lidhet me dinamikën, që po pëson tregu i punës. Ndërkohë 44 përqind e të rinjve deklarojnë se do të pëlqenin të punonin në sektorin privat. Vërejmë një rritje të të rinjve që kanë përzgjedhur sektorin privat si alternativë punësimi, në se e krahasojmë me 38 përqind të të rinjve në vitin 2015, që parapëlqenin punësimin në këtë sektor.<sup>31</sup> Ngushtimi i diferencës mes sektorit publik e privat dëshmon se të rinjtë po rivlerësojnë sektorin privat si mundësi punësimi. Meshkujt janë më të prirur të zgjedhin punësimin në sektorin privat me 52 përqind përkundër femrave me 33 përqind, duke pasqyruar vështërsitë që ato ndeshin gjatë punësimit në këtë sektor.

57 përqind e femrave janë në kërkim të punës, përkundër 46 përqind të meshkujve, çka tregon se ato kanë më shumë vështirësi në këtë drejtim për shkak të tipologjisë së tregut të punës. Numri i të rinjve të kësaj kategorie është i njëjtë për të rinjtë e zonave urbane e rurale, duke dëshmuar se punësimi mbetet sfidë përtej ndarjeve gjeografike.

Punësimi i të rinjve, sipas përgjigjeve të tyre, ndikohet nga një sërë faktorësh formalë (arsimi, eksperiencia) dhe informalë (lidhjet shoqërore, fati), që pasqyrojnë gjendjen e tregut të punës brenda vendit.

Njohja dhe lidhja shoqërore vazhdon të ketë një peshë të konsiderueshme në punësimin e të rinjve. 81 përqind e të rinjve pohojnë se lidhjet shoqërore (farefisi, shokët) janë të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme për të gjetur një vend pune. Nëse e krahasojmë me të dhënat e studimit të vitit 2015, kur kjo shifër ishte 76 përqind, vërejmë se është rritur peshja specifike e tij në punësim.<sup>32</sup> Në Tiranë, për shkak se është punëdhënësi kryesor,

FIGURA 48: Aktualisht, punoni në profesionit tuaj (për të cilin jeni trajnuar/arsimuar)?





FIGURA 49: Për mendimin tuaj, sa i rëndësishëm është secili nga faktorët e mëposhtëm që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?



vërejmë se janë 73 përqind e të rinjve, që e vlerësojnë atë si faktor shumë të rëndësishëm, përkundër 60 përqind në qytetet e tjerë kryesore.

71 përqind e të rinjve pohojnë se ekspertiza apo aftësia profesionale për një punë të caktuar është element shumë i rëndësishëm për një vend pune. Ata janë të vetëdijshëm se aftësia profesionale nuk mund të anashkalohej përballë faktorëve të tjerë, që ndikojnë në punësim.

Edhe **niveli i arsimimit** është vlerësuar nga të rinjtë si një element shumë i rëndësishëm, që ndikon në punësim. 69 përqind e të rinjve deklarojnë se niveli i arsimimit është një faktor shumë i

rëndësishëm. Lidhur me këtë aspekt të punësimit nuk vërejmë dallim mes të rinjve nga zonat urbane e rurale.

**Lidhjet me persona të pushtetshëm** për të gjetur një vend pune kanë sërish një peshë specifike në këndvështrimin e të rinjve. 57 përqind e tyre i konsiderojnë shumë të rëndësishme këto lidhje, çka dëshmon se faktorët informale të punësimit mbeten të lartë. Të rinjtë nga zonat urbane e konsiderojnë më të rëndësishëm këtë lidhje. 62 përqind e tyre e vlerësojnë këtë aspekt si shumë të rëndësishëm për gjetjen e një vendi pune, përkundër 49 përqind të rinjve nga zonat rurale.

FIGURA 50: Për mendimin tuaj, sa të rëndësishëm janë Të Njohurit (miqtë, të afërmit ...) që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?




FIGURA 51: Për mendimin tuaj, sa i rëndësishëm është Niveli i Arsimit që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?




FIGURA 52: Për mendimin tuaj, sa të rëndësishme janë Lidhjet me njerëzit në pushtet që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?





FIGURA 53: Sa të rëndësishëm janë për ju faktorët e mëposhtëm kur zgjidhni një punë:



Total (N=1.200)


**Fati** është element që të rinjtë e përlogarisin si faktor për punësimin. 49 përqind e të rinjve të intervistuar janë shprehur se fati është faktor shumë i rëndësishëm për të gjetur një vend pune. Madje, femrat shfaqin një shenjë më të lartë supersticioni. 52 përqind e tyre e konsiderojnë atë shumë të rëndësishëm, përkundër 47 përqind të djemve. Kjo tregon se faktorët formalë të punësimit si arsimimi, eksperiencia apo aftësitë nuk marrin peshën e duhur në realitetin e punësimit brenda vendit.

**Origjina e vendlindjes** nuk vlerësohet si faktor me rëndësi nga të rinjtë për të gjetur një vend pune. 38 përqind e të rinjve nuk e konsiderojnë atë fare të parëndësishëm, por, megjithatë 21 përqind e tyre e konsiderojnë ende si faktor shumë të rëndësishëm.

Për të rinjtë **arsimimi apo eksperiencia e punës jashtë vendit** luan një rol me rëndësi për punësimin. 58 përqind e të rinjve pohojnë se arsimimi apo eksperiencia e punës jashtë vendit është shumë e rëndësishme për të gjetur një vend pune. Niveli i lartë i të rinjve që studiojnë jashtë vendit, emigracioni dhe transferimi i aftësive janë shndërruar në faktorë të rëndësishëm për pundhënesit shqiptarë. Në këtë rast femrat, me 63 përqind, i besohen më shumë, përkundër 54 përqind të meshkujve.

Lidhja me punësimin e **anëtarësimit në parti politike** është një klishe sociale, që ka zënë vend. 41 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se anëtarësimi në një parti politike është shumë i rëndësishëm. Përballë këtij vlerësimi nuk vërehen dallime mes me-

FIGURA 54: **Jeni angazhuar ndonjëherë me aktivitete vullnetare gjatë 12 muajve të fundit, p.sh.: keni kryer vullnetarisht ndonjë punë pa pagesë?**



shkujve e femrave apo mes të rinjve të zonave urbane e rurale, duke u shndërruar në një normë. Te të rinjt që jetojnë në Tiranë kjo prirje është me e fortë me 48 përqind, përkundër atyre nga qytete të tjerë me 29 përqind, duke pasur parasysh se aty luajnë rol edhe lidhjet familjare.

Përballë elementëve, që ndikojnë te punësimi i të rinjve, janë një sërë aspektesh motivuese si pagat, mjedisi i punës, karriera, etika, kolegët, që kanë rëndësi për çdo të ri, kur ata janë përballë punësimit.

**Paga** është element nxitës e motivues në çdo plan punësimi. 86 përqind e të rinjve të intervistuar, kur zgjedhin një vend pune, e konsiderojnë pagën një faktor shumë të rëndësishëm. Kërkesa për një pagë dinjitoze, në përputhje me formimin e e eksperiencën, është e ligjshme.

**Siguria në vendin e punës** është mjaft e rëndësishme për të rinjtë, kur vendosin të punësohen. Në bazë të këtij vlerësimi 85 përqind e tyre deklarojnë se e konsiderojnë shumë të rëndësishme sigurinë në punë, kur janë përballë perspektivës së punësimit. Femrat i kushtojnë më shumë rëndësi këtij aspekti me 90 përqind, përkundërt meshkujve me 89 përqind, 93 përqind e të rinjve nga Tirana e vlerësojnë shumë këtë faktor përkundër 78 përqind të rinjve nga qytete të tjerë.

**Puna me njerëzit** luan rolin e vet kur merret vendim për të zgjedhur një vend pune. 74 përqind e të rinjve të intervistuar e


vlerësojnë shumë të rëndësishme marrëdhënien me njerëzit, në se do të zgjidhnin një vend pune. Lidhjet shoqërore në ambientet e punës janë një tregues i motivimit. 85 përqind e të rinjve nga Tirana e konsiderojnë si shumë të rëndësishëm këtë element përkundër 72 përqind nga qytetet kryesore, duke dëshmuar socializimin e shpeshtë në qendrat metropolitane.

**Puna me kolegë** që pëlqeni është një kënaqësi dhe faktor me rëndësi në vendin e punës. Për këtë arsye 65 përqind e të rinjve shprehin pa hezitim se e konsiderojnë shumë të rëndësishëm këtë element, që luan rol në ecurinë e punës. Femrat, sërish, shfaqin një përkrahje më të madhe ndaj këtij faktori me 67 përqind, përkundërt djemve me 63 përqind. Kjo prirje shfaqet si te të rinjtë e zonave rurale dhe në ato urbane.

**Karriera** është shtylla e nxitjes për punësim. 72 përqind e të rinjve pohojnë se karriera është element shumë i rëndësishëm, kur ata zgjedhin një vend pune. Vërehet se 77 përqind e femrave e vlerësojnë shumë këtë aspekt, përkundër 67 përqind të meshkujve, çka tregon se ecja e femrave drejt karrierës po përforcon zbehjen e dallimeve gjinore, forcimin e barazisë gjinore në këtë drejtim.

**Ndjesia se duhet të arrish diçka**, kur zgjedh një vend pune, mbetet element shumë motivues. Këtë e vërtetojnë statistikat e studimit, siç është cilave 76.5 përqind e të rinjve pohojnë se, kur merr vendimin të punësohesh është shumë e rëndësishme të kesh ndjesinë se do të arrish diçka.

FIGURA 55: Me ç’lloj organizate keni punuar vullnetarisht gjatë 12 muajve të fundit:



### Mundësia se do të bësh dicka të vlefshme për shoqërinë

është objektiv etik, kur zgjedh një vend pune. 71 përqind e të rinjve shprehen se ky element është shumë i rëndësishëm. Kjo lloj empatie sociale në Tiranë është pak më e dukshme, ku 81 përqind e të rinjve e shohin si shumë të rëndësishëm, përkundër 66 përqind në qytete të tjerë.

**Koha e lirë pas pune** është faktor, që ndikon në shëndetin e tyre emocional dhe forcimin e lidhjeve shoqërore të të rinjve. 74 përqind e të rinjve e konsiderojnë shumë të rëndësishëm këtë element, kur vendosin të zgjedhin një vend pune. Të rinjtë nga Tirana shprehin një mbështetje më të madhe për rëndësinë e këtij faktori me 86 përqind, përkundër të rinjve nga qytetet e tjerë me 71 përqind, sepse Tirana ofron më shumë mundësi për argëtim në kohën e lirë, pas pune.

**Aspekti i vullnetarizmit në shoqëri** dëshmon për shkallën e angazhimit dhe përgjegjësisë sociale të të rinjve. 22 përqind e të rinive pohojnë se janë përfshirë në aktivitete vullnetare në 12 muajt e fundit, ndërkohë që 78 përqind e tyre deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në aktivitete me karakter vullnetar (punë të papaguar). Vihet re se me rritjen e grupmoshave nga 18–29 vjeç rritet përqindja e të rinjve, që nuk angazhohen në punë vullnetare. 90 përqind e të rinjve të grupmoshës 26–29 pohojnë se nuk janë përfshirë në aktivitete vullnetare, çka dëshmon se aktivitete të tilla ndodhin kryesisht brenda shkollës. 14 përqind e të rinjve pohojnë se janë angazhuar në aktivitete vullnetare brenda shkollës apo universitetit, ndërsa 86 përqind nuk kanë pasur eksperiencë të tilla gjatë 12 muajve të fundit.

Edhe pjesëmarrja në veprimtari vullnetare brenda organizatave joqeveritare sërish shfaqet në nivele të ulëta. Vetëm 2 përqind e të rinjve brenda këtyre organizatave, pohojnë se janë angazhur ndërsa 98 përqind nuk kanë marrë asnjëherë pjesë në aktivitete të tilla gjatë 12 muajve të fundit. Edhe angazhimi vullnetar në kuadër të iniciativave qytetare civile është shumë i ulët. Sërish, vetëm 2 përqind e të rinjve pohojnë se janë angazhuar vullnetarisht në iniciativë të tilla, ndërsa 98 përqind nuk kanë marrë pjesë në to gjatë 12 muajve të fundit. Asnjë nga të rinjtë e intervistuar

nuk ka pohuar se ka pasur eksperiencë të punës vullnetare pa pagesë me shërbimet e zjarrfikëseve apo të ndihmës së shpejtë. Kur të rinjtë janë pyetur lidhur me angazhimin vullnetar për organizatat ndërkombëtare si Amnesty International apo Kryqi i Kuq, 98 përqind kanë pohuar se nuk kanë pasur eksperiencë të tilla me përjashtim të 2 përqind. Nivel i ulët i angazhimit vullnetar në shifrat 1 ose 2 përqind shfaqet edhe në rastet e partive politike, sindikatave, organizatave rinore.

## KONKLUZIONE

Çështja e punësimit të të rinjve mbetet elementi kryesor, që kushtëzon zhvillimin e tyre profesional e individual në të ardhmen. Shqetësimi i tyre është se tregu i punës i përball me oferta pune, që shpesh nuk përputhen me kualifikimin e tyre arsimor dhe që ata janë t'i detyruar të pranojnë. Ata vazhdojnë të pranojnë përparësinë që kanë kriteret informale të punësimit (lidhjet shoqërore, njohjet, etj), përkundër atyre formale (shkollimit, eksperiencës) në tregun e punës. Në përzgjedhjen e punës të rinjtë vlerësojnë se, veçanërisht paga dhe kushtet e punës, por edhe marrëdhëniet me kolegët janë parakushte për një mjedis pozitiv, që nxit zhvillimin e karrierës dhe i motivon ata drejt punësimit. Angazhimi i të rinjve në punë vullnetare pa pagesë brenda organizatave apo institucioneve të ndryshme mbetet i ulët duke dëshmuar një angazhim social të pakët.





## 9

## POLITIKA

## GJETJET KRYESORE

- 62 përqind e të rinjve pohojnë se nuk janë fare të interesuar për politikën.
- 31 përqind e të intervistuarve thonë se nuk janë aspak të përfaqësuar në politikë.
- 28 përqind e të rinjve pohojnë se bindjet e tyre politike nuk përputhen aspak me ato të prindërve.
- 69 përqind kanë pohuar se do të merrnin pjesë si votues në një proces të ardhshëm zgjedhor.
- 63 përqind pohojnë se burimi i informacionit për politikën është Interneti.
- Vetëm 24 përqind e të rinjve të intervistuar i përdorin rrjetet sociale si burime informacioni për ngjarjet e zhvillimet politike.
- 52 përqind pëlqejnë një lider, që qeveris me dorë të fortë për të mirën publike.
- 53 përqind e të rinjve pohojnë se opozita politike është e nevojshme për një demokraci të shëndetshme.
- Lufta ndaj krimit të organizuar e korrupsionit konsiderohet prioritet për qeverinë nga 80 përqind e të rinjve.
- Të rinjtë shqiptarë kanë renditur si vlerën më të rëndësishme të politikës sigurimin e mirëqenies ekonomike dhe punësimin e qytetarëve.

## ANALIZA E DETAJUAR E REZULTATEVE

## Interesi dhe informacioni për politikën

62 përqind e të rinjve se nuk janë fare të interesuar për politikën. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015, kur kjo shifër ishte 40 përqind, vërejmë se është rritur mosinteresi i tyre për politikën. Ata që janë shumë të interesuar për të përllogariten vetëm në 3 përqind, shifër kjo më e ulët se në vitin 2015, kur ata ishin 7 përqind.<sup>33</sup> Niveli i mosinteresimit për politikën është i njëjtë si për të rinjtë e zonave urbane dhe për ato rurale, duke dëshmuar një indiferentizëm të përgjithshëm rinor. Për këtë çështje femrat

shprehin një nivel më të lartë mosinteresi (73 përqind), përkundrajt djemve (62 përqind).

Niveli i mosinteresimit të të rinjve për politikën shfaqet edhe kur pyeten për zhvillimet politike në BE. 61 përqind e tyre shprehin se janë të paimteresuara, përkundrajt 48 përqind të të rinjtë të universiteteve, shifër që lidhet me nevojën e tyre për më shumë informacion. Në se e krahasojmë më të dhënat e studimit të vitit 2015, vërejmë se përqindja e të rinjve, që shprehin mosinteresi për zhvillimet e politikës së jashtme është rritur nga 42.7 përqind në 61 përqind<sup>34</sup>.

Edhe politika e një vendi të veçantë nuk përbën interes për të rinjtë shqiptarë. 62 përqind e tyre shprehin se janë të paimteresuara për politikën e një vendi të caktuar. Kjo prirje shfaqet 61 përqind, edhe në rastet, kur bëhet fjalë për politikën e një vendi në nivel rajonal.

SHBA e Rusia janë dy aktorë të rëndësishëm të politikës ndërkombëtare dhe interesi i të rinjve për zhvillimet politike në këto vende tregon për nivelin e informimit e qëndrimit të tyre.

Politika në SHBA nuk është në vëmendjen e të rinjve. 66 përqind e tyre shprehin se nuk janë të interesuar për zhvillimet e politikës në këtë vend përkundrajt 5 përqind, që shprehin se janë shumë të interesuar. Pavarësisht peshës botërore të politikës së SHBA, të rinjtë pasqyrojnë indiferentizmin e përgjithshëm karshi politikës. Edhe politika në Rusi nuk përbën interes për të rinjtë. Nga të dhënat e studimit 84 përqind e të rinjve pohojnë se nuk janë fare të interesuar për zhvillimet politike. Duke pasur parasysh se Rusia nuk ka ndonjë ndikim në Shqipëri, numri i të rinjve që shfaqen të mosinteresuara është më i madh.

Të rinjtë e pasqyrojnë nivelin e indiferentizmit politik edhe në familje. 45 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se nuk diskutojnë kurrë për politikën me familjen apo të afërmit. Në këtë grupim nuk bëjnë dallim të rinjtë e zonave urbane apo rurale. Vetëm 4 përqind e të rinjve pohojnë se diskutojnë shumë shpesh me prindërit për politikë.

Përputhja e bindjeve politike të të rinjve me ato të prindërve është kuriozitet social. 28 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë

FIGURA 56: Personalisht, sa të interesuar jeni me të mëposhtmet:





FIGURA 57: Për mendimin tuaj, sa të mirëpërfaqësuar janë interesat e të rinjve në politikën Kombëtare?




në se ato nuk përputhen aspak. Në krahasim me të dhënat e vitit 2015, kur ky tregues ishte 13.8 përqind vërejmë se ka një prirje drejt pavarësisë më të madhe për të gjykuar mbi politikën.<sup>35</sup> Një tregues që vërteton këtë ndryshim është fakti se në vitin 2015 ishin 31.7 përqind e të rinjve që pohojnë se bindjet e tyre përputheshin me ato të prindërve, ndërkohë që të dhënat e fundit tregojnë se 19 përqind e të rinjve pohojnë këtë prirje. Ky ndryshim mund të jetë rezultat i zhgënjimit dhe i indiferencës për politikën.

Përsa i përket përfaqësimit të rinjve në politikë, 31 përqind e tyre pohojnë se ata nuk janë aspak të përfaqësuar, ndërsa 30 përqind deklarojnë se janë pak të përfaqësuar. Shifra të tilla janë disi më inkurajuese se të dhënat e vitit 2015, ku 54.5 përqind e të rinjve mendonin se ata ishin pak të përfaqësuar në politikë.<sup>36</sup>

Sjellja dhe angazhimi elektoral i të rinjve është i rëndësishëm, duke patur parasysh se ata përbëjnë një elektorat të konsiderueshëm në Shqipëri.

41 përqind e të rinjve me të drejtë vote kanë votuar, ndërsa 13 përqind e tyre nuk kanë marrë pjesë në votime. Përqindja e pjesëmarrjes në votime rritet sipas grupmoshave (18–21) 57 përqind, (22–25) 74 përqind dhe (26–29) 80 përqind, çka dëshmon ndër-gjegjësimin mbi rëndësinë e votës në një proces zgjedhor, në krahasim me vitin 2015, kur këtë e pohojnë 28.3 përqind e të rinjve.<sup>37</sup>

FIGURA 58A: **Keni votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare?**




Lidhur me vullnetin e tyre për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, 69 përqind e të rinjve të intervistuar kanë pohuar se do të merrnin pjesë si votues. Të rinjtë nga zonat rurale shprehin një përqindje më të lartë pjesënmarre me 72 përqind përkundëjt atyre nga zonat urbane me 66 përqind. Të rinjtë nga qytetet e tjera kryesore shprehin më shumë mbështetje për të votuar (69 përqind e 73 përqind), kundërt 60 përqind e të rinjve nga Tirana. Sjellja elektorale e të rinjve nuk karakterizohet nga indiferenca pasi, siç duket, procesi zgjedhor është momenti kur ata ndjejne peshën dhe ndikimin që mund të ketë vota e tyre.

Karriera politike për të rinjtë nuk është dicka e lakmueshme. Kur të rinjtë janë pyetur nëse do të kishin dëshirë të merrnin një funksion politik, 52 përqind e tyre janë përgjigjur në mënyrë mohuese. Nga ana tjetër, 26 përqind e të rinjve janë shprehur se ndoshta mund ta merrnin një funksion të tillë cka pasqyron dilemat rinore në angazhimin politik. Në këtë drejtim meshkujt shfaqin një prirje më të fortë për karrierë politike (29 përqind), përkundërt femrave (23 përqind).

Mënyrat e informimit për politikën janë një aspekt i rëndësishëm për të rinjtë, duke patur parasysh rolin që ata luajnë për krijimin e opinioneve dhe gjykimeve të ndryshme.

FIGURA 58 B: **Keni votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare?**



63 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se burimi i informacionit për politikën është Interneti, duke dëshmuar një rritje të ndieshme në krahasim me vitin 2015, kur këtë e deklarorin 39 përqind e tyre. Në krahasim me 2015 është rritur numri i të rinjve në zonat rurale, që përdorin internetin si burim informacioni për politikën. Televizioni vazhdon të konsiderohet mjeti klasik i informimit për të rinjtë. 73 përqind e tyre deklarorin se informohen përmes TV. Në këtë rast vërehet një rënie e lehtë me vitin 2015, kur 87 përqind e të rinjve deklarorin TV si mjet komunikimi.<sup>38</sup>

Shtypi i shkruar dhe Radio kanë humbur gradualisht peshën e tyre si mjet informimi përballë teknologjive të reja të komunikimit. 96 përqind e të rinjve deklarorin se nuk informohen mbi zhvillimet politike përmes shtypit të përditshëm dhe 98 përqind shprehin në këtë mënyrë për radion. Edhe diskutimet në familje apo me miqtë për politikën nuk bëjnë pjesë të mjetet e informimit për të rinjtë. Respektivisht, 82 përqind dhe 85 përqind e të rinjve pohoj-


në se bisedat me familjen apo me shokët nuk shërbejnë si burim informacioni për politikën. Kjo shënon një rritje të dukshme në vitin 2015 kur nga 40 përqind e të rinjve e pohorin këtë.

Megjithëse rrjetet sociale janë shumë të përhapura mes të rinjve, vetëm 24 përqind e tyre i përdorin ato si burime informacioni për ngjarjet e zhvillimet politike, ndërsa 76 përqind pohojnë të kundërtën. Të rinjtë në rrjetet sociale nuk shkëmbejnë informacion politik, por përqëndrohen në tema të tjera.

Rreth 23 përqind e të rinjve të intervistuar deklarorin se bindjet e tyre politike janë të majta, 29 përqind të qendrës dhe 18 përqind janë me bindje të djathta.

Qëndrimet e të rinjve ndaj çështjeve të tilla si pabarazia sociale, pronësia publike, roli i shtetit në shoqëri përcaktojnë nivelin e bindjeve e të gjykimit të tyre për elementët të politikave publike.

FIGURA 59 A: Nëse do të mbaheshin zgjedhjet parlamentare dhe ju do të kishit të drejtën e votës, do të shkonit të votonit?



67 përqind e të rinjve janë dakort që të ardhurat mes të varferve e të pasurve duhet të jenë më të barabarta. Niveli i pabarazisë sociale i prek drejtpërdrejt të rinjtë. Tërheq vëmendjen shifra që 58 përqind e të rinjve të shtresave të pasura janë dakort me këtë parim, duke dëshmuar se, nga përpjekjet për barazi sociale, mund të përfitojnë të gjithë.

55 përqind e të rinjve janë dakort që shteti të rrisë pronësinë e vet në ndërmarrje e biznese, çka dëshmon se menaxhimi publik i ndërmarrjeve nuk është një tabu në kushtet e ekonomisë së tregut.


80 përqind e të rinjve kërkojnë që shteti të marrë më shumë përgjegjësi dhe 80 përqind e të rinjve të shtresave të pasura janë dakort me këtë parim të shtetit social.

Konkurrenca nuk shihet si dicka e dëmshme nga të rinjtë shqiptarë. 32 përqind e tyre nuk janë dakord me pohimin se konkurrenca në kushtet e ekonomisë së tregut nxjerr në dukje anën më të keqe të njerëzve. Të rinjtë e zonave urbane janë më shumë mbështetës të kësaj qasjeje me 36 përqind, përkundër atyre të zonave rurale, me 25 përqind, ku konkurrenca krijon më shumë probleme.

78 përqind e të rinjtë vlerësojnë se puna e shumtë dhe e palodhur sjell një jetë më të mirë në plan afatgjatë, duke pasqyruar qasjen e tyre etike në raport me punën.

Besimi tek institucionet është thelbësor në një sistem demokratik për të garantuar kohezionin social dhe qëndrueshmërinë.

FIGURA 59 B: Nëse do të mbaheshin zgjedhjet parlamentare dhe ju do të kishit të drejtën e votës, do të shkonit të votonit?



Në këtë grup institucionesh përfshihen që nga qeveria, presidenti, parlamenti, partitë politike, pushteti lokal e deri tek organizatat e shoqërisë civile.

Besimi i të rinjve shqiptarë tek institucionet kryesore të vendit, te parlamenti, qeveria dhe presidenti, paraqitet i ulët. 51 përqind e tyre pohojnë se nuk i besojnë institucionit të presidentit, 51 përqind nuk i besojnë parlamentit dhe 48 përqind nuk i besojnë qeverisë. Në raport me të dhënat e vitit 2015 vihet re një rënie e lehtë e këtij mosbesimi, por sërish mbetet i lartë.<sup>39</sup>

Të rinjtë shprehin nivel të lartë mosbesimi ndaj organizatave të shoqërisë civile. 40 përqind e tyre e pohojnë këtë. Edhe niveli i besimit te partitë politike është shumë i ulët. 58 përqind e të rinjve deklarojnë se nuk kanë besim tek ato.

Edhe qeverisja vendore nuk gëzon shumë besim mes të rinjve. 39 përqind e tyre deklarojnë se nuk i besojnë asaj,

Media e sindikatat kanë sërish nivel të ulët besimi. 30 përqind e të rinjve e 44 përqind deklarojnë se nuk u besojnë atyre. E njëj-

ta gjë mund të thuhet edhe për kompanitë e mëdha. Vetëm 6 përqind u besojnë atyre plotësisht, ndërsa 31 përqind e të rinjve nuk u besojnë. 28 përqind e të rinjve deklarojnë se u besojnë disi bankave, kundrejt 25 përqind që nuk u besojnë fare.

Të rinjtë shfaqin besim të dobët ndaj lëvizjeve vullnetare. 28 përqind e tyre u besojnë disi atyre, ndërsa 27 përqind nuk kanë besim te këto lëvizje.

OKB, OSBE, NATO luajnë rol edhe brenda Shqipërisë. Por besimi i të rinjve te roli e rëndësia e tyre për ne ndryshon sipas shkallës së informacionit e perceptimit të të rinjve. Bashkimi Europian është destinacion për shqiptarët dhe të rinjtë shqiptarë e mbështesin plotësisht këtë në masën 50 përqind, OKB në 42 përqind, OSBE në 37 përqind, NATO në 42 përqind.

Cilësia e demokracisë është element i rëndësishëm, kur gjykohehet si sistem politik qeverisjeje nga ana e të rinjve.

Lidhur me nivelin e demokracisë në vend, 25 përqind e të rinjve shprehin të pakënaqur me cilësinë e saj, 38 përqind pohojnë

FIGURA 60: "Të ardhurat midis të pasurve dhe të varfërve duhet të jenë më të përafërta"





FIGURA 61: Sa të kënaqur jeni me gjendjen e demokracisë në përgjithësi (në Shqipëri)?



se janë disi të kënaqur dhe vetëm 11 përqind janë shumë të kënaqur. Vërejmë një rritje të lehtë të përqindjes së të rinjve nga 2015, kur 22.5 përqind pohonin se ishin disi të kënaqur. Megjithatë, statistikat pasqyrojnë nivelin e përgjithshëm të ulët të besimit në institucionet e ndryshme, që përbëjnë sistemin demokratik në një vend.

55 përqind e të rinjve janë plotësisht dakort me faktin se demokracia është një formë e mirë qeverisjeje, përkundër 4 përqind që nuk janë dakort me këtë pohim. Kjo shprehet me refuzimin që ata i bëjnë diktaturës si formë qeverisjeje më e mirë se demokracia në rrethana të caktuara, kur 45 përqind e tyre e refuzojnë atë, përkundër 15 përqind që kanë mendim të kundërt.

52 përqind e të rinjve pëlqejnë një lider që qeveris me dorë të fortë për të mirën publike. Te të rinjtë ende nuk është zhvilluar vetëdija, se shpesh, liderërt e dorës së fortë rrezikojnë të bien në autoritarizëm. Ata e ndjekin këtë logjikë edhe kur 61 përqind e tyre janë dakort se vendi ka nevojë për një parti të fortë, që përfaqëson interesin popullor.

Pjesëmarrja në votime në demokraci është domethënëse për çdo qytetar. 62 përqind e të rinjve bien dakort me këtë pohim, duke nënkuptuar se vota është mjet i rëndësishëm i sistemit demokratik.

Të rinjtë kërkojnë një rol në politikë. 60 përqind e tyre pohojnë se duhet të kenë më shumë mundësi për të folur në politikë. Por, nga ana tjetër, 46 përqind e të rinjve deklarojnë se politikanët nuk duan t'ia dinë për opioninet e të rinjve, çka reflekton mosbesimin e tyre të përgjithshëm për politikën.

Konceptet e të rinjve për sistemin politik në demokraci janë të qarta. 53 përqind e tyre pohojnë se opozita politike është e nevojshme për një demokraci të shëndetshme.

Të rinjtë nuk e shohin dhunën si mjet për të zgjidhur konfliktet. 60 përqind e tyre e kundërshtojnë përcaktimin se në çdo shoqëri

ka konflikte që mund të zgjidhen vetëm me dhunë. Viktimat e para të cdo dhune janë të rinjtë dhe vetëdija e tyre përforcon qasjen e zgjidhjes së konflikteve me mjete të tjera.

48 përqind e të intervistuarve pohojnë se nuk dinë shumë nga politika. Kjo prirje është më e fortë me 54 përqind te të rinjtë e zonave rurale përkundër atyre në qytet me 44 përqind.

Të rinjtë e shfaqin indiferetizmin politik, kur 86 përqind e tyre pohojnë se nuk kanë nënshkruar ndonjë peticion me kërkesa politike apo ndonjë listë me kërkesa të tilla.

Protestat janë një element i demokracisë, por 83 përqind e të rinjve pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në organizime të tilla, çka tregon një apati sociale lidhur me format e reagimit qytetar në një shoqëri demokratike. Edhe pjesëmarrja në aktivitete vullnetare nuk përbën interes për të rinjtë. 75 përqind e tyre pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla, duke dëshmuar për një prirje pasive.

Tendenca e të rinjve për të qëndruar larg politikës dëshmohehet nga fakti se 87 përqind e tyre pohojnë se nuk kanë punuar për ndonjë parti politike apo grup politik.

Vendimet e të rinjve me karakter etik janë në një fazë të hershme. 92 përqind e të rinjve deklarojnë se nuk kanë blerë mallra për arsye politike apo mjedisore. Fushtatat e bojkimit të produkteve për arsye politike apo mjedisore janë risi për shoqërinë shqiptare dhe të rinjtë pasqyrojnë një përfshirje të paktë në këtë drejtim.

Mosangazhimi politik i të rinjve shprehet me faktin se 90 përqind e tyre nuk kanë marrë pjesë në aktivitete politike on-line përmes rrjeteve sociale

Mënyra se si të rinjtë i përcaktojnë dhe i vlerësojnë prioritetet e qeverisjes pasqyrojnë vetëdijen e tyre mbi procesin e zhvillimit të vendit.

FIGURA 62: **Jeni dakort apo jo me pohimet e mëposhtme:**




FIGURA 63: Keni provuar të bëni secilën si mëposhtë:





FIGURA 64: Deri në ç'masë duhet qeveria të fokusohet në secilin prej objektivave të mëposhtëm:



80 përqind e të rinjve të intervistuar e konsiderojnë luftën ndaj kriminit të organizuar e korrupsionit prioritet për qeverinë. Ky fakt është edhe tregues i ligjërit publik të vazhdueshëm gjatë periudhës 2015–2017 lidhur me reformën në drejtësi e aspekte të tjera.

49 përqind e të rinjve që pohojnë se qeveria duhet të angazhohet shumë për ta luftuar emigrimin e paligjshëm të personave. Për këtë çështje, femrat kanë një mbështetje më të madhe me 56 përqind, përkundër djemve me 46 përqind. Të rinjtë nga Tirana shprehën mbështetje me 58 përqind përkundër atyre nga qytetet kryesore me 46 përqind.

Forcimi i identitetit kombëtar është një element, që të rinjtë shqiptarë e vlerësojnë si prioritet të rëndësishëm për qeverinë. 48 përqind e të rinjve të intervistuar deklarojnë se qeveria shqiptare duhet të përqipet më shumë në lidhje me këtë aspekt. Globalizimi, migracioni, konfliktet me fqinjët, roli i medias për aspektet e identitetit i shtojnë të rinjtë të kërkojnë ruajtjen e forcimin e identitetit kombëtar.

80 përqind e të rinjve e konsiderojnë zhvillimin dhe rritjen ekonomike si një prioritet të rëndësishëm kombëtar ku kërkohet angazhim nga qeveria shqiptare. Tërheq vëmendjen fakti që 60 përqind e të rinjve pohojnë se fuqizimi i forcës ushtarake dhe sigurisë kombëtare është me rëndësi.

Ruajtja e natyrës dhe e mjedisit është një prioritet me rëndësi për ata. 77 përqind e të rinjve shprehën se qeveria duhet të përqipet më shumë lidhur me ruajtjen e natyrës e mjedisit.

Liritë sociale dhe ekonomike përbëjnë themelin e zhvillimit të shoqërisë ku vëmendja dhe vetëdija e të rinjve është e lartë. Garantimi i të drejtave e liritë të njeriut nga qeveria konsiderohet si element shumë i rëndësishëm për 79 përqind të të rinjve, ndërkohë që 79 përqind e tyre shprehën për garancinë e sigurinë sociale.

Duke patur parasysh rolin e të rinjve dhe të grave në shoqëri 71 përqind e të rinjve të intervistuar pohojnë se duhet të forcohet pozita sociale e grave dhe 75 përqind pohojnë se duhet të forcohe statusi shoqëror i të rinjve.

Vetëm 44 përqind pohojnë se qeveria duhet të punojë më shumë për nxitjen e shtimit të popullsisë, çka tregon se për të rinjtë vetëdija demografike është ende e ulët.

Prioritetet e zhvillimit ekonomik lidhen drejtpërdrejt me perspektivën e jetës së të rinjve, duke i bërë ata të vlerësojnë cdo element që ndikon te punësimi. Për këtë arsye nxitja e mbështetja e sipërmarrjes private nga qeveria konsiderohet një prioritet i rëndësishëm nga 61 përqind e të rinjve, ndërsa ulja e papunësisë shihet si detyrë parësore për qeverinë nga 84 përqind e të rinjve.

Kur të rinjtë janë pyetur mbi perspektivën e zhvillimit ekonomik në 10 vitet e ardhshme, 27 përqind e tyre kanë pohuar se ajo do të përmirësohet në mënyrë të ndieshme, që shënon rritje në krahasim me 11.6 përqind, që e pohonin këtë në 2015. 32 përqind deklarojnë se përmirësimi i saj do të jetë mesatar dhe kjo shifër është më e ulët se në vitin 2015, kur këtë e pohonin 64.1 përqind e të rinjve. Në këtë rast vërejmë një raport të ekuilibruar mes optimistëve dhe skeptikëve nga ana e të rinjve në vite lidhur me perspektivën e zhvillimit ekonomik të vendit.

Roli dhe pesha e Shqipërisë në politikën rajonale dhe ndërkom-bëtare, si dhe ballafaqimi i vlerave të Shqipërisë me ato të BE pasqyrojnë nivele informacioni dhe perceptime të ndryshme mes të rinjve.

31 përqind e të rinjve pohojnë se interesat kombëtare nuk theksohen si duhet në politikën globale, duke patuar parasysh Shqipërinë si vend i vogël. Vetëm 32 përqind e tyre besojnë se rëndësia e Shqipërisë do të rritet disi në vitet e ardhshme. Megjithatë, 70 përqind e të rinjve shprehin se janë krenarë që janë qytetarë të vendit të tyre. Në zonat rurale kjo përqindje është më e lartë me 76 përqind, në krahasim me zonat urbane, ku 66 përqind e të rinjve mbështesin këtë pohim.


Megjithëse Shqipëria nuk është prekur nga valë masive emigrantësh apo refugjatësh, 31 përqind e të rinjve pohojnë se nuk do të pranohet më shumë emigrantë apo refugjatë në vendin e tyre, përkundër 16 përqind që e pranojnë një prani më të madhe të tyre në vend. Të rinjtë nga zonat rurale shfaqin një prirje më kundërshtuese në këtë drejtim me 34 përqind, përkundër 29 përqind e të rinjve nga zonat urbane. Duke patuar parasysh se Shqipëria ka një numër të konsiderueshëm emigrantësh në vende të tjera, prirja kundërshtuese ndaj emigrantëve prej të rinjve shqiptarë tregon për një reagim instiktiv në raport me fenomenet, që ka shfaqur emigracioni ynë në vende të tjera.

Të drejtat e grave, minoriteteve të ndryshme, personave me aftësi të kufizuar dhe komuniteteve fetare janë vlerësuar nga të rinjtë në përputhje me bindjen e informacionin që ata kanë rreth tyre.

43 përqind e të rinjve pohojnë se gratë nuk kanë shumë të drejta. Këtë pohim e mbështesin 55 përqind e femrave përkundrejt 32 përqind të meshkujve. 40 përqind e të rinjve pohojnë se gratë kanë mjaft të drejta.

Për të drejtat e minoriteteve etnike të rinjtë kanë perceptime të ndryshme. 36 përqind e tyre pohojnë se ata nuk kanë shumë të drejta. Për këtë shprehin 50 përqind e të rinjve në Jugperëndim, përkundrejt 37 përqind në Veri e 17 përqind në Juglindje, çka lidhet me praninë më të madhe të minoriteteve në këto zona.

FIGURA 65: Cilat janë vlerat më të rëndësishme për ju personalisht (Të renditura):



■ E para (N=1.200)  
 ■ E dyta (N=1.192)  
 ■ E treta (N=1.189)



Edhe për LGBT 52 përqind e të rinjve, të nxitur nga fushatat mediatike për këtë kategori, pohojnë se nuk kanë shumë të drejta.

60 përqind e të rinjve pohojnë se njerëzit me aftësi të kufizuara nuk kanë shumë të drejta, ndërkohë që, 66 përqind e tyre besojnë se edhe të varfërit nuk kanë shumë të drejta. Në këtë rast është interesant fakti se edhe 69 përqind e të rinjve të shtresave të pasura besojnë se të varfërit nuk kanë shumë të drejta.

46 përqind e të rinjve shprehen se besimtarët e feve të ndryshme kanë të drejta, ndërkohë që 20 përqind e tyre pohojnë se ata nuk kanë mjaft të drejta.

61 përqind e të rinjve pohojnë se rinia ka mjaft të drejta, duke shprehur vetëdijen për të drejtat që gëzojnë në vend. 44 përqind e të rinjve të intervistuar thonë se fëmijët kanë mjaft të drejta, ndërsa 33 përqind e tyre pohojnë se fëmijët nuk kanë të drejta.

Të rinjtë janë vënë përballë ballafaqimit dhe krahasimit të vlerave të shoqërisë demokratike në vendin e tyre me ato të BE. Këto vlera përfshijnë demokracinë, sundimin e ligjit, mirëqenien ekonomike, barazinë sociale, punësimin, sigurinë, etj. Në këtë përballje krahasuese, të rinjtë vlerësojnë dallimet e ndieshme mes këtyre vlerave në vend me ato të BE-së. Sipas 24 përqind të të rinjve të intervistuar, vlera e demokracisë në vend është e keqe; 5 përqind pohojnë se është e mire, ndërsa, 51 përqind e tyre pohojnë se ajo është e mirë në BE. Sundimi i ligjit për 33 përqind të të rinjve është shumë keq, ndërsa, sipas 54 përqind të tyre është shumë mirë në BE. 26 përqind e të rinjve thonë se, situata e të drejtave të njeriut është shumë e keqe ndërsa 61 përqind pohojnë se është shumë e mirë në BE. Mirëqenia ekonomike e qytetarëve në Shqipëri për 39 përqind të të rinjve është shumë e keqe ndërsa për 60 përqind ky element është shumë mirë në BE. Punësimi, për 49 përqind të të rinjve në vend është shumë keq, ndërsa në BE, sipas 59 përqind të tyre është shumë e mirë. Barazia, për 30 përqind të të rinjve është shumë e keqe, ndërsa 60 përqind pohojnë se në BE është shumë e mirë. Siguria, për 29 përqind të të rinjve është shumë e keqe dhe për 54 përqind të rinjve në BE siguria është shumë e mirë. Për 31 përqind të të rinjve liria individuale është shumë keq, ndërsa 62 përqind pohojnë se në BE është mire.

Të rinjtë shqiptarë kanë renditur si vlerën më të rëndësishme mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe punësimin. Në klasifikimin e vlerave më të rëndësishme ato janë renditur në tre vendet e para. Për të rinjtë, vlera më e rëndësishme, e renditur në vend të parë, është mirëqenia ekonomike e qytetarëve me 22 përqind dhe e punësimit me 20 përqind, në vend të dytë. Këto dy vlera, mirëqenia ekonomike e qytetarëve dhe punësimi janë renditur përsëri në vend të tretë, me 18 përqind mirëqenia ekonomike dhe me 17 përqind punësimi.

Vetëdija e identitetit kombëtar e lokal të rinjtë është e qëndrueshme, duke marrë parasysh ndikimin që ushtrojnë globalizmi e emigrimi. 77 përqind e të rinjve të intervistuar e ndjejnë veten plotësisht si shqiptarë. Meshkujt e kanë më të fortë këtë ndjesi me 80 përqind, përkundër femrave me 73 përqind.

24 përqind e të rinjve e ndjejnë veten plotësisht si europianë, duke patur parasysh të drejtat e liritë e të riut europian, ndërsa 17 përqind nuk ndjehen fare si të tillë. 34 përqind e shohin veten si

qytetarë të botës, duke përjetuar globalizimin, ndërsa 57 përqind e të rinjve ndjehen si qytetarë të rajonit, ku banojnë. 76 përqind e ndjenë veten si qytetarë të zonës ku kanë lindur.

## KONKLUZIONE

Të rinjtë vazhdojnë të shfaqin mosbesim dhe mos interes ndaj procesit politik, duke dëshmuar një apati dhe indiferencë të përgjithëshme. Pjesëmarrja e sjellja e tyre elektorale është aktive, çka tregon se kanë zgjedhur procesin e votimit për të shfaqur interesin e tyre për politikën.

Shqetësimet e të rinjve për politikën dhe prioritetet e zhvillimit social-ekonomik të vendit janë të qarta, përdërisa i rendisin mirëqenien ekonomike e punësimin si elementë kyç të zhvillimit.

Konceptet e tyre për liritë e të drejtat e njeriut janë në përputhje me normat e shoqërisë së hapur e liberale.

Ata ndjehen krenarë për identitetin e tyre kombëtar dhe besojnë se vetëdija e tyre si europianë do të jetë e plotë, kur të gëzojnë liritë dhe të drejtat e qytetarëve europianë.



# 10

## PYETJE KONFIDENCIALE

- Të rinjtë në Shqipëri e vlerësojnë shëndetin e tyre si të mirë dhe janë të kënaqur me paraqitjen e tyre fizike.
- Një e treta e të rinjve, shumica mbi 25 vjec, janë duhanpirës të rregullt, ndërkohë që pothuaj askush nuk pranon se përdor kanabis.
- Gjysma e të rinjve janë seksualisht aktivë, por vetëm 30 përqind prej tyre përdor rregullisht masa mbrojtëse.
- Rreth gjysma e të rinjve kanë ndjenja të konsiderueshme nacionaliste dhe ide fikse mbi atë që përfaqëson karakterin e vërtetë shqiptar dhe se si të huajt duhet të përshtaten në Shqipëri.
- Shumica e të rinjve i rri larg sjelljeve kriminale dhe të dhunshme por, nga ana tjetër, një e katërta e tyre tregon një tolerancë dhe pranueshmëri në rritje të sjelljeve jo-etike kopjimi në provimet e shkollës.
- Nuk ka një stil prindërimi mbizotërues në Shqipëri. Të rinjtë janë rritur nga prindërit e tyre me stile shumë të ndryshme, që variojnë nga mënyra kontrolluese dhe conservative, deri te ajo besuese dhe liberale. Prania e dhunës fizike dhe verbale në fëmijëri është e pranishme në të paktën gjysmën e rasteve.

### SHËNDETI DHE KONSUMI

Shumica e të rinjve shqiptarë, mbi 60 përqind, kanë besim se gëzojnë shëndet shumë të mirë, madje dhe të shkëlqyer. Një e treta pohon se shëndeti i tyre është i mirë, ndërkohë, ata që ankohen për shëndet jo të mirë janë në numra shumë të vegjël. Kjo është pasojë e natyrshme e moshës së atyre që pyeten. Në Shqipëri shumë sëmundje si hipertensioni dhe diabeti që shfaqin simptoma më vonë janë në rritje. Shfaqja e tyre lidhet edhe me

zakone të këqija të të ushqyerit dhe të ushtrimit fizik në moshë të re. Ndaj ka nevojë për më shumë informacion dhe fushata ndër-gjegjësuere për dietën dhe aktivitetin fizik.

Të rinjtë duken se janë shumë të kënaqur me paraqitjen e tyre fizike, gjë që vlen për 28 përqind të tyre. 42 përqind janë më së shumti të kënaqur, ndërkohë që 19 përqind janë deri diku të kënaqur. Kjo lë mënjanë vetëm 11 përqind, që janë të pakënaqur më mënyrën se si duken. Këto të dhëna, që bazohen mbi vetëdeklarimin, mund të mos tregojnë, në fakt, detajet e një tjetër fenomeni. Bulizmi dhe konflikti në shkolla për shkak të karakteristikave të paraqitjes fizike, janë ndikuese për shumë adoleshentë dhe duhe trajtuar.

Shumica e të rinjve të pyetur, 67 përqind, nuk pinë duhan dhe nuk kanë qenë duhanpirës, ndërkohë që 4 përqind e kanë lënë duhanin. Pjesa e mbetur, një e treta e të rinjve përdorin duhan. Prej këtyre, gjysma janë duhanpirës të përditshëm dhe gjysma tjetër e pi me raste. Këto shifra janë shumë të ndryshme për femrat dhe meshkujt. 25 përqind e meshkujve të rinj shqiptarë pinë duhan çdo ditë, krahasuar me 4 përqind të vajzave, që bëjnë të njëjtën gjë. Po ashtu, numri i atyre që pinë më raste dyhan është shumë më i lartë te meshkujt se sa te femrat. Tendeca për të pirë duhan është më e lartë në moshën mi 25 vjeç. Një e treta e tyre janë duhanpirës të rregullt.

Gjysma e të rinjve të pyetur thonë se nuk pinë kurrë alkol. Ndërkohë që 38 përqind thonë se e pinë rrallë. Vetëm 9 përqind pinë në fundjavë ose disa herë gjatë javës. Meshkujt raportojnë më shumë se femrat konsumin e alkolit me raste ose rrallë. Femrat më së shumti nuk përdorin asnjëherë alkol.

40 përqind e të rinjve thonë se përdorimi i alkolit është i papranueshëm, ndërkohë që 47 përqind thonë se është i pranueshëm me raste ose në ndodhi të vecanta. Pranueshmëria e alkolit me raste dhe evenimente rritet me rritjen në moshë dhe në nivelin e arsimit.




**FIGURA 66: Pini duhan?****FIGURA 67: Konsumoni alkool?**

FIGURA 68: Cili nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë përvojën tuaj seksuale?




Shumica dërrmuese e të rinjve mohan se ka konsumuar ose konsumon marihuanë. Vetëm 3 përqind e tyre e kanë përdorur në disa raste dhe shumica e këtyre, janë meshkuj mbi 25 vjeç.

### JETA SEKSUALE

43 përqind e të rinjve nuk kanë pasur ende një përvojë seksuale, ndërkohë që 24 përqind kanë pasur një të tillë me një partner të vetëm. Një e katërta e tyre kanë pasur ndërkohë më shumë se sa një partner seksual. Rreth 6 përqind nuk ndiheshin të gatshëm të jepnin një përgjigje dhe 5 përqind e të rinjve, refuzoi.

31 përqind e meshkujve të rinj janë ende të virgjër, krahasuar kjo me 58 përqind të femrave. Meshkujt përbëjnë dhe shumicën e atyre që pohojnë se kanë pasur partnerë seksualë të shumtë. Numri i të rinjve që kanë më shumë se sa një partner në jetën e tyre seksuale është në rritje të konsiderueshme nga vitet e kaluara. Përgjithësisht, mosha në të cilën të rinjtë kanë eksperiencën e tyre të parë seksuale është 18 vjeç, me një diferencë të vogël gjinore, për meshkujt është 17 dhe për femrat është 19 vjeç.

FIGURA 69: Në ç'moshë keni përjetuar marrëdhënien tuaj të parë seksuale?



30 përqind e të rinjve marrin masat e duhura mbrojtëse gjatë aktivitetit të tyre seksual në mënyrë të rregullt, kurse një e treta e tyre e bën këtë vetëm me raste. 23 përqind nuk përdorin fare mbrojtje gjatë raportit seksual dhe shumica në këtë grup janë vajzat e reja. Të rinjve nuk iu mungon informacioni mbi masat mbrojtëse, sepse vetëm 4 përqind e tyre thonë se nuk kanë informacionin përkatës. Përqindja e përdoruesve të rregullt të masave mbrojtëse është shumë më e lartë në zonat urbane (34 përqind) se sa në ato rurale (24 përqind).

Për një të katërtën e të rinjve, mungesa e marrëdhënieve seksuale para martesës ose, siç përdoret rëndom si term, 'virgjëria' mbetet një vlerë për të dyja gjinitë. Një e treta e të intervistuarve beson se kjo është një vlerë vetëm për gjininë femërore. Një grup tjetër nuk i atribuon asnjë vlerë virgjërisë, duke thënë se ajo është ose një barrë e panevojshme për të rinjtë (15 përqind) ose thjesht një koncept i vjetëruar (20 përqind). Meshkujt besojnë më shumë se sa femrat që virgjëria është një vlerë për vajzat. Numri i njerëzve që nuk besojnë se ajo është një vlerë rritet me moshën dhe nivelin arsimor të të pyeturve. Megjithatë mbetet shumë suprizues fakti se konsiderata e përgjithshme për virgjërinë mbetet pothuajse e pandryshueshme që nga viti 2011.

### SHQIPTARËT 'E VËRTETË'

Rreth gjysma e të rinjve në Shqipëri besojnë se shqiptarët e vërtetë janë vetëm ata me gjak shqiptar. Një e treta nuk bie dakord mbi këtë pohim, ndërkohë që 9 përqind janë të pavendosur plotësisht. Rreth 50 përqind e të pyeturve thanë se të huajt, që jetojnë në Shqipëri duhet të përshkatan dhe të respektojnë zakonet dhe traditat shqiptare, pra të jenë konform këtyre. Një e pesta e përgjigjeve ishin kundër këtij pohimi.

FIGURA 70: Përdorni profilaktikë apo metoda për parandalimin e shtatzënisë?




FIGURA 71 A: Sa jeni dakort me të mëposhtmet:





FIGURA 71 B: Sa jeni dakort me të mëposhtmet:



Pak më shumë se sa gjysma e të pyeturve thanë se do të ishte më mirë në se Shqipëria do të banohej vetëm nga "shqiptarët e vërtetë", ndërkohë që 30 përqind nuk ishin dakord me këtë variant.

Duket se ka një ndarje të rinjtë, ku një grup ka përqafuar fort përcaktimet dhe temat nacionaliste, ndërsa gjysma tjetër, pak më e dobët nga numrat, ka një qëndrim më të relaksuar dhe kozmopolit kundrejt këtyre çështjeve.

## EKSPERIENCA E RITJES DHE FËMIJËRISË

Të rinjtë, më së shumti, bien dakord me pohimin se ka nevojë për një disiplinë të fortë nga prindërit. Rreth 58 përqind e tyre e pranojnë këtë, ndërkohë që vetëm 22 përqind shprehin kundërshti.

Rreth gjysma e të rinjve besojnë se mungesa e vullnetit është arsyeja për të cilën disa njerëz nuk kanë sukses në jetë. Një e pesta e kampionit nuk janë dakord me këtë pohim, duke thënë se për të rinjtë ka dhe faktorë të tjerë që luajnë rol në këtë drejtim si, për shembull, fati dhe rastësia.

Të rinjtë janë të ndarë, kur vlerësojnë në se dikush duhet falur për një fyerje ndaj nderit të tyre apo jo. 47 përqind besojnë se një fyerje e tillë s'mund të falet apo të harrohet.

Të rinjtë janë pyetur edhe për përfshirjen e tyre në aktivitete të ndryshme me natyrë ilegale apo jo-etike. Në masë dërrmuese ata mohojnë të jenë përfshirë në vjedhje, në përdorimin e drogave të rënda apo dhe në frekuentimin e shkollës, ndërkohë që ishin nën influencën e alkolit. Po ashtu, ata mohojnë të kenë shkatërruar ndonjëherë qëllimisht pronën e tjetrit. Tre të katërtat e të rinjve mohojnë të kenë qëlluar apo kërcënuar ndonjëherë dikë tjetër, ndërkohë që 8 përqind e tyre e ka bërë shpesh këtë gjë. Sjelljet "e këqija" më të shpeshta janë ato që bëhen brenda në shkollë si mungesa në mësim, ndërkohë që prindërit i dinë në shkollë, si dhe kopjimi në provime. Vetëm gjysma e të rinjve mohan se i ka praktikuar këto sjellje të gabuara, ndërkohë që një e pesta raporton se i bën shpesh ato. 23 përqind e të rinjve pranojnë se kanë kopjuar më shumë se njëherë në provime, duke demonstruar kështu një pranueshmëri të këtij fenomeni, pasi që

ndihen të gatshëm ta ndajnë këtë fakt me të tjerët ose, edhe të mburren me këtë gjë.

Të rinjtë rrëfejnë gjëra mjaft interesante përsa i përket stilit të prindërimit dhe të edukimit nga familjarët e tyre. Dy të tretat e të rinjve pranojnë se prindërit iu kanë shpjeguar shpesh pse duhet të zbatonin rregullat. 37 përqind e tyre janë ftuar që t'i vendosnin këto rregulla së bashku me prindërit, duke u përfshirë aktivisht në këtë proces. Më shumë se 28 përqind e të rinjve nuk e kanë njohur asnjëherë këtë gjë. Ata nuk janë ftuar ndonjëherë të jenë pjesë e caktimit të rregullave.

Gjysma e të rinjve pranojnë se prindërit e tyre kanë qenë në dijeni të sjelljes dhe mbarëvajtjes së tyre në shkollë. 15 përqind thonë se prindërit nuk kanë pasur fare dijeni për këto çështje. Pjesa tjetër pohon se prindërit kanë pasur një pjesë të informacionit, por nuk i kanë ditur të gjitha.

Gjysma e të rinjve të pyetur mohojnë se kanë ngrënë shpullat nga prindërit, kur janë sjellë keq, ndërkohë që kjo ka nddhur shpesh për të paktën 20 përqind të tyre. Më shumë se gjysma e të rinjve janë qortuar dhe kritikuar shpesh kur nuk kanë përmbushur pritshmëritë e familjes. Një e katërta tregon se në rastet kur sillëshin keq, prindërit u bërtisnin dhe u hakërreheshin, ndërkohë që 40 përqind e tyre mohojnë të kenë përjetuar një gjë të tillë.

Prindërit shqiptarë janë të ndryshëm kur bëhet fjalë për "qëndresën" e tyre përballë dëshirës së fëmijëve për të marrë diçka dhe këmbënguljes shpesh ekstreme të tyre për ta pasur. Një e katërta e të rinjve thonë se kur ata "insistonin fuqimisht" për ta pasur diçka, atëherë ia arrinin, ndërkohë që për 39 përqind të tyre kjo gjë nuk ka funksionuar.

Një pjesë jo e vogël e prindërve kanë përdorur "bakshishe" të vogla, në formën e ëmbëlsirave apo lodrave, për t'i bindur fëmijët të silleshin mirë. Kjo praktikë raportohet nga 31 përqind si e shpeshtë, por, ndërkohë, rreth gjysma e tyre nuk e kanë hasur këtë gjë në familje.

Prindërit shqiptarë nuk përdorin kërcënime boshe ndaj fëmijëve, por i materializojnë ato. 18 përqind e të rinjve thonë se, pavarësisht paralajmërimit apo kërcënimit të prindërve, ata nuk janë dënuar, ndërkohë që shumica pohon se paralajmërimi është kthyer në realitet, kur ata janë sjellë keq.

FIGURA 72: Sa herë jeni sjellë si mëposhtë?





FIGURA 73: **Mendoni si ju kanë rritur prindërit kur keni qenë në shkollën fillore. Sa shpesh kanë ndodhur të mëposhtmet?**



Në përgjithësi vihen re dy grupime në përshkrimin e stilit të prindërimit: një qasje pak më e ashpër dhe, një më tolerante, por mbetet shqetësues fakti se ka shumë dëshmi për sjellje të paprueshme prindërore, si dhuna.

## PËRFUNDIME

Duhanpirja po kthehet në një zakon tejet të përhapur te të rinjtë, ku vihet re rritja e numrit të femrave. Efektet shëndetësore negative të duhanit nuk portretizohen në paketat e shitura në Shqipëri, sikundër aplikohet në vendet e tjera evropiane, ku fotografi shqetësuese synojnë të 'trembin' konsumatorët. Mund të ndryshohet kjo praktikë për sensibilizimin dhe uljen e numrit të përdoruesve.

Shkollat duhet të konsiderojnë hartimin dhe zbatimin e kodeve të etikës ose kodeve të nderit për të ulur shpeshësinë e kopjimit në provime dhe, akoma më keq, mburrjen me një sjellje të tillë. Kjo do të shënjestrojë edhe rritjen e tolerancës ndaj praktikave informale nga të rinjtë.

Të gjithë të rinjtë, por sidomos vajzat, duhet të edukohen dhe të inkurajohen vazhdimisht për përdorimin e rregullt të masave mbrojtëse në ativitetin e tyre seksual.

Mbeten të nevojshme programe të ndryshme ndërgjegjësimi, që synojnë t'i ndalojnë prindërit të përdorin dhunë në familje. Të rinjtë e shkollave të mesme duhen informuar se mund ta raportojnë këtë dhunë te psikologu i shkollës. Dhuna në familje është ndër tre motivet e para të kryerjes së krimeve të rënda në Shqipëri dhe një edukim i mirë kundër saj, që në moshë të vogël, do ta reduktohte fenomenin.







## 11


# PYETJE SPECIFIKE PËR SHQIPËRINË

- Pjesa më e madhe e të rinjve shqiptarë janë pro anëtarësimit të vendit të tyre në Bashkimin Evropian (BE). Ata, përgjithësisht, kanë pritshmëri jorealiste për kohën e realizimit të këtij qëllimi.
- Shqiptarët e rinj duken të ndarë në pritshmërinë që kanë nga reforma në drejtësi. Ata janë më optimistë në lidhje me procesin e vetingut dhe më skeptikë për sa i përket mundësisë që të ketë arrestime dhe procese gjyqësore të profilit të lartë politik.
- Shumica e të rinjve në Shqipëri besojnë se krimi ka lidhje të forta si me politikën në vend ashtu dhe me agjensitë ligj-zbatuese, madje dhe me median. Ky nivel i lartë i mosbesimit kolektiv ndaj institucioneve është pengesa më e madhe ndaj suksesit të reformave, që synojnë të përafrojnë Shqipërinë drejt anëtarësimit në BE.
- Gjysma e të rinjve të pyetur në këtë sondazh janë pro bashkimit të Shqipërisë me Kosovën, ndërkohë që gjysma tjetër përkrah marrëdhënie normale midis dy vendeve fqinjë.

## INTEGRIMI EVROPIAN DHE REFORMAT KYÇE

Mbi 92 përqind e të rinjve shqiptarë, pra një shumicë dërrmuese, janë pro anëtarësimit të vendit të tyre në Bashkimin Evropian, ndërkohë që vetëm 5 përqind janë euroskeptikë dhe besojnë se për Shqipërinë është më mire të mos jetë anëtare në BE. 3 përqind, shumica banues në kryeqytet, duken të pavendosur. Në vitin 2014, 89 përqind do të votonin pro në një referendum për anëtarësimin ndërkohë që numri i atyre që ishin kundër ose nuk do të merrnin pjesë në votim, ishte rreth 11 përqind.

FIGURA 74: **Mendoni se Shqipëria duhet të hyjë në Bashkimin Evropian?**



Sipas edicionit më të fundit të Barometrit Ballkanik, Shqipëria dhe Kosova janë në krye të listës së vendeve, që besojnë se anëtarësimi në BE do të ishte një zhvillim mjaft pozitiv për vendin e tyre (Barometer, 2017).<sup>40</sup>

Shumica e të rinjve shqiptarë, 37 përqind, janë tejet optimistë për shanset e Shqipërisë për t'iu bashkuar BE-së brenda pesë viteve të ardhshme. 32 përqind besojnë se kjo do të ndodhë në 10 vitet e ardhshme. 12 përqind mendojnë se kjo do të kërkojë një periudhë prej 10–20 vitesh, ndërkohë që 5 përqind nuk kanë besim se kjo do të ndodhë ndonjëherë.

FIGURA 75: Kur mendoni se Shqipëria do të hyjë në Bashkimin Evropian?




FIGURA 76: Mendoni se procesi i "Reformës në Drejtësi" do të shoqërohet me arrestime dhe gjykime të niveleve të larta në politikë dhe sistemin e drejtësisë?




FIGURA 77: Sa jeni dakort me pohimet e mëposhtme? Krimi dhe Politika kanë lidhje të forta me njëra tjetrën




FIGURA 78: Sa jeni dakort me pohimet e mëposhtme? Krimi dhe Media kanë lidhje të forta me njëra tjetrën





FIGURA 79: Sa jeni dakort me pohimet e mëposhtme? Krimi dhe Agjencitë e Zbatimit të Ligjit kanë lidhje të forta me njëra tjetrën



Rezultatet tregojnë se për një grup të madh të rinjsh mungon informacioni i saktë rreth procesit të integritimit. Ky rezultat mbetet konsistent me sondazhet e zhvilluara në të kaluarën. Sërish Barometri Ballkanik tregon se në rastin e Shqipërisë, një shumicë qytetarësh të të gjitha moshave pret që anëtarësimi në BE të ndodhë qysh në 2020, kurse një tjetër grup beson se kjo do të ndodhë, së paku, në 2025.<sup>41</sup>

29 përqind e të rinjve vlerësojnë se qeveria shqiptare nuk ka bërë mjaftueshëm për të shtyrë përpara perspektivën evropiane të vendit, ndërkohë që një tjetër grup, prej 39 përqind, vlerësojnë se është bërë mjaftueshëm për këtë proces. Vetëm një e katërta duken të kënaqur me performancën e qeverisë në procesin e integritimit.

Për të avancuar në rrugën e integritimit evropian, Shqipërisë i janë vënë dy kushte kryesore: zbatimi i reformës në drejtësi dhe, ne veçanti, kryerja e procesit të vettingut për gjykatësit dhe prokurorët dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, me një fokus të posaçëm në betejën kundër trafikut të narkotikëve. Në dy vitet e fundit të dyja këto çështje kanë qenë subjekti i një debati të nxehtë politik, por dhe shoqëror prandaj edhe kanë rrëmbyer vëmendjen e medias. Pikëpamjet e të rinjve mbi këto tema janë shumë të rëndësishme, sepse tregojnë perceptimet si dhe pritshmëritë për të ardhmen e këtyre proceseve.

58 përqind e të rinjve shqiptarë, pra pak më shumë se gjysma, besojnë se vettingu do të jetë i suksesshëm ose dhe shumë i suksesshëm dhe do ta pastrojë sistemin gjyqësor shqiptar nga individë të paaftë dhe të korruptuar. 26 përqind janë pesimistë dhe shpre-

hen se ky proces nuk do të funksionojë. Numri i atyre, që nuk kanë një mendim të caktuar ose janë të pavendosur mbi suksesin e këtij procesi, është i lartë dhe përbën 16 përqind të përgjigjeve.

Pritshmëria e përgjithëshme e të rinjve mbi Reformën në Drejtësi është se ajo do të gjenerojë shumë pak ose aspak arrestime dhe gjyqe, që do të prekin sferat e larta të politikës. Pra, ka pak pritshmëri që rastet e korrupsionit madhor do të mund të trajtohen përmes kësaj reforme. Vetëm 10 përqind e të rinjve të pyetur mendojnë se, si pasojë e reformës, politikanë dhe zyrtarë të nivelit të lartë do të përballen me gjykatën. Numri i atyre që nuk dinë si ti përgjigjen ose janë të pavendosur është i lartë dhe përbën 20 përqind të të rinjve.

Të dyja këto pyetje tregojnë se të rinjtë kanë një optimizëm të rezervuar për reformën dhe presin më shumë ndryshime sistematike, se sa arrestime dhe procese të bujshme. Ato dëshmojnë se te të rinjtë, sikundër te pjesa tjetër e popullatës, ka një perceptim të ndieshëm të nivelit të pandëshkueshmërisë së klasës politike.

Niveli në rritje i aktivitetit kriminal, sidomos në fushën e narkotrafikut, si dhe lidhjet midis krimit dhe politikës kanë qenë kryefjala e debateve politike më intensive. Rreth 70 përqind e të rinjve bien dakord me pohimin se krimi ka lidhje shumë të forta me politikën në Shqipëri. 5 përqind e tyre nuk janë dakord me këtë pohim, ndërkohë që 18 përqind janë disi të dyzuar. Ky nivel i perceptimit të kësaj ideje është prezent dhe në disa sondazhe të tjera.

Më shqetësues është numri i atyre që besojnë se krimi ka lidhje të ngushta me vetë agjencitë ligjzbatuese, kur, realisht e ligjërish duhet të jenë në ballë të luftës kundër kriminelëve. Në fakt këto

agjensi nuk gëzojnë një percetim pozitiv nga të rinjtë. 55 përqind e tyre kanë shumë dyshime rreth këtyre agjensive, duke besuar se ato përfitojnë nga lidhjet me krimin, përmes zinxhirëve të korrupsionit. Vetëm 10 përqind e të rinjve nuk bien dakord me këtë pohim ndërkohë që pjesa tjetër mbetet disi në mes.

Tërheq vëmendjen rezultati që të rinjtë, në numër të konsiderueshëm, mbeten shumë skeptikë ndaj medias. 43 përqind e tyre besojnë se edhe media ka lidhje me krimin e organizuar, ndërkohë që vetëm 22 përqind nuk ndajnë po këtë mendim.

Të rinjve iu është kërkuar të bëjnë një vlerësim të punës dhe të përpjekjeve, që aktorë të ndryshëm në vend po bëjnë për të luftuar krimin. Ata e vendosin punën e policisë së shtetit në të njëjtin nivel vlerësimi me atë të përfaqësimit të komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri. 26 përqind e të rinjve vlerësojnë se policia po bën përpjekjet më maksimale, ndërkohë që 25 përqind besojnë se në krye të kësaj beteje qëndron, në fakt, komuniteti ndërkombëtar. 22 përqind besojnë se aktori më i përfshirë është media. Më pak se 10 përqind ia japin këtë meritë prokurorëve dhe gjykatave, ndërkohë që 12 përqind thonë se asnjë institucion nuk është duke bërë shumë në lidhje me këtë çështje.

Numrat konfirmojnë se të rinjtë mbeten thellësisht skeptikë në lidhje me institucionet vendimtare, që supozohet të ruajnë rendin publik dhe të luftojnë kriminalitetin si dhe me aktorët e pushtetit të katërt, mediat, që identifikojnë dhe ekspozojnë problemet. Ky nivel i ulët i besimit publik një pengesë strategjike për shoqëritë demokratike dhe shtetet funksionale.


### PERSPEKTIVA ALTERNATIVE?

Të rinjtë shqiptarë shfaqen të ndarë në dysh, kur vjen puna për të ardhmen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës. 47 përqind prej tyre shprehen në favor të pasjes së marrëdhënieve normale midis dy shteteve fqinjë, kurse 47 përqind kërkojnë bashkimin. Ky bashkim mund të jetë në dy forma: si një konfederatë, për 9 përqind të tyre dhe si një shtet i unifikuar, për 38 përqind të tjerët. Mbështetja për një shtet të bashkuar është, veçanërisht e lartë, te të rinjtë që banojnë në veri të vendit. Me rritjen e moshës dhe të nivelit arsimor, te të pyeturit fillon e ulet dhe mbështetja për një shtet të vetëm dhe rritet mbështetja për marrëdhënie normale midis fqinjësh.

Sondazhe të ndryshme që janë zhvilluar më parë, tregojnë nivele të ndryshme mbështetjeje për idenë e bashkimit të të dy vendeve. Sipas një sondazhi të 2012, “62 përqind do të votonin pro bashkimit të Shqipërisë me Kosovën në një referendum përkatës. Kjo krahasohet me vetëm 39 përqind që do votonin pro në 2011. Po ashtu, 59 përqind e të pyeturve mendojnë se ky bashkim do të ishte një zhvillim pozitiv.”<sup>42</sup>

Ky ndryshim në kohë për mbështetjen është i dukshëm edhe në sondazhe të tjerë, të zhvilluara me kampionë përfaqësues të popullatës. Për shembull, në një sondazh paraelektoral, vetëm 1 përqind e të pyeturve thanë se bashkimi me Kosovën duhet të jetë një prioritet i qeverisë dhe parlamentit shqiptar.<sup>43</sup> Zelli nacionalist është një ndjesi, që shumica e shqiptarëve e humbasin gradualisht me rritjen në moshë.

FIGURA 80: Për mendimin tuaj, ç’ marrëdhënie zyrtare duhet të kenë Shqipëria dhe Kosova?



■ Marrëdhënie fqinjesie mes dy shteteve të pavarura
 ■ Kosova duhet t'i bashkohet Shqipërisë në një shtet të vetëm
 ■ Pa përgjigje
 ■ Të bëhen një vend i vetëm federal (Konfederatë)
 ■ Nuk e di

## PËRFUNDIME

Mbështetja e lartë për integrimin evropian vijon të jetë e shoqëruar me një nivel të ulët njohurish rreth procesit. Informacioni i strukturuar për BE-në dhe procesin e integritit në të nuk janë ende pjesë e kurrikulumit zyrtar shkollor në asnjë nivel arsimor. Kjo gjë mund të jetë në fokus për t'u ndryshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Besueshmëria e Refomës në Drejtësi është e varur nga transparencja dhe eficienta e procesit të vettingut. Ky është një proces delikat dhe në vazhdimësi dhe e ardhmja do të provojë rëndësinë madhore që zotëron ky proces.

Niveli i mosbesimit dhe, madje, i përçmimit të politikanëve, i policisë dhe i medias, nga të rinjtë duke i konsideruar ato shpesh si aksesore të krimit, është shumë shqetësues.

Agjensitë e zbatimit të ligjit dhe media në Shqipëri duhet të ndërgjegjësohen për imazhin negativ që kanë te të rinjtë. Ato duhet të marrin hapa për ta korrigjuar këtë imazh përmes sjelljes më profesionale, etike, si dhe përmes përcjedhjes së mesazheve të tyre në mënyrë të qartë dhe të hapur. Pronësia e medias në Shqipëri mbetet jotransparente dhe qëndrimet redaksionale ndryshojnë shpesh për të akomoduar palët në pushtet. Ky është një faktor që do t'i shtyjë përherë e më shumë të rinjtë drejt 'konsumit' të mediave alternative dhe online edhe pse për momentin besueshmëria e portaleve është mjaft e ulët.



## REFERENCA

- [ 1 ] <http://www.tiranatimes.com/?p=136005>
- [ 2 ] <http://www.monitor.al/rekordi-shqiperia-kalon-e-para-ne-bote-per-numrin-e-larte-te-bar-kafeve-per-banor/>
- [ 3 ] <http://www.balkaninsight.com/en/article/report-balkan-countries-most-vulnerable-to-adverse-effects-of-fake-news-03-29-2018> Raporti i OSI Bullgari
- [ 4 ] E krahasuar dhe me të dhënat e kapitullit mbi Familjen, vetëm 1 përqind e të rinje shqiptarë janë në një marrëdhënie bashkëjetese me partnerin e tyre.
- [ 5 ] <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1442/Paga-mesatare-mujore-ne-sektorin-shteteror-dhe-privat-Shqiperia-dhe-vendet-e-rajonit>
- [ 6 ] “Korrupsioni në Europën Juglindore” (The state of corruption in Southeast Europe,) SELDI, 2016 [http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/RAR\\_2016/SHADOW\\_POWER\\_EN\\_FINAL.pdf](http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/RAR_2016/SHADOW_POWER_EN_FINAL.pdf) pg 19
- [ 7 ] Sondazhi EBRD/World Bank Life in Transition cituar te Tirana Times: “One in two Albanians believe political connections are key to success, survey shows”, April 20–26,2018, pg 15 ( [www.tiranatimes.com](http://www.tiranatimes.com) )
- [ 8 ] Ibid, pg 18.
- [ 9 ] “Harta : vendet më fetare dhe më pak fetare në botë” (Mapped: The world’s most (and least) religious countries” January 14. 2018 The Telegraph <https://www.telegraph.co.uk/travel/maps-and-graphics/most-religious-countries-in-the-world/>
- [ 10 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert , faqe 42 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 11 ] ibid
- [ 12 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert , faqe 46 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 13 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert , faqe 48 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 14 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert , faqe 53 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 15 ] Ibid, faqe 54
- [ 16 ] Ibid, faqe 55
- [ 17 ] Ibid , faqe 55
- [ 18 ] Ibid, faqe 56
- [ 19 ] Ibid, faqe 56
- [ 20 ] “Harta : vendet më fetare dhe më pak fetare në botë” (Mapped: The world’s most (and least) religious countries” January 14. 2018 The Telegraph <https://www.telegraph.co.uk/travel/maps-and-graphics/most-religious-countries-in-the-world/>
- [ 21 ] “Harta : vendet më fetare dhe më pak fetare në botë” (Mapped: The world’s most (and least) religious countries” January 14. 2018 The Telegraph <https://www.telegraph.co.uk/travel/maps-and-graphics/most-religious-countries-in-the-world/>
- [ 22 ] <http://www.ekonomiaonline.com/globi/rajon/bllokohet-faqja-e-lotarise-amerikane-aplikuan-200-mije-shqiptare/>
- [ 23 ] <http://www.ekonomiaonline.com/globi/rajon/bllokohet-faqja-e-lotarise-amerikane-aplikuan-200-mije-shqiptare/>
- [ 24 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert, faqe 77 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 25 ] Ibid 76
- [ 26 ] Ibid, faqe 70
- [ 27 ] Ibid, faqe 74
- [ 28 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert, faqe 82 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 29 ] Ibid, faqe 83
- [ 30 ] Ibid, faqe 84
- [ 31 ] Ibid, faqe 85
- [ 32 ] Ibid, faqe 90
- [ 33 ] Rinia Shqiptare 2015, Studim ,Fondacioni Friedrich Ebert, faqe 150 web link <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12299.pdf>
- [ 34 ] Ibid, faqe 151
- [ 35 ] Ibid, faqe 52
- [ 36 ] Ibid, faqe 157
- [ 37 ] Ibid, faqe 155
- [ 38 ] Ibid, faqe 153
- [ 39 ] Ibid, faqe 161
- [ 40 ] Balkan Barometer, Regional Cooperation Council (RCC): 2017, pg 29,
- [ 41 ] Ibid.
- [ 42 ] “Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme”, <http://www.aiis-albania.org/sites/default/files/Albania%20in%20the%20next%20ten%20years%20-%20Politics%2C%20Economy%2C%20Society%2C%20Perceptions.pdf> , pg 15
- [ 43 ] “Ekonomia kryeson listen e shqetësimeve të shqiptarëve në prag të zgjedhjeve, sondazhi i AIIS” (Economy tops Albanians’ concerns ahead of elections, AIIS survey finds), Tirana Times, June 16, 2017, <http://www.tiranatimes.com/?p=132878>

**TABELA E FIGURAVE**

10	FIGURA 1: <b>Sa shpesh angazhoheni në aktivitet e mëposhtme?</b>	32	FIGURA 25 B: <b>Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju?</b>
12	FIGURA 2: <b>Keni akses të rregullt interneti (përfshi: Wi-Fi, smart-phone, publik, PC ...)?</b>	33	FIGURA 25 C: <b>Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju?</b>
12	FIGURA 3: <b>Sa shpesh e përdorni internetin për qëllimet e mëposhtme?</b>	33	FIGURA 25 D: <b>Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju?</b>
13	FIGURA 4: <b>Përafërsisht, sa miq keni në rrjetin social që përdorni më shpesh?</b>	38	FIGURA 26: <b>Sa e fortë është dëshira juaj të lëvizni në një vend tjetër për më shumë se gjashtë muaj (të emigroni)?</b>
17	FIGURA 5: <b>Sa të rëndësishme janë sjelljet e mëposhtëm për ju?</b>	39	FIGURA 27: <b>Sa kohë mendoni të qendroni jashtë?</b>
18	FIGURA 6: <b>Si e shihni të ardhmen tuaj pas 10 vitesh?</b>	40	FIGURA 28: <b>Ç'keni bërë deri tani për t'u larguar nga vendi?</b>
19	FIGURA 7: <b>Si e shihni të ardhmen e Shqipërisë në përgjithësi?</b>	41	FIGURA 29: <b>Cila është arsyeja kryesore pse kërkonte të largoheni nga vendi?</b>
19	FIGURA 8: <b>Në ç'masë ju trembin të mëposhtmet?</b>	41	FIGURA 30: <b>Ku dëshironi të shkoni? Rendisni deri në tre vende që ju pëlqejnë më shumë.</b>
20	FIGURA 9: <b>Për mendimin tuaj, sjelljet e mëposhtme mund të justifikohen gjithmonë, nuk mund të justifikohen kurrë, apo diku ndërmjet?</b>	42	FIGURA 31: <b>Deri në ç'masë keni njohuri për mundësitë në dispozicion të immigrantëve / të huajve në vendin mikpritës më të dëshiruar (i renditur i pari) sa i përket</b>
20	FIGURA 10: <b>Sa besim keni tek personat e mëposhtëm?</b>	42	FIGURA 32 A: <b>Cili është niveli juaj i zotërimit të gjuhës zyrtare në vendin mikpritës më të dëshiruar (i renditur i pari)?</b>
21	FIGURA 11: <b>Si do të ndiheshit nëse familjet ose personat e mëposhtëm do të lëviznin në lagjen tuaj?</b>	43	FIGURA 32 B: <b>Nëse nuk e kuptoni / flisni gjuhën zyrtare të vendit mikpritës më të dëshiruar (i renditur i pari), sa të gatshëm jeni ta mësoni atë?</b>
21	FIGURA 12: <b>Cilit besim fetar i përkisni, nëse keni?</b>	43	FIGURA 33: <b>Mendoni se jeni / do të jeni në gjendje të kontribuoni në zhvillimin dhe begatinë e vendit mikpritës? Si?</b>
22	FIGURA 13: <b>Sa i rëndësishëm është Zoti në jetën tuaj?</b>	46	FIGURA 34: <b>Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me cilësinë e arsimit në Shqipëri?</b>
22	FIGURA 14: <b>Përpos dasmave dhe funeraleve, sa shpesh i ndiqni shërbesat fetare këto ditë?</b>	46	FIGURA 35: <b>Jeni dakort se ka raste kur në universitetet / institutet në Shqipëri "blihen" notat?</b>
26	FIGURA 15: <b>Ku jetoni?</b>	47	FIGURA 36: <b>Mendoni se arsimiti universitar, shkollor dhe profesional në vendin tuaj është i mirëpërshtatur apo i keqpërshtatur me tregun e punës?</b>
26	FIGURA 16: <b>Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë situatën tuaj?</b>	47	FIGURA 37: <b>Gjatë arsimimit tuaj deri tani, keni marrë pjesë në një praktikë apo stazh?</b>
27	FIGURA 17: <b>Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë marrëdhënien tuaj me prindërit?</b>	48	FIGURA 38: <b>Cili është niveli më i lartë i arsimimit që keni përbushur deri tani?</b>
27	FIGURA 18: <b>Do t'i rrisnit fëmijët tuaj ashtu siç ju kanë rritur ju prindërit, apo do t'i rrisnit ndryshe?</b>	48	FIGURA 39: <b>Cili është niveli më i lartë i arsimimit që synoni të përbushni?</b>
28	FIGURA 19: <b>Cili mes pjesëtarëve të familjes apo të njohurve tuaj ka më shumë ndikim mbi vendimet tuaja të rëndësishme?</b>	49	FIGURA 40: <b>Cili është statusi juaj aktual sa i përket arsimimit?</b>
28	FIGURA 20: <b>Kanë ndikim prindërit mbi vendimet e rëndësishme në jetën tuaj?</b>	50	FIGURA 41: <b>Mesatarisht, sa orë në ditë shpenzoni për të studiuar (pas klasave/në shtëpi)?</b>
29	FIGURA 21: <b>Si e shihni veten në të ardhmen?</b>	50	FIGURA 42: <b>Për mendimin tuaj, si është jeta e përditshme në universitetin/shkollën tuaj?</b>
29	FIGURA 22: <b>Cili është statusi juaj aktual?</b>	51	FIGURA 43: <b>Cila ishte nota juaj mesatare gjatë vitit të fundit akademik?</b>
30	FIGURA 23: <b>Për mendimin tuaj, sa të rëndësishëm janë faktorët e mëposhtëm për një jetë të lumtur?</b>	54	FIGURA 44: <b>Cili është statusi juaj aktual i punësimit?</b>
31	FIGURA 24: <b>Për mendimin tuaj, cila është mosha më e mirë për tu martuar?</b>		
32	FIGURA 25 A: <b>Keni miq me prejardhje të ndryshme nga ju?</b>		

- 54 FIGURA 45:  
**Keni përjetuar një apo më shumë nga përvojat e mëposhtme: Nuk kam mundur të fitoj punën e dëshiruar për shkak të notave të dobëta në shkollë**
- 55 FIGURA 46:  
**Keni përjetuar një apo më shumë nga përvojat e mëposhtme: Pas shkollës kam lëvizur sepse nuk kishte punë të përshtatshme për mua në rajonin tim**
- 56 FIGURA 47:  
**Mesatarisht, sa orë në javë punoni?**
- 57 FIGURA 48:  
**Aktualisht, punoni në profesionit tuaj (për të cilin jeni trajnuar/arsimuar)?**
- 57 FIGURA 49:  
**Për mendimin tuaj, sa i rëndësishëm është secili nga faktorët e mëposhtëm që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?**
- 58 FIGURA 50:  
**Për mendimin tuaj, sa të rëndësishëm janë Të Njohurit (miqtë, të afërmit ...) që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?**
- 58 FIGURA 51:  
**Për mendimin tuaj, sa i rëndësishëm është Nivelin e Arsimit që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?**
- 59 FIGURA 52:  
**Për mendimin tuaj, sa të rëndësishme janë Lidhjet me njerëzit në pushtet që një i ri të gjejë punë në vendin tuaj?**
- 59 FIGURA 53:  
**Sa të rëndësishëm janë për ju faktorët e mëposhtëm kur zgjidhni një punë**
- 60 FIGURA 54:  
**Jeni angazhuar ndonjëherë me aktivitete vullnetare gjatë 12 muajve të fundit, p.sh.: keni kryer vullnetarisht ndonjë punë pa pagesë?**
- 61 FIGURA 55:  
**Me ç'loj organizate keni punuar vullnetarisht gjatë 12 muajve të fundit:**
- 64 FIGURA 56:  
**Personalisht, sa të interesuar jeni me të mëposhtmet**
- 64 FIGURA 57:  
**Për mendimin tuaj, sa të mirëpërfaqësuarat janë interesat e të rinjve në politikën Kombëtare?**
- 65 FIGURA 58 A:  
**Keni votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare?**
- 65 FIGURA 58 B:  
**Keni votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare?**
- 66 FIGURA 59 A:  
**Nëse do të mbaheshin zgjedhjet parlamentare dhe ju do të kishit të drejtën e votës, do të shkonit të votonit?**
- 66 FIGURA 59 B:  
**Nëse do të mbaheshin zgjedhjet parlamentare dhe ju do të kishit të drejtën e votës, do të shkonit të votonit?**
- 67 FIGURA 60:  
**"Të ardhurat midis të pasurve dhe të varfërve duhet të jenë më të përafërta"**
- 67 FIGURA 61:  
**Sa të kënaqur jeni me gjendjen e demokracisë në përgjithësi (në Shqipëri)?**
- 68 FIGURA 62:  
**Jeni dakort apo jo me pohimet e mëposhtme**
- 69 FIGURA 63:  
**Keni provuar të bëni secilën si mëposhtë**
- 69 FIGURA 64:  
**Deri në ç'masë duhet qeveria të fokusohet në secilin prej objektivave të mëposhtëm**
- 70 FIGURA 65:  
**Cilat janë vlerat më të rëndësishme për ju personalisht (Të renditura)**
- 74 FIGURA 66:  
**Pini duhan?**
- 74 FIGURA 67:  
**Konsumoni alkool?**
- 75 FIGURA 68:  
**Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë përvojën tuaj seksuale?**
- 75 FIGURA 69:  
**Në ç'moshë keni përjetuar marrëdhënien tuaj të parë seksuale?**
- 76 FIGURA 70:  
**Përdorni profilaktikë apo metoda për parandalimin e shtatzënisë?**
- 76 FIGURA 71 A:  
**Sa jeni dakort me të mëposhtmet**
- 76 FIGURA 71 B:  
**Sa jeni dakort me të mëposhtmet**
- 77 FIGURA 72:  
**Sa herë jeni sjellë si mëposhtë?**
- 78 FIGURA 73:  
**Mendoni si ju kanë rritur prindërit kur keni qenë në shkollën fillore. Sa shpesh kanë ndodhur të mëposhtmet?**
- 81 FIGURA 74:  
**Mendoni se Shqipëria duhet të hyjë në Bashkimin Europian?**
- 82 FIGURA 75:  
**Kur mendoni se Shqipëria do të hyjë në Bashkimin Europian?**
- 82 FIGURA 76:  
**Mendoni se procesi i "Reformës në Drejtësi" do të shoqërohet me arrestime dhe gjykime të niveleve të larta në politikë dhe sistemin e drejtësisë?**
- 83 FIGURA 77:  
**Sa jeni dakort me pohimet e mëposhtme? Krimi dhe Politika kanë lidhje të forta me njëra tjetrën**
- 83 FIGURA 78:  
**Sa jeni dakort me pohimet e mëposhtme? Krimi dhe Media kanë lidhje të forta me njëra tjetrën**
- 84 FIGURA 79:  
**Sa jeni dakort me pohimet e mëposhtme? Krimi dhe Agjencitë e Zbatimit të Ligjit kanë lidhje të forta me njëra tjetrën**
- 85 FIGURA 80:  
**Për mendimin tuaj, ç'marrëdhënie zyrtare duhet të kenë Shqipëria dhe Kosova?**

## **TABELA E TABELAVE**

- 6 TABELË 1:  
**Peshimi / koeficienti**
- 13 TABELË 2:  
**Ngjarjet kryesore të jetës**
- 14 TABELË 3:  
**Monedha LEK**

## IMPRINT

**PUBLIKOI:** Fondacioni „Friedrich Ebert“ – Zyra e Tiranës

Rr. „Abdi Toptani“ • Torre Drin • Kati 3-të

Kutia Postare 1418 • Tiranë • Shqipëri

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

[www.fes.de/youth-studies/](http://www.fes.de/youth-studies/)

**PERSONI PËRGJEGJËS:** Wulf Lapins

**KOORDINATORE PROJEKTI:** Jonida Smaja

**KONTAKT:** Martin Güttler • [martin.guettler@fes.de](mailto:martin.guettler@fes.de)

**REDAKTOR:** Mrs. Evis Mastori MSc

**AUTORË:** Alba Çela, Geron Kamberi

**DESIGN:** Andrea Schmidt • Typografie/im/Kontext

**SHTYP:** Albdesign PSP, Tiranë, Shqipëri

**ISBN:** 978-9928-215-24-6

**DATE:** 2019

Qëndrimet e shprehura në publikim nuk janë domosdoshmërisht të Fondacionit “Friedrich Ebert” (FES) apo të organizatave në të cilat punojnë autorët. FES nuk mund të garantojë saktësinë e të gjitha të dhënave të përdorura në këtë publikim. Përdorimi komercial në çdo media i publikimit të Fondacionit “Friedrich Ebert” nuk është i lejuar pa miratim me shkrim të FES. Çdo referencë e bërë për Kosovën nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR (RKSKB) 1244/1999 dhe opinionin e ICJ (GJND) mbi deklarinin e pavarësisë së Kosovës. Çdo referencë e bërë për Maqedoninë nënkuptohet si referuar Ish – Republika Jugosllave e Maqedonisë.



